



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 188

Tiranë – E martë, 7 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 3.12.2021	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2021..... 16945
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 3.12.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 35, datë 27.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2021, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”..... 16945
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 3.12.2021	Për transferimin në pronësi nga Ministria e Brendshme tek Bashkia Librazhd, të një pjese të pasurisë 7/136, me emërtimin “Komisariati i Policisë Librazhd”, me sipërfaqe trualli 1900 m ² dhe sipërfaqe ndërtese 513 m ² , me vendndodhje në zonën kadastrale 2446, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe për një shtesë në vendimin nr. 1086, datë 28.10.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 16946
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 3.12.2021	Për miratimin e protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për krijimin e Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar... 16949
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 734, datë 3.12.2021	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Fierit..... 16951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 3.12.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 615, datë 7.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kontratat e tregtimit në largësi të shërbimeve financiare për konsumatorët”..... 16951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 739, datë 3.12.2021	Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil dhe rregullat për procesin e investigimit..... 16952

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 740, datë 3.12.2021	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunimin e përbashkët në arsimin e lartë.....	16966
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 741, datë 3.12.2021	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit (SPSH).....	16971
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 3.12.2021	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)	16972
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 743, datë 3.12.2021	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Vlerësimit të Maturës Shtetërore (SVMSH)	16974
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 59, datë 24.11.2021	Për miratimin e rregullores “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”	16975
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 65, datë 1.12.2021	Për dhënien e miratimit për zotërimin e kontrollit të tërthortë të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Alpha Albania sh.a. nga aksionari i tërthortë Alpha Bank s.a., Greqi.....	17037
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 1.12.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Për eksport-importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare”, të ndryshuar.....	17037



VENDIM
Nr. 730, datë 3.12.2021

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND EDHE PËR KANDIDATË TË
TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE
PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 27, dhe të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfundimisht, për vitin 2021, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND është e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2021, pranimi në TND të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 8 (tetë).

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë për kandidatët nga jashtë shërbimit civil janë, si më poshtë vijon:

a) Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

b) Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë

institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

c) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlershme në:

- institucione të administratës publike;
- institucione bankare të nivelit të dytë e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë të paktën 5 (pesë) vjet që janë krijuar.

Përfundimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë:

- në institucione ndërkombëtare brenda vendit;
- në profesion jashtë vendit;
- pedagogë në institucione të arsimit të lartë;
- avokatë, noterë apo kontabilistë të miratuar brenda ose jashtë vendit,

duhet të kenë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune, përkatësisht në këto institucione ose në profesion.

ç) Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

5. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 731, datë 3.12.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 35, DATË 27.1.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN
VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2021,
NË INSTITUCIONET E
ADMINISTRATËS SHTETËRORE,
PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 35, datë 27.1.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2021 është, gjithsej, 889 (tetëqind e tetëdhjetë e nëntë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- a) për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues 8;
- b) për kategorinë e mesme drejtuese 60;
- c) për kategorinë e ulët drejtuese 169;
- ç) për kategorinë ekzekutive 652.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 732, datë 3.12.2021

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI NGA
MINISTRIA E BRENDSHME TEK
BASHKIA LIBRAZHD, TË NJË PJESE TË
PASURISË 7/136, ME EMËRTIMIN
“KOMISARIATI I POLICISË LIBRAZHD”,
ME SIPËRFAQE TRUALLI 1900 m² DHE
SIPËRFAQE NDËRTESE 513 m², ME
VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 2446, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250,
DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
1086, DATË 28.10.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3, shkronja “g”, 5 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi nga Ministria e Brendshme tek Bashkia Librazhd, të një pjese të pasurisë 7/136, me emërtimin “Komisariati i Policisë Librazhd”, me sipërfaqe trualli 1900 (një mijë e nëntëqind) m² dhe sipërfaqe ndërtese 513 (pesëqind e trembëdhjetë) m², me vendndodhje në zonën kadastrale 2446, sipas formularit, gjithsej 1 (një) fletë, dhe planrilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës publike, për ndërtimin e një parku publik.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike, të miratuar me vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, të miratuar me vendimin nr. 1086, datë 28.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Librazhd, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Bashkia Librazhd, para dorëzimit të sipërfaqes së truallit dhe ndërtesës, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, të lidhin marrëveshje me objekt:

a) sigurimin e ambienteve të nevojshme, transferimin dhe ruajtjen e mjeteve të sekuestruara, të cilat ndodhen aktualisht në këtë pasuri, pa kosto financiare për Policinë e Shtetit;

b) sigurimin, për Ministrinë e Brendshme, të një sipërfaqeje toke të mjaftueshme, për t’u përdorur për parkimin e mjeteve që bllokohen nga shërbimet e Policisë së Shtetit;

c) ndërtimin e murit të ri rrethues dhe rehabilitimin e fasadave të objekteve të Komisarariatit të Policisë Librazhd, në harmoni me zonën që do të zhvillohet.

4. Bashkisë Librazhd i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.



5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Librazhd dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETETRORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Istitucioni / Pushteti Qendror _____
Bashkia / Njesia: Librazhd
 Iusta e përdorimit të pronës: Administrata vendore

Identifikimi: Bashkim Murati (Specialist)
 Supërvizor: Borçilida Bilaku (Arhitekt)
 Aprovoj: Kasriod Gurra (Kyetar Bashkia Librazhd)



A			B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastrale Indeksi / Hektar	Nr. Paturiz 7/136	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtim (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Istitucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Istitucioni / Enti përdorues Statusi juridik / përdorimit (Shënim në veçanta)
1	2446 LB - E - 3	7/136	Truall	Ish komiseriati i policisë Librazhd Lagja Nr. 2 Librazhd	1900	513	Ambjente ndërmes	Bashkia	10
									11
									Shpërfaqja prej 1900 m ² truall dhe 513 m ² ndërtimesh është pjesë e pasurisë 7/136 e cila në total ka shpërfaqje 4000m ² truall dhe 993 m ² ndërtimesh



VENDIM
Nr. 733, datë 3.12.2021

propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË
BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, PËR KRIJIMIN E
SEKRETARIATIT KOORDINUES
NDËRQEVERITAR**

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për krijimin e Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me

**PROTOKOLL BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR
KRIJIMIN E SEKRETARIATIT KOORDINUES NDËRQEVERITAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, më poshtë referuar si “Palët”

Duke synuar forcimin dhe thellimin e bashkëpunimit dypalësh në fusha me interes të ndërsjellë,

Në vijim të marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara dhe me qëllim monitorimin e zbatimit të tyre,

Palët bien dakord për sa më poshtë,

NENI 1

Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar për përmirësimin e bashkëpunimit shumë - sektorial Shqipëri – Kosovë.

NENI 2

1. Sekretariati Koordinues Ndërqeveritar kryen këto detyra:
 - a) Koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara midis palëve;
 - b) Koordinimin e nismave të reja të përbashkëta të dy palëve;
 - c) Përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve periodike në mbledhjet javore të Këshillit të Ministrave të dy palëve;
 - d) Përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve përpara mbledhjeve të dy qeverive;
 - e) Analizimin e progresit të zbatimit të marrëveshjeve të lidhura mes palëve;



nëpërmjet identifikimit të problematikave të hasura dhe propozimit të masave për zbatimin e plotë të tyre;

f) Thellimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis administratave të dy palëve.

2. Për realizimin e detyrave të saj, në përputhje me legjislacionet në fuqi të Palëve, Sekretariati Koordinues Ndërqeveritar bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore në Shqipëri dhe Kosovë, organizatat dhe shoqatat, realizon proceset e aplikimit për fonde mbështetëse në programe dhe projekte, të shteteve të veçanta dhe të organizatave partnere, donacione të subjekteve fizike dhe juridike, vendase dhe të huaja për zbatimin e marrëveshjeve midis dy palëve.

NENI 3

1. Sekretariati Koordinues Ndërqeveritar është strukturë në varësi të kryeministrave të dy vendeve dhe drejtohet nga Koordinatori.
2. Sekretariati Koordinues Ndërqeveritar do ketë gjithsej gjashtë punonjës, të përcaktuar nga palët në numër të barabartë. Këta të fundit do punojnë në shërbim të Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar
3. Koordinatori shkarkohet me urdhër të kryeministrit së secilës palë.
4. Sekretariati Koordinues Ndërqeveritar për realizimin e detyrave të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi të palëve, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, e organizata jo qeveritare.

NENI 4

1. Staf i ngarkuar me punë në kuadër të të dy palëve, do ngarkohet me punë shtesë në kuptim të ndihmës dhe përkrahjes ndaj Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar. Personat e përcaktuar për punë të këtillë do vendosen nga dy Kryeministrat me konsultim të Koordinatorit.
2. Koordinator i Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar do shërbejë si këshilltar i dy Kryeministrave dhe do marrë pagën e këshilltarit të Kryeministrit të Shqipërisë.

NENI 5

Veprimtaria e Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar do të financohet nga secila palë për shpenzimet korente dhe pagat e stafit rezident të caktuar nga Palët.



NENI 6

1. Ky protokoll bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët.
2. Protokollin e Bashkëpunimit mund të ndryshohet me shkrim nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve.

Nënshkruar në ELBASAN, më 26.11.2021, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të gjithë tekstet janë njëjloj të vlefshëm.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS**

**EDI RAMA
KRYEMINISTËR**

**ALBIN KURTI
KRYEMINISTËR**

VENDIM

Nr. 734, datë 3.12.2021

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË FIERIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Baki Bala, prefekt i qarkut të Fierit, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Lifter Shehaj emërohet prefekt i qarkut të Fierit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

1.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

VENDIM

Nr. 736, datë 3.12.2021

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 615, DATË 7.9.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KONTRATAT E TREGTIMIT NË
LARGËSI TË SHËRBIMEVE
FINANCIARE PËR KONSUMATORËT”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 36 e 61, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me: Direktivën 2002/65/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 23 shtator 2002, në lidhje me tregtimin në distancë të shërbimeve financiare të konsumatorëve [numri CELEX 32002L0065, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 271, 9.10.2002, f. 16–24], dhe amenduar nga: direktiva (EU) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 25 nëntor 2015 [numri CELEX 32015L2366, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 337/35, 23.12.2015, f. 35–127].



VENDOSI:

Në vendimin nr. 615, datë 7.9.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “b”, të pikës 2, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) “Mjet i komunikimit në largësi” është çdo mjet, që, pa praninë fizike të njëkohshme të tregtarit dhe të konsumatorit, mund të përdoret për lidhjen e kontratës ndërmjet palëve.”.

2. Pas pikës 7 shtohet pika 7.1, me këtë përmbajtje:

“7.1 Përfshihet sa më sipër, pika 7, e këtij vendimi, lidhur me informimin, nuk aplikohet, me përjashtim të nënndarjeve “iii–vii”, të shkronjës “b”; nënndarjeve “i” dhe “iv”, të shkronjës “c” dhe nënndarjes “ii”, të shkronjës “ç”, të kësaj pike, në rastet kur dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi për shërbimet e pagesave gjejnë zbatim.”.

3. Në pikën 17, pas fjalës “... përcaktuar”, fjalët “... në pikën 3, të nenit 37, të ligjit nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”...” zëvendësohen me “... në pikën 1, të nenit 37/1, të ligjit nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.”...

4. Në pikën 18, pas fjalës “... jetës” hiqen fjalët “... sipas përcaktimeve në shkronjën “c”, të pikës 3, të nenit 37, të ligjit nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”...”.

5. Në pikën 22, pas fjalëve “... të parashikuara në nenet ...” fjalët “...37, pika 4, ...” zëvendësohen me “... 37/7 ...”.

6. Pas pikës 24 shtohet pika 24.1, me këtë përmbajtje:

“24.1 Në rastin kur konsumatori heq dorë nga një kontratë sigurimi, tregtari nuk i kërkon konsumatorit të paguajë asnjë shumë.”.

7. Shkronja “c”, e pikës 33, të këtij vendimi, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Mjetet e tjera të komunikimit në largësi, kur ato lejojnë komunikimet individuale, përveç atyre të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike:

i. nuk do të autorizohen nëse nuk është marrë pëlqimi i konsumatorëve; ose

ii. mund të përdoren vetëm nëse konsumatori nuk ka shprehur kundërshtimin e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 739, datë 3.12.2021

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT
KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT PËR
SIGURINË E OPERIMIT NË
AVIACIONIN CIVIL DHE RREGULLAT
PËR PROCESIN E INVESTIGIMIT²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 100, pika 2, e 101, të ligjit 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është miratimi i:

a) organizimit dhe funksionimit të Autoritetit të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil (këtu e në vijim “Autoriteti i Investigimit”) si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për transportin ajror (këtu e në vijim “ministri”), me seli në Tiranë;

b) rregullave për procesin e investigimit, sipas përcaktimit në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti i Investigimit financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

3. Autoriteti i Investigimit ka si mision përmirësimin e sigurisë ajrore dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve, nëpërmjet investigimit të tyre dhe nxjerrjes së shkaqeve, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

4. Rregullat për investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil përcaktohen në rregulloren sipas shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

² Ky projektvendim është përafëruar plotësisht me Rregulloren (BE) nr. 996/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 20 tetor 2010, mbi investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil dhe shfuqizon direktivën 94/56/EC, të ndryshuar nga Rregulloret (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nr. 376/2014 dhe nr. 2018/1139. Numri CELEX 02010R0996, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 29, datë 12.11.2010, faqe 35.



II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AUTORITETIT TË INVESTIGIMIT

1. Autoriteti i Investigimit organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë e tij për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti i Investigimit ka si përgjegjësi funksionale të tij kryerjen e procesit të investigimit dhe nxjerrjes së shkaqeve të aksidenteve e të incidenteve të rënda dhe dhënien e rekomandimeve për sigurinë ajrore.

3. Autoriteti i Investigimit drejtohet nga drejtori, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e tij dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i autoritetit e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

4. Drejtori i Autoritetit të Investigimit emërohet dhe lirohet me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të ministrit përgjegjës për transportin ajror dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;
b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

ç) të ketë përvojë profesionale e aftësi teknike e menaxheriale, të paktën 5 (pesë) vjet në fushën e aviacionit civil për çështje rregullatore dhe ato të sigurisë së operimit;

d) të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;

dh) të mos ketë qenë i angazhuar në funksione drejtuese partiake, të paktën 4 (katër) vjet përpara emërimit;

e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

5. Drejtori i Autoritetit të Investigimit lirohet nga detyra, kur:

a) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

d) jep dorëheqjen nga detyra;

dh) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës.

6. Marrëdhëniet e punës së drejtorit dhe punonjësve të Autoritetit të Investigimit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

7. Drejtori i Autoritetit të Investigimit kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) përcakton objektivat vjetorë dhe harton planin vjetor të punës së institucionit;

b) drejton procesin e planifikimit buxhetor dhe të raportit vjetor të punës;

c) raporton në mënyrë periodike dhe sa herë që kërkohet te ministri për veprimtarinë e institucionit;

ç) drejton punën për përgatitjen e rregullores që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të autoritetit dhe/apo ndryshimet e saj dhe e dërgon atë për miratim te ministri;

d) përgatit kërkesat e veçanta të vendit të punës për rekrutimin e nëpunësve/punonjësve të autoritetit dhe emëron nëpunësit dhe punonjësit, në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë;

dh) nxjerr akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme të detyrueshme për nëpunësit e autoritetit dhe për realizimin e funksioneve të tij;

e) nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me organe homologe dhe organizata të ndryshme të huaja, në përputhje me parashikimet ligjore;

ë) autorizon me shkrim delegimin e pjesshëm apo të plotë të kompetencave, në rast të mungesës së tij;

f) çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi dhe ministri.

8. Autoriteti i Investigimit, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij, kryen detyrat sipas përcaktimeve në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, të këtij vendimi, si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi.

9. Rregullorja, që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Autoritetit të Investigimit dhe/apo ndryshimet e



saj, miratohet nga ministri, pas propozimit të drejtorit të autoritetit.

10. Struktura dhe organika e Autoritetit të Investigimit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

11. Autoriteti i Investigimit ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e autoritetit përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria ... (emri i ministrisë përgjegjëse për transportin ajror), Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil.

12. Vula e Autoritetit të Investigimit ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për nëpunësit civilë aktualë të Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/ Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit.

2. Vendimi nr. 686, datë 2.6.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/ Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil”, shfuqizohet.

3. Deri në miratimin dhe vënien në zbatim të strukturës së re të Autoritetit të Investigimit sipas legjislacionit në fuqi, Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/ Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil të vijojë funksionimin e tij, sipas strukturës dhe organikës aktualisht në fuqi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

SHTOJCA

(Pika 4, kreu I)

RREGULLORE

PËR INVESTIGIMIN DHE PARANDALIMIN E AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE NË AVIACIONIN CIVIL

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përmirësojë sigurinë e aviacionit civil, duke garantuar një nivel të lartë të efikasitetit, përshtatshmërisë dhe cilësisë së investigimeve të sigurisë së aviacionit civil. Objektivi i vetëm është parandalimi i aksidenteve dhe incidenteve në të ardhmen, pa përcaktuar fajësi apo përgjegjësi, duke përfshirë kështu krijimin e një Rrjeti Evropian të Autoriteteve të Investigimit për Sigurinë në Aviacionin Civil. Kjo rregullore parashikon, gjithashtu, rregulla në lidhje me disponueshmërinë në kohë të informacionit, në lidhje me të gjithë personat dhe mallrat e rrezikshëm në bordin e një avioni të përfshirë në një aksident, si edhe ka për qëllim përmirësimin e ndihmës për viktimat e aksidenteve ajrore dhe të afërmit e tyre.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Autoritet i Investigimit”, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil.

2. “Aksident”, një ngjarje e lidhur me operimin e avionit, e cila, në rastin e një avioni me pilot, ndodh ndërmjet kohës që një person hip në avion për të fluturuar deri në kohën që ky person zbret ose, në rastin e një avioni pa pilot, ndodh ndërmjet kohës që avioni është gati të lëvizë për të fluturuar deri në kohën që pushon, në përfundim të fluturimit dhe sistemi kryesor motorik është fikur, në të cilën:

a) një person plagoset për vdekje apo rëndë;

i. si pasojë e prezencës së tij në avion;

ii. si pasojë e kontaktit të drejtpërdrejtë me ndonjë pjesë të avionit, duke përfshirë edhe pjesët e shkëputura nga avioni; ose



iii. nga ekspozimi i drejtpërdrejtë i shpërthimit të avionit, me përjashtim të rasteve kur dëmtimet janë shkaktuar nga shkaqe natyrore, të vetëshkaktuara apo të shkaktuara nga persona të tjerë ose në rastet kur dëmtimet u ndodhin personave të fshehur jashtë zonave normalisht të përdorshme nga pasagjerët dhe ekuipazhi;

b) avioni pëson dëme ose mosfunksionime strukturore, të cilat ndikojnë në dëmtimin e fuqisë strukturore, performancën apo karakteristikat e fluturimit të avionit e që normalisht kërkojnë riparim madhor ose zëvendësim të pjesës së dëmtuar, përveçse për dëmtim ose mosfunksionim të motorit, kur dëmi kufizohet te një motor (përfshirë përbërësit ose aksesoret e tij), te helikat, pjesët e krahëve, antenat, fletët, gomat, frenat, rrotat, mbulesat, panelet, hyrjet e rrotave, xhamat, shpimet ose deformimet në veshjen e avionit, ose dëmtimet e vogla në helikat e bishtit të rotorit, rrotës së uljes dhe ato që rezultojnë nga breshëri ose goditja nga zogjtë; ose

c) avioni humb apo është krejtësisht i paarritshëm.

3. “Përfaqësuesi i akredituar”, një person i zgjedhur nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, në bazë të kualifikimeve të tij, me qëllim pjesëmarrjen në një investigim të sigurisë të kryer nga një shtet tjetër. Një përfaqësues i akredituar, i caktuar nga Republika e Shqipërisë dhe shtetet e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), siç përcaktohet në marrëveshjen shumëpalëshe (marrëveshja për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, ratifikuar me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006) duhet të jetë nga një autoritet investigimi të sigurisë.

4. “Këshilltarë”, personi i emëruar nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, në bazë të kualifikimeve të tij, me qëllim për të ndihmuar përfaqësuesin e tij të akredituar në një investigim të sigurisë;

5. “Shkaktim”, veprimet, mosveprimet, ngjarjet, kushtet ose një kombinim të tyre, të cilat kanë sjellë një aksident ose incident; identifikimi i shkaqeve nuk nënkupton përcaktimin e fajit apo të përgjegjësisë administrative, civile ose penale.

6. “Dëmtim fatal”, një dëmtim që pëson një person në një aksident dhe që rezulton në vdekjen e tij brenda 30 ditëve nga data e aksidentit.

7. “Regjistruer fluturimi”, çdo lloj regjistruesi të instaluar në avion me qëllim lehtësimin e investigimeve të sigurisë së aksidenteve/incidenteve.

8. “Incident”, një ngjarje gjatë operimit të një avionit, e ndryshme nga aksidenti, e cila ndikon ose mund të prekë sigurinë e operimit.

9. “Standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara”, standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara për aksidentet e avionit dhe investigimin e incidenteve të miratuara në përputhje me nenin 37, të Konventës së Çikagos.

10. “Investiguesi në detyrë”, një person të ngarkuar, në bazë të kualifikimeve të tij me përgjegjësi për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e një investigimi të sigurisë në operim.

11. “Operator”, çdo person fizik ose juridik, që drejton ose është propozuar për të operuar një ose më shumë avionë.

12. “Person i përfshirë”, pronari, një anëtar i ekuipazhit, operatori i avionit i përfshirë në një aksident ose incident të rëndë; çdo person i përfshirë në mirëmbajtjen, projektimin, prodhimin e këtij avionit ose në trajnimin e ekuipazhit të tij; çdo person i përfshirë në sigurimin e kontrollit të trafikut ajror, në informacionin e fluturimit apo të përfshirë në shërbimet e aerodromeve, të cilët kanë ofruar shërbime për këtë avion; Stafi i autoritetit të aviacionit civil; ose stafi i Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë në Operim të Aviacionit (EASA).

13. “Raport paraprak”, komunikimi që përdoret për shpërndarjen e shpejtë të të dhënave të marra gjatë fazave të hershme të investigimit.

14. “Të afërmit”, familjarët dhe/ose të afërmit dhe/ose një person tjetër, i cili është i lidhur ngushtë me viktimën e përfshirë në një aksident, siç është përcaktuar në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

15. “Investigimi i sigurisë në operim”, një proces i kryer nga autoriteti investigues i sigurisë në operim, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe të incidenteve, të cilat përfshijnë mbledhjen dhe analizën e informacionit, nxjerrjen e konkluzioneve, si edhe përcaktimin e shkaqeve dhe /ose faktorët kontribues dhe, kur është e nevojshme, bërjen e rekomandimeve të sigurisë.

16. “Rekomandimi i sigurisë”, një propozim i një autoriteti investigues të sigurisë në operim, bazuar në informacionin e marrë nga një investigim



sigurie në operim apo burim tjetër, i tillë si studime të sigurisë, të bëra me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve.

17. “Incident i rëndë”, një incident i cili përfshin rrethana që tregojnë se ka pasur një probabilitet të lartë për një aksident dhe është i lidhur me funksionimin e një avioni, i cili në rastin e një avioni me ekuipazh ndodh ndërmjet kohës që personat kanë hipur në avion, me qëllim fluturimi deri në kohën kur të gjithë këta persona kanë zbarkuar ose në rastin e një avioni pa ekuipazh, ndodh ndërmjet kohës që avioni është gati për të lëvizur, me qëllim fluturimi deri në kohën e pushimit në nivelin e fundit të fluturimit dhe kur sistemi primar shtytës është mbyllur. Një listë me shembuj të incidenteve të rënda është paraqitur edhe në aneksin e kësaj rregulloreje.

18. “Plagosje e rëndë”, një dëmtim që pëson një person në një aksident dhe i cili përfshin një nga rastet e mëposhtme:

a) shtrimin në spital për më shumë se 48 orë, brenda 7 ditëve nga data, kur dëmtimi ka ndodhur;

b) thyerje e ndonjë prej kockave (përveç frakturave të thjeshta të gishtave, majës së këmbës dhe hundës);

c) prerjet që shkaktojnë hemorragji, dëmtim të rëndë të nervave, muskujve ose ligamenteve;

ç) dëmtim i ndonjë organi të brendshëm;

d) djegie të shkallës së dytë apo të tretë ose ndonjë djegie që mbulon më shumë se 5% të sipërfaqes së trupit;

dh) ekspozimi i vërtetuar ndaj substancave infektive ose rrezatimit të dëmshëm.

19. “Rrjeti Evropian”, Rrjeti Evropian i Autoriteteve të Investigimit të Sigurisë së Aviacionit Civil, që është një bashkësi e autoriteteve kompetente, të cilat merren me investigimin e sigurisë në operim në secilin nga shtetet e ZPEA-së, sipas përcaktimit të marrëveshjes shumëpalëshe, të përbërë nga krerët e këtyre autoriteteve dhe/ose në rastin e një autoriteti multimedial, nga krerët e degës së aviacionit ose përfaqësuesit e tyre dhe që ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së investigimeve të kryera, duke inkurajuar standarde të larta në metodat e investigimit dhe trajnimit të investiguesve në operim.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore do të zbatohet për investigimet e sigurisë në operim në aksidentet dhe incidentet e rënda:

a) të cilat kanë ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) në rastet kur janë përfshirë avionë që janë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose operojnë nëpërmjet një sipërmarrjeje të themeluar në Republikën e Shqipërisë dhe në ato raste kur aksidenti/incidenti ka ndodhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por një investigim i tillë nuk është kryer nga shteti tjetër.

c) në rastet në të cilat Republika e Shqipërisë ka të drejtë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e rekomanduara, të emërojë një përfaqësues të akredituar për të marrë pjesë si shteti i regjistrimit, shteti i operatorit, shteti i projektuesit, shteti i prodhuesit ose shteti që siguron informacion, mjete ose ekspertë me kërkesën e shtetit që kryen investigimin;

ç) në rastet kur Republika e Shqipërisë ka një interes të veçantë, për shkak të fatkeqësive apo dëmtimeve të rënda që iu janë shkakuar qytetarëve të saj, ajo do të lejohet nga shteti i cili do kryejë investigimet e sigurisë, të emërojë një ekspert për të marrë pjesë në këto investigime.

2. Kjo rregullore do të zbatohet për çështjet që kanë të bëjnë me disponueshmërinë në kohë të informacionit, në lidhje me të gjithë personat dhe mallrat e rrezikshëm në bordin e një avioni të përfshirë në një aksident dhe ndihmën për viktimat e aksidenteve ajrore dhe të afërmit e tyre.

3. Kjo rregullore nuk zbatohet për investigimet e sigurisë në aksidentet dhe incidentet e rënda, që përfshijnë avionë për qëllime ushtarake, doganore, policore apo shërbimeve të ngjashme, përveçse kur Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil vendos ndryshe, në përputhje me nenin 5, pika 4, dhe legjislacionin kombëtar.

Neni 4

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil

1. Ministria përgjegjëse për transportin ajror duhet të garantojë që investigimet e sigurisë në



operim të kryhen ose të mbikëqyren, pa ndërhyrje të jashtme, nga Autoriteti i Investigimit, i cili duhet të jetë i aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur në kryerjen e një investigimi të plotë të sigurisë, qoftë vetë ose nëpërmjet marrëveshjeve me autoritetet e tjera të investigimit të sigurisë.

2. Autoriteti i Investigimit është funksionalisht i pavarur, në mënyrë të veçantë nga autoritetet e aviacionit, të cilat janë përgjegjëse për vlefshmërinë ajrore, certifikimin, operimin e fluturimit, mirëmbajtjen, licencimin, kontrollin e trafikut ajror ose operimin e aerodromit dhe, në përgjithësi, ky autoritet është i pavarur, gjithashtu, nga çdo subjekt apo palë tjetër, interesat e të cilave mund të bien ndesh me detyrën e besuar Autoritetit të Investigimit të sigurisë ose të ndikojnë në objektivitetin e saj.

3. Autoriteti i Investigimit duhet që gjatë kryerjes së investigimeve të sigurisë të mos kërkojë dhe të mos marrë udhëzime nga askush dhe ky autoritet do të ketë pushtet të pakufizuar mbi kryerjen e investigimeve të sigurisë.

4. Veprimet që i janë besuar Autoritetit të Investigimit mund të zgjerohen në mbledhjen dhe analizimin e informacionit të sigurisë së aviacionit nga Këshilli i Ministrave, në mënyrë të veçantë për qëllime të parandalimit të aksidenteve, për aq sa këto veprime nuk ndikojnë në pavarësinë e këtij autoriteti dhe nuk sjellin asnjë përgjegjësi në çështjet rregullatore, administrative ose standardizuese.

5. Me qëllim të informimit të publikut për nivelin e përgjithshëm të sigurisë në aviacion, një pasqyrim i sigurisë do të publikohet çdo vit në nivel kombëtar. Në këtë analizë nuk do të zbulohen burimet e informacionit konfidencial.

6. Autoritetit të Investigimit i garantohen mjetet e nevojshme për të kryer të gjitha përgjegjësitë e tij, në mënyrë të pavarur dhe ai duhet të jetë në gjendje të ketë burime të mjaftueshme për kryerjen e këtyre përgjegjësiave. Në mënyrë të veçantë:

a) drejtori i Autoritetit të Investigimit duhet të ketë përvojë dhe kompetencë në sigurinë e aviacionit civil për të përmbushur detyrat e tij në përputhje me këtë rregullore dhe ligjin kombëtar;

b) investiguesve do t'i jepet një status i posaçëm, me anë të cilit do të kenë garancinë e nevojshme për pavarësi;

c) Autoriteti i Investigimit do të ketë të paktën një investigues në dispozicion, të aftë për të kryer

funksionin e investiguesit në detyrë në rast të një aksidenti të rëndë ajror;

ç) Autoritetit të Investigimit i akordohen fondet përkatëse që i mundëson atij të kryejë funksionet e tij;

d) Autoriteti i Investigimit do të organizohet në mënyrë që të ketë në dispozicion të tij, drejtpërsëdrejti ose me anë të bashkëpunimit të përmendur në nenin 6 ose, nëpërmjet marrëveshjeve me autoritete apo subjekte të tjera kombëtare, një personel të kualifikuar dhe pajisjet e nevojshme, duke përfshirë zyrat dhe hangarët për të mundësuar ruajtjen dhe këqyrjen e avionit, përmbajtjen dhe rrënojat e tij.

Neni 5

Detyrimi për të investiguar

1. Çdo aksident apo incident i rëndë që përfshin një avion, për të cilin zbatohet vendimi nr. 1095, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që përafron rregulloren EU nr. 2018/1139, do të jetë subjekt i investigimit në shtetin në territorin e të cilit aksidenti ose incidenti i rëndë ka ndodhur.

2. Kur një avion, për të cilin zbatohet vendimi nr. 1095, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që përafron rregulloren EU nr. 2018/1139 dhe i cili është regjistruar në Republikën e Shqipërisë, përfshihet në një aksident ose incident të rëndë, vendndodhja e të cilit nuk mund të përcaktohet përfundimisht nëse është në territorin e ndonjë shteti, procesi i investigimit të sigurisë do të caktohet nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil i Republikës së Shqipërisë, si autoriteti i shtetit në të cilin është regjistruar avioni.

3. Shtrirja e investigimit të sigurisë referuar pikave 1, 2 dhe 4, të këtij neni, dhe procedurat që duhet të ndiqen në kryerjen e investigimeve të tilla të sigurisë në operim do të përcaktohen nga Autoriteti i Investigimit, duke marrë parasysh mësimet që priten të nxirren nga investigime të tilla, për përmirësimin e sigurisë së aviacionit, duke përfshirë edhe ata avionë me një masë maksimale ngritjeje më të vogël ose të barabartë me 2250 kg.

4. Autoriteti i Investigimit mund të vendosë të hetojë incidente, përveç atyre të parashikuara në



pikat 1 dhe 2, të këtij neni, si aksidentet ose incidentet e rënda të llojeve të tjera të përplasjeve të avionit, kur ata gjykojnë se prej këtyre investigimeve mund të nxirren mësimet të vlefshme për sigurinë në aviacion.

5. Investigimet e sigurisë bazuar në pikat 1, 2 dhe 4, të këtij neni, nuk duhet të jenë të lidhura në asnjë rast me përcaktimin e fajit ose të detyrimeve. Ato duhet të jenë të pavarura, të ndara dhe të paparagjykuara nga ndonjë proces gjyqësor ose administrativ i përcaktimit të fajësisë ose detyrimeve.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve investiguese të sigurisë në operim

1. Autoriteti i investigimit mund të kërkojë ndihmën e autoriteteve investiguese të sigurisë së shteteve të tjera të ZPEA-së, sipas përcaktimit të marrëveshjes shumëpalëshe, ashtu siç edhe mund t'i kërkojë ndihmë reciprokisht. Kur pas një kërkesë, një autoritet investigimi i sigurisë bie dakord për të ofruar ndihmë, ndihma do të ofrohet falas për aq kohë sa është e mundur.

2. Autoriteti i Investigimit mund ta delegojë detyrën e kryerjes së investigimit të një aksidenti ose incidenti të rëndë kundrejt një autoriteti tjetër të investigimit të sigurisë në varësi të marrëveshjes së përbashkët dhe duhet të lehtësojë procesin e investigimeve të këtij autoriteti.

Neni 7

Rrjeti Evropian i Autoriteteve të Investigimit të sigurisë së Aviacionit Civil

1. Autoriteti i investigimit do të marrë masa që të jetë pjesë e Rrjetit Evropian të Autoriteteve të Investigimit të Sigurisë së Aviacionit Civil (Rrjeti), i cili është i përbërë nga krerët e autoriteteve investiguese të sigurisë në operim në secilin nga shtetet e tjera të ZPEA-së, sipas përcaktimit të marrëveshjes shumëpalëshe dhe/ose, në rastin e një autoriteti multimodal, nga krerët e degës së aviacionit, ose përfaqësuesit e tyre, duke përfshirë edhe një kryetar të zgjedhur në mesin e tyre për një periudhë 3-vjeçare.

2. Pjesëmarrja në rrjet duhet të ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së investigimeve të kryera nga autoritetet e

investigimit të sigurisë dhe për të forcuar pavarësinë e tyre. Në veçanti ajo do të inkurajojë standardet më të larta në metodat e investigimit dhe trajnimit të investiguesve.

3. Me qëllim arritjen e objektivave rrjeti në mënyrë të veçantë kryen:

a) përgatitjen e sugjerimeve dhe këshillimin e institucioneve të BE-së në të gjitha aspektet e hartimit e të zbatimit të politikave dhe rregullave, në lidhje me investigimet e sigurisë dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në BE;

b) promovimin e shkëmbimit të informacionit të dobishëm për përmirësimin e sigurisë së aviacionit dhe promovimin në mënyrë aktive të bashkëpunimit të strukturuar ndërmjet autoriteteve investiguese të sigurisë, Komisionit, EASA-s dhe autoriteteve kombëtare të aviacionit civil;

c) bashkërendimin dhe organizimin, kur është e nevojshme, “komentet e homologëve”, aktivitetet përkatëse të trajnimit dhe programet e zhvillimit për investiguesit;

ç) promovimin e praktikave më të mira investiguese të sigurisë, me qëllim zhvillimin e një metodologjie të përbashkët të investigimit të sigurisë dhe hartimin e një inventari të praktikave të tilla;

d) forcimin e kapaciteteve investiguese të organeve të investigimit të sigurisë, në veçanti, duke zhvilluar dhe menaxhimin e një kornize për ndarjen e burimeve;

dh) sigurimin, me kërkesë të autoriteteve investiguese të sigurisë, me qëllim të zbatimit të nenit 6, të ndihmës së nevojshme, duke përfshirë por jo kufizuar, një listë të investiguesve, pajisjeve dhe kapaciteteve në dispozicion të Republikës së Shqipërisë për përdorim të mundshëm nga autoriteti që kryen investigimin;

e) mundësinë për të pasur akses në informacionet që përmbajnë të dhënat të përmendura në nenin 18 dhe analizimin e rekomandimeve të sigurisë, me qëllim identifikimin e rekomandimeve të rëndësishme të sigurisë, të cilat kanë rëndësi për të gjithë BE-në.

4. Anëtarët e rrjetit nuk kërkojnë dhe nuk pranojnë udhëzime nga ndonjë organ që mund të ndikojë në statusin e pavarur të investigimeve të sigurisë.

5. EASA, sipas rastit, ftohet si vëzhgues në takimet e rrjetit. Rrjeti, gjithashtu, mund të ftojë vëzhgues nga autoritetet investiguese të sigurisë të



vendeve të treta dhe ekspertë të tjerë relevantë për të marrë pjesë në mbledhjet e tij.

Neni 8

Pjesëmarrja e EASA-s dhe autoriteteve kombëtare të aviacionit civil në investigimet e sigurisë në operim

1. Me kusht që të jetë plotësuar kërkesa për mospasjen konflikt interesi, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil do të ftojë EASA-n dhe autoritetin kompetent të aviacionit civil të shteteve të ZPAE-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, brenda qëllimit të kompetencave të tyre përkatëse, të emërojnë një përfaqësues për të marrë pjesë:

a) si këshilltar i investiguesit në detyrë në cilindo investigim të sigurisë, sipas nenit 5, pikat 1 dhe 2, të kryer në territorin e një shteti të ZPAE-së, siç përcaktohet sipas marrëveshjes shumëpalëshe ose në territorin e përmendur në nenin 5, pika 2, nën kontrollin dhe në diskrecionin e investiguesit në detyrë;

b) si këshilltar i caktuar, sipas kësaj rregulloreje, me qëllim që të ndihmojë përfaqësuesin e akredituar të Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil në çdo investigim të sigurisë, të zhvilluar në ato vende që nuk janë vende të BE-së, në të cilin një autoritet investigimi i sigurisë është i ftuar që të caktojë një përfaqësues të akredituar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e rekomanduara për aksidentet dhe investigimin e incidenteve, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesit të akredituar.

2. Pjesëmarrësit e përmendur në pikën 1, të këtij neni, kanë të drejtë, në mënyrë të veçantë:

a) për të vizituar vendin e ngjarjes dhe të shqyrtojnë mbetjet;

b) të sugjerojnë fushat e marrjes në pyetje dhe t'u marrin informacion dëshmitarëve;

c) të marrin kopje të të gjitha dokumenteve përkatëse dhe të marrin informacionin e duhur faktik;

ç) të marrin pjesë në transmetimet e regjistrimeve të medieve, me përjashtim të zërit të kabinës apo imazhit të regjistruar;

d) të marrin pjesë në aktivitetet investiguese jashtë zonës ku ka ndodhur aksidenti apo incidenti i rëndë, siç janë ekzaminimet përbërëse, testet dhe

simulimet, informimet teknike dhe takimet lidhur me progresin e investigimit, përveç kur kanë të bëjnë me përcaktimin e shkaqeve apo formulimin e rekomandimeve të sigurisë.

3. Në rastin kur mbështetje për investigimin i kërkohej në mënyrë analoge Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbështesë investigimin në të cilin do të marrin pjesë, duke mundësuar informacionin e kërkuar, këshilltarët dhe pajisjet për autoritetin e investigimit të sigurisë në detyrë.

Neni 9

Detyrimi për të njoftuar aksidentet dhe incidentet e rënda

1. Çdo person i përfshirë, i cili ka njohuri të ndodhjes së një aksidenti ose incidenti të rëndë, do të njoftojë pa vonesë Autoritetin Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, kur Republika e Shqipërisë është shteti i ngjarjes së aksidentit/incidentit të rëndë.

2. Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil duhet të njoftojë pa vonesë organizatat ndërkombëtare, shtetet anëtare të ZPEA-së dhe vendet e treta të interesuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e rekomanduara, për çdo ngjarje aksidenti dhe incidenti të rëndë, për të cilën është njoftuar.

Neni 10

Pjesëmarrja e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil

1. Pas marrjes së njoftimit të ndodhjes së një aksidenti ose incidenti të rëndë nga një shtet i ZPAE-së ose nga ato vende që nuk janë vende të BE-së, Autoriteti i Investigimit, kur Republika e Shqipërisë është shtet i regjistrimit, shtet i operatorit, shtet i projektimit ose shtet i prodhimit, do të informojë sa më shpejt të jetë e mundur shtetin anëtar ose ato vende që nuk janë vende të BE-së, në territorin e të cilave ka ndodhur aksidenti ose incidenti i rëndë, mbi faktin, nëse ata kanë për qëllim të caktojnë një përfaqësues të akredituar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e rekomanduara. Kur një përfaqësues i tillë i akredituar emërohet, duhet të sigurohen emri,



kontaktet dhe të dhënat e tij, si dhe data e pritshme e mbërritjes në qoftë se përfaqësuesi i akredituar ka për qëllim për të udhëtuar në vendin në të cilin ka dërguar njoftimin.

2. Përfaqësuesit e akredituar për shtetin e projektimit emërohen nga autoriteti investigues i sigurisë së operimit të shtetit, në territorin e të cilit është vendosur veprimtaria kryesore e biznesit të mbajtësit të certifikatës për projektimin e atij tipi të avionit apo pjesëve të tij.

Neni 11

Statusi i investiguesve në detyrë

1. Me emërimin e tij ose të saj nga Autoriteti i Investigimit dhe pavarësisht çdo investigimi gjyqësor, investiguesi në detyrë është i autorizuar për të marrë masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat e investigimit të sigurisë.

2. Pavarësisht nga detyrimet e konfidencialitetit, në bazë dhe për zbatim të ligjit në fuqi, investiguesi në detyrë ka, veçanërisht, të drejtë:

a) të ketë qasje të menjëhershme, të pakufizuar dhe të papenguar në vendin e aksidentit ose incidentit, si dhe në avion mbetjet apo përbërësit e tij;

b) të sigurojë një renditje të menjëhershme të provave dhe heqje të kontrolluar të mbetjeve ose të përbërësve të avionit, për qëllime ekzaminimi dhe analize;

c) të ketë akses të menjëhershëm dhe të përdorë regjistrimet e fluturimit, përmbajtjen e tyre dhe çdo regjistrim tjetër përkatës, për të siguruar një ekzaminim të hollësishëm në kohën e duhur;

ç) të ketë akses në rezultatet e ekzaminimeve mjekësore të viktimave, nëse është e mundur, ose të testeve të bëra me kampionet e marra nga këta persona;

d) të kërkojë shqyrtimin mjekësor të personave të përfshirë në funksionimin e avionëve apo të kërkojë testet që do të kryhen në mostrat e marra nga këta njerëz dhe të ketë qasje të menjëhershme në rezultatet e këtyre ekzaminimeve apo të testeve;

dh) të thërrasë dhe të marrë në pyetje dëshmitarët dhe të kërkojë që ata të japin informacion ose prova relevante për investigimin e sigurisë;

e) të ketë akses në çdo informacion apo të dhënë të rëndësishëm, që mbahet nga pronari, mbajtësi i certifikatës së tipit, projektimit,

organizata përgjegjëse për mirëmbajtjen, organizata e trajnimit, operatori apo prodhuesi i avionit, autoritetet përgjegjëse për aviacionin civil, EASA dhe ofruesit e lundrimit të shërbimit ajror ose operatorët aerodromit.

3. Investiguesi në detyrë do t'iu tregojë ekspertëve dhe këshilltarëve të tij si dhe përfaqësuesve të akredituar të ekspertëve dhe këshilltarëve të tij të drejtat e renditura në pikën 2, të këtij neni, në masën e nevojshme për t'iu mundësuar atyre të marrin pjesë në mënyrë efektive në investigimin e sigurisë. Këto të drejta do të zbatohen pa rënë ndesh me të drejtat e investiguesve dhe ekspertëve të caktuar nga organi kompetent i hetimit gjyqësor.

4. Çdo person, që merr pjesë në investigimet e sigurisë, do të kryejë detyrat e tij në mënyrë të pavarur dhe nuk do të kërkojë e as të pranojë udhëzime nga askush, përveçse nga investiguesi në detyrë ose përfaqësuesit e akredituar.

Neni 12

Koordinimi i investigimeve

1. Kur një hetim penal ka nisur në të njëjtën kohë, investiguesi në detyrë, i ngarkuar me çështjen duhet të njoftohet. Në këtë rast, investiguesi në detyrë duhet të sigurojë gjurmimin dhe të kujdeset për regjistruarin e fluturimit ose për çdo prove tjetër fizike. Organi i prokurorisë mund të caktojë një zyrtar për të asistuar në leximin e regjistruarit të fluturimit apo në trajtimin e provave fizikë të vendngjarjes. Kur një ekzaminim ose analizë në lidhje me provat fizike mund të ndryshohet, të tjetërsohet ose të shkatërrohet, fillimisht do të merret miratimi i organit të prokurorisë, pa rënë ndesh me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Kur ky miratim nuk mund të arrihet, sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, brenda një kohe të arsyeshme dhe jo më vonë se dy javë nga parashtrimi i kërkesës, kjo nuk duhet të pengojë investiguesin në detyrë për përfundimin e ekzaminimit ose të analizave. Kur organi i prokurorisë ka të drejtë të konfiskoje ndonjë provë, investiguesi në detyrë duhet të ketë akses të menjëhershëm dhe të pakufizuar për përdorimin e kësaj prove.

2. Kur në linjën e investigimit të sigurisë bëhet e ditur ose ka dyshime të arsyeshme që një akt i ndërhyrjes së paligjshme, siç parashikohet nga ligji



në fuqi, është i përfshirë në një aksident ose incident të rëndë, investiguesi në detyrë duhet të njoftojë menjëherë autoritetet kompetente. Sipas nenit 14, informacioni përkatës i mbledhur në investigimin e sigurisë duhet të ndahet menjëherë me autoritetet kompetente dhe në bazë të një kërkesë, materiali përkatës mund t'i transferohet këtyre autoriteteve. Shpërndarja e këtij informacioni dhe materiali konkretisht nuk pengon të drejtën e Autoritetit të Investigimit që të vazhdojë investigimin e sigurisë, në përputhje me autoritetet tek të cilat kontrolli i vendndodhjes mund të jetë transferuar.

3. Autoriteti i Investigimit, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër autoritetet që mund të përfshihen në veprimtarinë, në lidhje me investigimin e sigurisë, si autoritetet gjyqësore, aviacioni civil, autoritetet e kërkim-shpëtimit, do të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin përmes marrëveshjeve paraprake.

Këto marrëveshje duhet të respektojnë pavarësinë e Autoritetit të investigimit dhe të lejojnë që investigimet teknike të kryhen me eficiencë dhe profesionalizëm. Veç të tjerash, marrëveshjet paraprake duhet të përfshijnë çështjet e më poshtme:

- aksesit në vendndodhjen e aksidentit;
- ruajtja dhe aksesit në prova;
- statusi për trajtimet fillestare dhe të mëtejshme;
- shkëmbimi i informacionit;
- përdorim i përshtatshëm i informacionit të sigurisë;
- zgjidhje e konflikteve.

Neni 13

Ruajtja e provave

1. Kur aksidenti apo incidenti i rëndë ka ndodhur në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, si dhe organet e përfshira në investigim, që kanë akses në prova, do të garantojnë trajtimin e sigurt të të gjitha provave dhe do të marrin të gjitha masat e arsyeshme për t'i mbrojtur këto prova dhe për të mbajtur të sigurt ruajtjen e avionit, pjesëve të tij dhe mbetjet e përplasjes, për një periudhë sa të jetë e nevojshme për qëllimin e investigimit të sigurisë. Ruajtja e provave duhet të përfshijë ruajtjen me fotografi ose me mënyra të tjera të çdo prove, e cila mund të zhvendoset, të tjetërsohet, të humbasë ose të

shkatërrohet. Ruajtja e sigurt duhet të garantojë mbrojtje kundër dëmeve të mëvonshme, mbrojtje nga aksesit i personave të paautorizuar ose përkeqësimi apo shkatërrimi i provave.

2. Në pritje të investiguesve të sigurisë, askush nuk duhet të modifikojë gjendjen e vendndodhjes së aksidentit, të marrë ndonjë mostër prej aty, të ndërmarrë ndonjë veprim ose të marrë mostra nga avioni i përplasur, pjesët ose mbetjet e tij, t'i vendosë ose t'i rivendosë ato, përveç se kur veprime të tilla kërkojnë të kryhen për arsye sigurie ose janë të nevojshme për t'iu ardhur në ndihmë personave të dëmtuar ose me lejen e menjëhershme të autoriteteve për kontrollin e vendngjarjes, dhe kur është e mundur, në konsultë me Autoritetin Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil.

3. Çdo person i përfshirë duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur dokumentet, materialet dhe regjistrimet, në lidhje me ngjarjen, në veçanti për të parandaluar fshirjen e regjistrimeve të bisedave dhe të alarmeve pas fluturimit.

Neni 14

Mbrojtja e informacionit të ndjeshëm të sigurisë

1. Të dhënat e mëposhtme nuk do të vihen në dispozicion ose të përdoren për qëllime të tjera, përveçse për investigimin e sigurisë:

a) të gjitha deklaratat e marra personave nga Autoriteti i Investigimit për rrjedhën e investigimit të sigurisë;

b) të dhënat që lidhen me zbulimin e identitetit të personave, që kanë dhënë prova në kuadër të investigimit të sigurisë;

c) informacioni i mbledhur nga Autoriteti i Investigimit, i cili është i një natyre veçanërisht të ndjeshme dhe personale, duke përfshirë informacionin, në lidhje me shëndetin e individëve;

ç) materiali i prodhuar pas kohës së investigimeve, i tillë si shënimet, skicat, opinionet e shkruara nga investiguesit, mendimet e shprehura në analizën e informacionit, duke përfshirë informacionin e regjistruar të fluturimit;

d) informacionet dhe dëshmitë e dhëna nga investiguesit e shteteve të BE-së, ose vendeve që nuk janë pjesë e BE-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara, kur



kjo kërkohet nga autoriteti i tyre i investigimit të sigurisë;

dh) projektet paraprake apo përfundimtare të raporteve ose deklaratat e përkohshme;

e) zëri i kabinës dhe regjistrimet e imazheve, si dhe transkriptet e tyre, regjistrimet zanore brenda njësive të kontrollit të trafikut ajror, duke siguruar, gjithashtu, se edhe ai informacion që nuk ka lidhje me investigimin e sigurisë, veçanërisht informacioni që kanë ndikim në jetën private, do të jetë i mbrojtur në mënyrë të përshtatshme, pavarësisht nga pika 3 e këtij neni.

2. Të dhënat në vijim nuk do të vihen në dispozicion ose të përdoren për qëllim tjetër, përveç investigimit të sigurisë ose për qëllime të tjera që synojnë përmirësimin e sigurisë së aviacionit:

a) të gjitha komunikimet ndërmjet personave që kanë qenë të përfshirë në operimin e avionit;

b) regjistrimet elektronike ose me shkrim dhe transkriptet e regjistrimeve nga njësitë e kontrollit të trafikut ajror, duke përfshirë raportet dhe rezultatet e bëra për qëllime të brendshme;

c) letrat shoqëruese me shpjegime për transmetimin e rekomandimeve të sigurisë nga Autoriteti i Investigimit të sigurisë në operim për marrësin, kur kërkohet nga Autoriteti i Investigimit të sigurisë në operim që lëshon rekomandimin;

ç) ngjarjet e raportuara të paraqitura në bazë të rregullave në fuqi për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil.

Regjistrimet e të dhënave lidhur me fluturimin nuk vihen në dispozicion ose përdoren për qëllime të ndryshme nga ato të investigimit të sigurisë, vlefshmërisë ajrore dhe të mirëmbajtjes, përveç rasteve kur të dhëna të tilla janë të nxjerra ose nuk janë më të kufizuara, sipas procedurave të sigurisë.

3. Pavarësisht nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, organet e drejtësisë ose autoriteti kompetent për të vendosur për zbulimin e të dhënave, në përputhje me ligjin kombëtar, mund të vendosin se përfitimet e zbulimit të të dhënave, të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, për çfarëdo qëllimi tjetër të lejuar nga ligji, tejkalojnë ndikimin negativ kombëtar dhe ndërkombëtar, që një veprim i tillë mund të ketë në investigimet aktuale të sigurisë ose në të ardhmen. Organet e drejtësisë mund të vendosin për të kufizuar rastet në të cilat mund të merret një vendim i tillë i zbulimit, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Komunikimi i të dhënave të një shteti tjetër, siç referohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, për qëllime të tjera përveç investigimit të sigurisë, dhe përveç kësaj, në lidhje me pikën 2 të këtij neni, për qëllime të tjera nga ato që synojnë përmirësimin e sigurisë së aviacionit, mund të kryhet për aq sa ligji kombëtar për komunikimin e lejon. Përpunimi ose zbulimi i të dhënave të marra nëpërmjet një komunikimi të tillë nga autoritetet e shtetit pritës duhet të lejohet vetëm pas konsultimit paraprak me Shtetin komunikues dhe në varësi të ligjit kombëtar të shtetit pritës.

4. Vetëm të dhënat e domosdoshme për qëllimet e përmendura në pikën 3 të këtij neni mund të zbulohen.

Neni 15

Komunikimi i informacionit

1. Staf i në detyrë i Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil ose çdokush tjetër i thirrur për të marrë pjesë ose për të kontribuar në investigimin e sigurisë duhet t'u nënshtrohet rregullave të zbatueshme të konfidencialitetit profesional, duke përfshirë edhe rregullat për anonimatën e atyre që janë të përfshirë në një incident ose aksident, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Pa rënë ndesh me detyrimet e paracaktuara në nenet 16 dhe 17, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil duhet të komunikojë informacionin që mendohet se është i rëndësishëm për parandalimin e aksidentit ose të një incidenti të rëndë të personave përgjegjës për avionin ose prodhimin apo mirëmbajtjen e pajisjeve të avionit dhe individëve ose entiteteve ligjore përgjegjëse për funksionimin e avionit dhe trajnimin e personelit.

3. Pa rënë ndesh me detyrimet e përcaktuara në nenet 16 dhe 17, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, si dhe përfaqësuesit e akredituar, referuar nenit 8, duhet të komunikojnë me EASA-n dhe të japin për Autoritetin e Aviacionit Civil informacionin e përshtatshëm faktik, të siguruar gjatë investigimit të sigurisë, përveç informacionit referuar nenit 14, pika 1, ose shkaktuar nga një konflikt interesi. Informacioni i marrë nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të mbrohet në



përputhje me nenin 14 dhe aktet ligjore të zbatueshme.

Neni 16

Raporti i investigimit

1. Çdo investigim i sigurisë do të pasohet nga një raport, në një formë të përshtatshme për llojin dhe rëndësinë e aksidentit ose incidentit të rëndë. Raporti i referohet vetëm qëllimit të investigimit të sigurisë është parandalimi i aksidenteve dhe i incidenteve në të ardhmen, pa përcaktuar fajin apo përgjegjësinë. Raporti përmban, sipas rastit, rekomandimet e sigurisë.

2. Raporti duhet të mbrojë anonimitetin e një individi të përfshirë në një aksident ose incident të rëndë.

3. Kur investigimet e sigurisë mundësojnë nxjerrjen e raporteve përpara përfundimit të investigimit, përpara publikimit të këtyre raporteve, Autoriteti i Investigimit mund të kërkojë komente nga autoritetet e interesuara, duke përfshirë EASA-n, dhe ndërmjet tyre edhe mbajtësit e certifikatës për projektimin, prodhuesit dhe operatorët në fjalë. Ata do t'u nënshtrohen rregullave të aplikueshme të sekretit profesional, në lidhje me përmbajtjen e konsultimit.

4. Përpara publikimit të raportit përfundimtar, Autoriteti i Investigimit do të kërkojë komente nga autoritetet e interesuara, duke përfshirë EASA-n, dhe ndërmjet tyre edhe mbajtësit e certifikatës për projektimin, prodhuesit dhe operatorët në fjalë, të cilët do t'u nënshtrohen rregullave të aplikueshme të sekretit profesional, në lidhje me përmbajtjen e konsultimit. Në marrjen e komenteve të tilla, Autoriteti i Investigimit do të ndjekë standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e rekomanduara.

5. Informacioni i parashikuar nga neni 14 duhet të përfshihet në një raport vetëm kur ky informacion është i rëndësishëm për analizën e aksidentit ose incidentit të rëndë. Informacione ose pjesë të informacionit që nuk kanë lidhje me analizën nuk do të zbulohen.

6. Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil do të bëjë publik raportin përfundimtar në kohën më të shkurtër të mundshme dhe nëse është e mundur brenda 12 muajve nga data e aksidentit apo incidentit të rëndë.

7. Nëse raporti përfundimtar nuk mund të bëhet publik brenda 12 muajsh, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil do të lëshojë një deklaratë të përkohshme, të paktën në çdo përvjetor të aksidentit apo të incidentit të rëndë, duke detajuar progresin e investigimit dhe çdo çështje të ngritur të sigurisë.

8. Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil duhet të dërgojë një kopje të raportit përfundimtar dhe të rekomandimeve të sigurisë sa më shpejt të jetë e mundur tek:

a) organet e investigimit të sigurisë në operim dhe autoritetet e aviacionit civil të shteteve, që kanë lidhje me ngjarjen, dhe ICAO-s, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e rekomanduara;

b) personat, të cilëve iu janë adresuar rekomandimet e sigurisë të përmendura në raport;

c) Komitetit të Përbashkët, sipas parashikimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, përveç rasteve kur raporti është në dispozicion të publikut përmes mjeteve elektronike, dhe, në këtë rast, Autoriteti i investigimit duhet vetëm ta vërë në dijeni.

Neni 17

Rekomandimet e sigurisë në operim

1. Në çdo fazë të investigimit të sigurisë, Autoriteti i Investigimit do të rekomandojë në një letër të datës përcjellëse, pas konsultimit të duhur me palët përkatëse, për autoritetet e interesuara, shtetet e ZPAE-së të përcaktuara, sipas marrëveshjes shumëpalëshe ose vendet që nuk janë pjesë e BE-së, çdo veprim parandalues që ai konsideron që është i nevojshëm dhe që duhet të ndërmerret menjëherë për të rritur sigurinë e aviacionit.

2. Autoriteti i Investigimit mund të nxjerrë, gjithashtu, rekomandime të sigurisë në bazë të studimeve apo të analizave të një serie investigimesh apo çdo veprimtarie tjetër të kryer, në përputhje me nenin 4, pika 4.

3. Rekomandimi i sigurisë, në asnjë rast nuk duhet të krijojë një prezumim të fajit apo të përgjegjësisë për një aksident, incident të rëndë apo incident.



Neni 18

Ndjekja e rekomandimeve të sigurisë në operim dhe e të dhënave të sigurisë

1. Marrësi i një rekomandimi të sigurisë në operim konfirmon marrjen e letrës së përcjellë dhe informon Autoritetin e Investigimit, që ka lëshuar rekomandimin brenda 90 ditëve nga dita e pranimit të kësaj letrë, për veprimet e ndërmarra apo nën shqyrtim, kur është e përshtatshme përcakton kohën e nevojshme për përfundimin e këtyre veprimeve dhe kur nuk ndërmerret asnjë veprim jep arsyet përse.

2. Brenda 60 ditëve nga marrja e përgjigjes, Autoriteti i Investigimit do të informojë marrësin nëse e konsideron ose jo përgjigjen e përshtatshme dhe të japë arsyetim, kur nuk pajtohet me vendimin për të kryer asnjë veprim.

3. Autoriteti i investigimit do të zbatojë procedurat për të regjistruar përgjigjet kundrejt rekomandimeve të lëshuara të sigurisë.

4. Çdo entitet që merr një rekomandim sigurie, duke përfshirë edhe autoritetet përgjegjëse për sigurinë e aviacionit civil në nivel të shteteve anëtare të BE-së do të zbatojë procedurat për të monitoruar progresin e veprimeve të ndërmarra si përgjigje ndaj rekomandimeve të sigurisë që ata kanë marrë.

5. Autoriteti i investigimit do të regjistrojë në depot qendrore të themeluara, sipas rregullave në fuqi për integrimin në një qendër të përbashkët të informacionit rreth ngjarjeve në aviacionin civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara, në përputhje me rregullat në fuqi për raportimin e ngjarjeve, të gjitha rekomandimet e sigurisë të nxjerra, në përputhje me nenin 17, pikat 1 dhe 2, si dhe përgjigjet e tyre. Autoriteti i Investigimit do të regjistrojë në mënyrë të ngjashme në depot qendrore të gjitha rekomandimet e sigurisë të marra nga vendet që nuk janë anëtare të BE-së.

Neni 19

Informacion mbi personat dhe mallrat e rrezikshme në bord

1. Operatorët ajrorë të BE-së, që kryejnë fluturime, të cilët mbërrijnë ose nisen dhe operatorët ajrorë të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së, që kryejnë fluturime që nisen nga një

aeroport i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të zbatojnë procedurat të cilat lejojnë prodhimin:

a) sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se brenda dy orëve nga njoftimi i ndodhjes së një aksidenti të avionit, të një liste të vlefshme, të bazuar në informacionin më të mirë që kanë në dispozicion, të të gjithë personave në bord; dhe

b) menjëherë pas njoftimit të ndodhjes së një aksidenti të një avioni, të listës së mallrave të rrezikshme në bord.

2. Listat e përmendura në pikën 1 të këtij neni do të vihen në dispozicion të Autoritetit të Investigimit për t'u lidhur me të afërmit e personave në bord dhe, kur është e nevojshme, të njëjsteve mjekësore, të cilat mund të kenë nevojë për informacione për trajtimin e viktimave.

3. Në mënyrë që të lejohen të afërmit e udhëtarëve për të marrë informacion të shpejtë në lidhje me praninë e të afërmeve të tyre në bordin e një avioni të përfshirë në një aksident, linjat ajrore do t'u ofrojnë udhëtarëve mundësinë për të dhënë emrin dhe kontaktet e një personi që do të vihet në dijeni në rastin e një aksidenti. Ky informacion mund të përdoret nga shoqëritë ajrore vetëm në rast të një aksidenti dhe nuk do t'u komunikohet palëve të treta ose të përdoret për qëllime komerciale.

4. Emri i një personi në bord nuk do të bëhet publik para se të afërmit e atij personi të jenë informuar nga autoritetet përkatëse. Lista e përmendur në pikën 1(A) do të mbahet konfidenciale, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe emri i secilit person që paraqitet në atë listë do të bëhet publik vetëm në masën për të cilën, të afërmit e personave përkatës në bord nuk kanë kundërshtuar.

Neni 20

Asistenca për viktimat e aksidenteve ajrore dhe të afërmit e tyre

1. Për të siguruar një përgjigje më të plotë dhe të harmonizuar ndaj aksidenteve në nivel evropian, Autoriteti i Investigimit do të krijojë një plan për aksidentet emergjente të aviacionit civil në nivel kombëtar. Një plan i tillë emergjent duhet të mbulojë ndihmën për viktimat e aksidenteve të aviacionit civil dhe të afërmit e tyre.



2. Republika e Shqipërisë duhet të sigurohet që të gjitha linjat ajrore të vendosura në territorin e saj kanë një plan për ndihmën ndaj viktimave të aksidenteve të aviacionit civil dhe të afërmit të tyre. Këto plane duhet të marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, mbështetjen psikologjike për viktimat e aksidenteve të aviacionit civil dhe të afërmit e tyre dhe do të lejojnë linjat ajrore të reagojnë ndaj një aksidenti të rëndë. Autoriteti i investigimit do të auditojë planet e ndihmës së linjave ajrore të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe duhet të inkurajojë linjat ajrore të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së që të veprojnë së bashku për të miratuar një plan në mënyrë të ngjashme, për ndihmën e viktimave të aksidenteve të aviacionit civil dhe të afërmit e tyre.

3. Kur ndodh një aksident, shteti në krye të investigimeve, shteti në të cilin linja ajrore e avionit të të cilit është i përfshirë në aksident është themeluar, ose shteti që kishte një numër të madh të shtetasve të tij në bordin e avionit të përfshirë në aksident, do të sigurojë emërimin e një personi të referencës, si një pikë kontakti dhe informator për viktimat dhe të afërmit e tyre.

4. Shtetet e ZPAE-së ose në një vend që nuk është anëtar i BE-së, i cili për shkak të vdekjeve apo lëndimeve të rënda ndaj qytetarëve të tij, ka një interes të veçantë në një aksident që ka ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të emërojë një ekspert, i cili ka të drejtë të:

- a) të vizitojë vendin e ngjarjes;
- b) të ketë qasje në informatat përkatëse faktike, të cilat janë miratuar për publikimet publike nga autoriteti investigativ përgjegjës i sigurisë, si dhe në informacionin mbi progresin e investigimit;
- c) të marrë një kopje të raportit përfundimtar.

5. Një ekspert i emëruar në përputhje me pikën 4, të këtij neni mund të asistojë, në përputhje të legjislacionit të zbatueshëm në identifikimin e viktimave dhe të marrë pjesë në takime me të mbijetuarit e shtetit të tij.

6. Në përputhje me pikën 1, të nenit 2, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, edhe transportuesit ajrorë të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së do të përmbushin detyrimet e sigurisë të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 21

Aksesi në dokumente dhe mbrojtja e të dhënave personale

Kjo rregullore zbatohet pa rënë ndesh dhe në përputhje me rregullat në fuqi për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

ANEKS

LISTA ME SHEMBUJT E INCIDENTEVE TË RËNDA

Incidentet e listuara më poshtë janë shembuj tipikë të incidenteve, që kanë të ngjarë të jenë incidente të rënda. Lista nuk është shteruese dhe shërben vetëm si udhëzim, në lidhje me përkufizimin e “incidentit të rëndë”:

- Një përplasje në afërsi, që kërkon një manovër shmangieje për të mënjанuar një përplasje apo një situatë të pasigurt ose kur një veprim i shmangies do të ishte i përshtatshëm;

- Një përplasje në afërsi të kërkuar një manovër shmangieje për të shmangur një përplasje apo një situatë të pasigurt ose kur një veprim i shmangies do të ishte i përshtatshëm;

- Fluturimi i kontrolluar në terren vetëm pak i evitueshëm;

- Ndërprerja e ngritjes së avionit në një pistë të mbyllur apo të zënë, në një rrugë lidhëse, duke përjashtuar operacionet e autorizuara me helikopterë ose nga një pistë e pacaktuar;

- Ngritja e një avioni nga një pistë e mbyllur apo të zënë, nga një rrugë lidhëse, duke përjashtuar operacionet e autorizuara me helikopterë ose nga një pistë e pacaktuar;

- Uljet ose tentativat për ulje në një pistë të mbyllur ose të zënë, në një rrugë lidhëse, duke përjashtuar operacionet e autorizuara me helikopterë ose nga një pistë e pacaktuar;

- Dështimet e rënda për të arritur performancën e parashikuar gjatë ngritjes ose në momentin fillestarë të ngritjes;

- Zjarret dhe tymi në pjesën e pasagjerëve, në pjesën e ngarkesave ose zjarret në motor, edhe pse këto zjarre janë shuar nga përdorimi i agjentëve zjarrfikës;

- Ngjarjet që kërkojnë përdorimin emergjent të oksigjenit nga ana e ekuipazhit të fluturimit;



- Defektet strukturore të avionit ose shpërbërja e motorit, duke përfshirë defektet e kanalizuar në turbinën e motorit, të cilat nuk klasifikohen si aksident;

- Disa keqfunksionime të shumë sistemeve të një sistemi të avionit që ndikojnë seriozisht në funksionimin e avionit;

- Paaftësia e ekuipazhit të fluturimit në fluturim;

- Sasia e karburantit që kërkon deklarin e një emergjence nga piloti;

- Inkursionet e pistës të klasifikuara sipas shkallës së ashpërsisë A, në bazë të manualit për parandalimin e inkursioneve në pistë (ICAO Doc 9870), i cili përmban informacion mbi klasifikimet e shkallëve të ashpërsisë;

- Incidentet e ngritjeve ose të uljeve. Avioni afrohet shumë poshtë, ulja në pistë para zonës së uljes, dalja nga pista ose drejtimin më shpejt se komanda e dhënë;

- Dështimet e sistemit, fenomenet e motit, operacionet jashtë zonave të aprovuara të fluturimit apo dukuri të tjera, të cilat mund të kishin shkaktuar vështirësi në kontrollin e avionit;

- Dështimi i më shumë se një sistemi në një sistem teprice, të detyrueshëm për drejtimin e fluturimit dhe të lundrimin.

VENDIM

Nr. 740, datë 3.12.2021

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR BASHKËPUNIMIN E PËRBASHKËT NË ARSIMIN E LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunimin e përbashkët në arsimin e lartë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**



Memorandum Mirëkuptimi
mbi Bashkëpunimin e Përbashkët në Arsimin e Lartë
ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe
Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës, në vijim referuar si nënshkruesit,

Bazuar në Marrëveshjen për bashkëpunim kulturor dhe arsimor midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, nënshkruar në Madrid më 25 nëntor 1999,

Duke dëshiruar të intensifikojnë marrëdhëniet dypalëshe, bazuar në vlerësimin e tyre për rëndësinë e arsimit si një faktor kyç për zhvillimin dhe besimin e tyre, se në veçanti nga bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë do të përfitojnë të dy nënshkruesit,

Të dy nënshkruesit propozojnë si më poshtë:

SEKSIONI 1

Nënshkruesit do të shkëmbejnë informacion mbi sistemet e tyre arsimore, si bazë për të përforcuar marrëdhëniet e tyre. Këto përfshijnë organizimin e vizitave dhe shkëmbimin e informacionit mbi arsimin e lartë, duke përfshirë kërkimin e tij shkencor, sistemet e tyre përkatëse të kualifikimit, konferencat arsimore, forumet dhe diskutimet në panele të mbajtura në të dy vendet.

SEKSIONI 2

Të dy nënshkruesit po punojnë në forcimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, duke përfshirë kërkimin shkencor, si dhe për të inkurajuar institucionet e tyre që të zhvillojnë sistemet e arsimit të lartë në mënyrë reciproke.

SEKSIONI 3

Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë e Republikës së Shqipërisë përmes Zyrës Kombëtare Erasmus + do të punojë së bashku me Ministrinë e Universiteteve të Mbretërisë së Spanjës përmes Agjencisë Spanjolle të Shërbimit për Ndërkombëtarizimin e Arsimit (SEPIE), për të lehtësuar zhvillimin e programeve



të mobilitetit dhe shkëmbimin akademik midis institucioneve të arsimit të lartë të të dy vendeve.

SEKSIONI 4

Nënshkruesit kuptojnë se aktivitetet e informacionit dhe bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të lartë përfshijnë studentët, mësuesit, studiuesit dhe personelin jo-mësimdhënës të të dy vendeve.

SEKSIONI 5

Për të arritur qëllimet e këtij memorandum, nënshkruesit do të veprojnë si më poshtë:

- A. Shkëmbejnë përvoja në fushën e arsimit të lartë.
- B. Sigurojnë më shumë vëmendje për njerëzit e talentuar.
- C. Inkurajojnë partneritete dhe marrëveshje midis universiteteve nga të dy vendet.
- D. Ofrojnë bursa sipas mundësive që disponojnë të dy vendet.
- E. Shkëmbejnë informacion dhe publikime në fushën e arsimit të lartë, si dhe publikime në lidhje me sistemin e arsimit të lartë të secilit vend.
- F. Organizojnë konferenca, takime, seminare dhe kumtesa shkencore të përbashkëta, me kusht që ato të jenë të koordinuara me Palën tjetër, dhe që kjo e fundit të informohet paraprakisht në një periudhë të arsyeshme kohore.
- G. Bashkëpunojnë në fusha të tjera të propozuara dhe miratuara nga të dy nënshkruesit.

SEKSIONI 6

Nënshkruesit do të punojnë për:

- A. Mbikëqyrjen e shkëmbimit të studentëve të arsimit të lartë në programe bachelor, master dhe doktoraturë.
- B. Shkëmbimin e profesorëve dhe studiuesve vizitorë për të trajtuar disa plane shkencore, të kërkuesve të institucioneve të arsimit të lartë, ekzaminuesve dhe rezidentëve për projekte kërkimore dhe shkencore.



C. Shkëmbimin e personelit jo-mësimdhënës që dëshiron të studiojë në institucionet e arsimit të lartë në të dy vendet.

SEKSIONI 7

Aktivitetet që lindin nga ky Memorandum nuk do të sjellin ndonjë kosto të veçantë financiare.

Aty ku është e zbatueshme, kostot financiare që lindin si rezultat i këtyre aktiviteteve do të përfshihen në buxhetet vjetore të dy Ministrive, në përputhje me legjislacionin e të dy vendeve.

SEKSIONI 8

Nënshkruesit do të përcaktojnë detajet, organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi, me krijimin e një komiteti pasues që do të takohet mbi baza të rregullta, duke caktuar me shkrim vendin dhe datën e takimeve të tij. Ky komitet do të përgatisë programet e hollësishme të bashkëpunimit me të cilët do të përcaktojë dhe identifikojë kushtet e bashkëpunimit në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi, duke kryer kontrollin e zbatimit të tij, vlerësimin dhe dhënien e udhëzimeve të nevojshme që synojnë zbatimin e tij efikas.

SEKSIONI 9

Të drejtat e pronësisë intelektuale

A. Nënshkruesit do të marrin përsipër të respektojnë të drejtat dhe të sigurojnë zbatimin e plotë të të drejtave të pronësisë intelektuale, në përputhje me ligjet kombëtare të secilit vend, para fillimit të çdo aktiviteti të përbashkët.

B. Rezultatet e hulumtimeve dhe patentave të shpikjes që rezultojnë nga një bashkëpunim i tillë, do të jenë të drejtat e nënshkruesve dhe rezultatet mund të botohen në revista shkencore vendase dhe ndërkombëtare, me pëlqimin e nënshkruesve.

C. Të gjitha korrespondencat dhe komunikimet në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi do të bëhen me shkrim midis dy vendeve.

**SEKSIONI 10****Dispozitat përfundimtare**

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk është ligjërish i detyrueshëm dhe as nuk prodhon detyrime sipas së Drejtës Ndërkombëtare.

Çdo ndryshim, objekt miratimi paraprak midis nënshkruesve, duhet t'i bashkëngjitet si një Shtojcë, e cila do të ishte pjesë e qenësishme e këtij Memorandumi, duke treguar datën nga e cila ndryshimi për të cilin është rënë dakord, duhet të jetë i zbatueshëm.

SEKSIONI 11

Çdo mosmarrëveshje midis nënshkruesve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore, përmes këshillimit dhe negociatave midis të dy nënshkruesve dhe pa u apeluar tek palët e treta ose arbitrazhi ndërkombëtar.

SEKSIONI 12

Ky Memorandum do të fillojë zbatimin e tij që nga data e nënshkrimit, për një periudhë pesëvjeçare, dhe rinovohet në mënyrë të heshtur për periudha të njëpasnjëshme prej pesë vjetësh, përveç rastit kur njëra Palë njofton Palën tjetër me shkrim përmes kanaleve diplomatike paraprakisht gjashtë muaj përpara, me synimin për të përfunduar këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Në fund të zbatimit të këtij Memorandumi, çdo program në vazhdim do të vijojë, përveç në rastet e forcave madhore.

Nënshkruar në Madrid më 4 tetor 2021 në dy kopje në gjuhët shqipe, spanjolle dhe angleze, të dyja janë njësoj të vlefshme. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë

Edi Rama

KRYEMINISTËR

Për Qeverinë e Mbretërisë së
Spanjës

Pedro Sánchez Pérez-Castejón

PRESIDENTI I QEVERISË



VENDIM
Nr. 741, datë 3.12.2021

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHETETËRORE TË
SISTEMIT TË PROVIMIT TË SHETITIT
(SPSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit (SPSH).

2. Institucioni administrues i kësaj baze të dhënash shtetërore është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

3. Të dhënat e bazës shtetërore të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) të dhënat parësore të SPSH-së konsiderohen të dhënat e mbledhura nga QSHA-ja, që kanë të bëjnë me:

i. profesionin/profilin e kandidatit për provim shteti;

ii. numrin e pjesëmarrjeve në provim shteti;

iii. foton digjitale gjatë procedurës së hyrjes në provim;

iv. rezultatet e testimit dhe përgjigjet e dhëna nga kandidatët për çdo profesion/profil;

v. institucionin e arsimit të lartë (IAL), ku kandidati që do të kryejë provimin e shtetit ka kryer studimet e ciklit të parë “*Bachelor*” dhe/ose studimet e ciklit të dytë;

vi. vitin e diplomimit (viti kur ka përfunduar studimet e ciklit të parë “*Bachelor*” dhe/ose studimet e ciklit të dytë kandidati që do të kryejë provimin e shtetit);

vii. postën elektronike/numrin e telefonit të kandidatit, ku do të marrë njoftime nga sistemi për statusin e aplikimit;

viii. drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP)/zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), nga vjen kandidati i regjistruar për kryerjen e provimit të shtetit;

ix. fondet e pyetjeve të profesioneve/profileve me elementet specifike të kapitujve/pyetjeve;

x. procesverbalet e vendimet e mbajtura nga komisionet e provimit të shtetit dhe provimet e tjera të digjitalizuara për saktësime dhe ndryshime në pyetje, për skualifikime dhe parregullsi gjatë seancave të provimeve;

xi. ID-në e aplikimit të kandidatit (e vendosur në mënyrë automatike nga sistemi), nëpërmjet të cilës kandidati gjurmon statusin e aplikimit;

b) të dhënat dytësore të SPSH-së konsiderohen të dhënat që merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, si më poshtë vijon:

i. numri i identitetit;

ii. emri, atësia, mbiemri;

iii. datëlindja;

iv. gjinia;

v. shtetësia;

vi. vendlindja;

vii. vendbanimi.

4. Dhënës të informacionit për SPSH-në janë:

a) ZVAP-të, DRAP-të:

i. për të dhëna në lidhje me diplomat e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve;

b) urdhrat profesionalë:

i. për listën emërore në lidhje me profilin e provimit të shtetit të kandidatëve;

c) IAL-të:

i. për të dhëna lidhur me programet e studimit që ofrohen nga ana e tyre;

ç) hartuesit e fondeve të pyetjeve:

i. për fondin e pyetjeve të provimit të shtetit për profesionet e rregulluara;

d) komisionet e provimit të shtetit:

i. për programet orientuese dhe fondin e pyetjeve të provimit të shtetit për profesionet e rregulluara;

dh) palë të tjera të interesuara që mund të kërkojnë kryerjen e provimeve të digjitalizuara pranë QSHA-së.

5. Subjekte për sistemin SPSH janë kandidatët për provimin e shtetit, ZVAP-të, DRAP-të, urdhrat profesionalë, institucionet e arsimit të lartë, ministritë përgjegjëse, komisionet e provimit të shtetit, si dhe palë të tjera të interesuara për kryerjen e provimeve të digjitalizuara pranë QSHA-së, sipas kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

6. Sistemi SPSH ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.



7. Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen jo më tepër sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

8. Niveli i aksesit të lejuar për përdoruesit e SPSH-së përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) menaxher përdoruesish (QSHA):

i. krijon përdorues e cakton rolet dhe të drejtat;

ii. kontrollon veprimtarinë e përdoruesve;

b) administrator sistemi (QSHA):

i. krijon sezonin e provimit;

ii. krijon strukturat e provimeve;

iii. krijon seancat për provime;

iv. gjeneron raporte dhe statistika;

v. ngarkon fondin e pyetjeve;

c) administrator salle (QSHA) që fut kandidat për provim sipas listës emërore;

ç) menaxher pagesash (QSHA) që kontrollon nëse kandidatët për provim shteti kanë kryer pagesën e duhur;

d) menaxher aplikimesh (ZVAP):

i. verifikon dokumentacionin e aplikantit për provim shteti;

ii. pas konfirmimit të dokumentacionit, përgatitet lista emërore e kandidatëve, e cila dërgohet pranë drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar respektiv;

dh) menaxher aplikimesh (DRAP):

i. verifikon dokumentacionin e aplikantit për provim shteti nga zyra vendore e arsimit parauniversitar vartës;

ii. pas konfirmimit të dokumentacionit, përgatit listën emërore të kandidatëve, e cila dërgohet edhe pranë QSHA-së në rrugë zyrtare;

e) menaxher aplikimesh (urdhrrat profesionale):

i. verifikon dokumentacionin e aplikantit për provim shteti;

ii. pas konfirmimit të dokumentacionit, përgatitet lista emërore e kandidatëve, e cila dërgohet edhe pranë QSHA-së në rrugë zyrtare.

9. Palët do të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem, lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj. duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe të konfidencialitetit të të dhënave.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, institucionet arsimore parauniversitare, ministratë përgjegjëse, si autoritetet kompetente të profesioneve të rregulluara, dhe urdhrat profesionale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 742, datë 3.12.2021

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË
SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË
INFORMACIONIT PARAUNIVERSITAR
(SMIP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore SMIP është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

3. Të dhënat e bazës shtetërore të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) të dhënat parësore të SMIP-së konsiderohen të dhënat e mbledhura nga QSHA-ja, që kanë të bëjnë me:

i. të dhënat e institucionit arsimor parauniversitar:

- emërtimi zyrtar i institucionit;
- akti zyrtar për krijimin e institucionit;
- NIPT-i i institucionit;
- vendndodhja;
- nivelet e arsimit parauniversitar;
- shkolla vartëse (nëse ka);
- të dhënat për godinën;



- infrastruktura e shkollës;

ii. të dhënat për kontratat e punës së mësuesve dhe nivelin e kualifikimit të tyre;

iii. të dhënat për kurikulat në arsimin parauniversitar;

iv. të dhënat për numrin e institucioneve arsimore parauniversitare, të nxënësve dhe të mësuesve;

b) të dhënat dytësore të SMIP-së konsiderohen të dhënat që merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, si më poshtë vijon:

i. numri i identifikimit personal;

ii. emri, atësia, mbiemri;

iii. datëlindja, vendlindja.

4. Dhënës të informacionit për SMIP-në janë institucionet arsimore parauniversitare, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe ministria përgjegjëse për arsimin.

5. Subjekte për sistemin SMIP janë institucionet arsimore parauniversitare, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

6. Sistemi SMIP ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

7. Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

8. Niveli i aksesimit në sistemin SMIP bazohet në rolet e krijuara të përdoruesve:

a) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit:

i. shikon, krijon, modifikon kurikulën për arsimin profesional;

ii. shikon, krijon, modifikon lëndët kurikulare;

iii. kopjon/aktivizon kurikulat për vitin shkollor pasardhës;

b) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar:

i. shikon, krijon, modifikon kurikulën për arsimin parauniversitar,

ii. shikon, krijon, modifikon lëndët kurikulare,

iii. kopjon/aktivizon kurikulat për vitin shkollor pasardhës;

c) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar:

i. shikon, modifikon, fshin institucionet në varësi;

ii. shikon, modifikon të dhënat e punonjësve në varësi;

iii. gjeneron raporte dhe statistika për institucionet e punonjësit në varësi;

ç) Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar:

i. shikon, krijon, modifikon, fshin shkollat në varësi;

ii. shikon, krijon, modifikon të dhënat e punonjësve në varësi;

iii. shikon nxënësit e shkollave në varësi;

iv. gjeneron raporte dhe statistika për institucionet e punonjësit në varësi;

d) ministria përgjegjëse për arsimin:

i. shikon, modifikon institucionet dhe punonjësit në varësi;

ii. shikon listën e nxënësve për shkollat në varësi;

iii. gjeneron raporte dhe statistika;

dh) ministria përgjegjëse për arsimin profesional:

i. shikon, modifikon institucionet dhe punonjësit në varësi;

ii. shikon listën e nxënësve për shkollat në varësi;

iii. gjeneron raporte dhe statistika;

e) Qendra e Shërbimeve Arsimore ka të drejtë të plotë në administrimin e sistemit;

ë) administratori i shkollës:

i. shikon, modifikon, shton të dhënat e shkollës;

ii. implementon kurikul në nivel shkolle dhe klase;

iii. gjeneron raporte dhe statistika;

iv. gjeneron dëftesa dhe certifikata;

v. shikon transferimet e nxënësve;

vi. shikon temat mësimore;

vii. shikon ecurinë shkollore për vitin shkollor;

f) mësuesi:

i. shikon, modifikon, shton planin mësimor;

ii. shton temat mësimore;

iii. administron regjistrin për lëndën që jep mësim;

iv. administron klasën në kujdestari;

g) prindërit shohin të dhënat e fëmijës/fëmijëve së/të regjistruar në sistem si nxënës (ecurinë në shkollë).

9. Palët do të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht



kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe të konfidencialitetit të të dhënave.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 743, datë 3.12.2021

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHETETËRORE TË
SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË
MATURËS SHETETËRORE (SVMSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shetetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shetetërore të Sistemit të Vlerësimit të Maturës Shetetërore (SVMSH).

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shetetërore të SVMSH-së është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

3. Të dhënat e bazës shetetërore të SVMSH-së ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) të dhëna parësore të SVMSH-së konsiderohen të dhënat e krijuara dhe të mbledhura nga QSHA-ja, që kanë të bëjnë me:

i. të dhënat që i posedon institucioni arsimor në lidhje me maturanët, të cilat hidhen në sistem nga

mbikëqyrësi i shkollës, në mënyrë që të gjenerohet ID-ja unike, e cila identifikon maturanin/kandidatin në sistem, gjatë plotësimit të formularit;

ii. vlerësimin në provimet e maturës;

iii. qendrat për zhvillimin e provimeve të Maturës Shetetërore;

iv. listat e provimeve të Maturës Shetetërore;

v. përcaktimin e notave të shkallëzuara në varësi të pikëve të fituara;

b) të dhënat dytësore të SVMSH-së konsiderohen të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore. Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, si më poshtë vijon:

i. numri i identifikimit personal;

ii. emri, atësia, mbiemri;

iii. datëlindja e vendlindja.

4. Dhënës të informacionit për SVMSH-në janë institucionet arsimore parauniversitare, ZVAP-të, maturanët/kandidatët e çdo institucioni arsimor parauniversitar dhe ministria përgjegjëse për arsimin.

5. Subjekte për SVMSH-në janë maturanët/kandidatët, ministria përgjegjëse për arsimin, institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të cilat nuk kanë akses në sistem.

6. Sistemi i SVMSH-së ndërvepron me bazën e të dhënave shetetërore, në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

7. Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

8. Niveli i aksesimit për subjektet e interesuara për SVMSH-në përcaktohet nga akses i lejuar për përdoruesit e këtij sistemi. Punonjësit e autorizuar të QSHA-së kanë akses të plotë në sistem. Mbikëqyrësi, punonjës i institucionit arsimor, ka rolin e krijimit të formularëve dhe të pasurimit të databazës tek *user*-i përkatës i institucionit arsimor, duke pasur akses të kufizuar në sistem, duke u emërtuar në sistem si mbikëqyrës i formularëve. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar kanë akses në sistem vetëm për të deklaruar mbetësit vjetorë, që raportohen nga shkollat.

9. Palët marrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër



e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem, lidhur me aksesin, ndryshimin, korigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe të konfidencialitetit të të dhënave.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 59, datë 24.11.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR LICENCIMIN E
INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE DHE
INSTITUCIONEVE TË PARASË
ELEKTRONIKE, SI DHE PËR
REGJISTRIMIN E OFRUESVE TË
SHËRBIMEVE TË PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3; nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 46 dhe nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 4, 7, 8, 9, 13, 14, 15, 21, 28 dhe 31, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; dhe të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2022.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONEVE TË
PAGESAVE DHE INSTITUCIONEVE TË
PARASË ELEKTRONIKE, SI DHE PËR
REGJISTRIMIN E OFRUESVE TË
SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objkti

Objkti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kërkesave, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për:

a) licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë;

b) regjistrimin në regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë, që përfitojnë nga përjashtimet sipas përcaktimeve në nenin 4, shkronjat “g” dhe “h”, si dhe në nenin 28, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

c) dhënien e miratimeve nga ana e Bankës së Shqipërisë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtyre subjekteve; dhe

d) detyrimet për njoftime nga ana e subjekteve në Bankën e Shqipërisë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:



a) nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) nenit 4, pika 46 dhe nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, (i cili në këtë rregullore do të quhet ligji “Për bankat”);

c) neneve 4, 7, 8, 9, 13, 14, 15, 21, 28 dhe 31, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” (i cili, në këtë rregullore do të quhet ligji “Për shërbimet e pagesave”);

d) nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë:

a) institucionet e pagesave, siç përcaktohen në pikën 13, të nenit 5, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”. Shoqëritë e kursim-kreditit që do të ushtrojnë veprimtarinë edhe si institucion pagesash, mund të ofrojnë shërbimet e pagesave vetëm për anëtarët e tyre;

b) institucionet e parasë elektronike, siç përcaktohen në pikën 46, të nenit 4, të ligjit “Për bankat”;

c) ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, siç përcaktohen në pikën 27, të nenit 5, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

d) ofruesit e shërbimeve që kryejnë një veprimtari sipas shkronjave “g” dhe “h”, të nenit 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, siç parashikohet në nenin 62 dhe 63, të kësaj rregulloreje.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe në ligjin “Për bankat”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “agjent i institucionit të parasë elektronike” - është personi fizik ose juridik, i cili vepron në emër dhe për llogari të një institucioni të parasë

elektronike, për shpërndarjen dhe ripagimin e fondeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve të pagesave. Institucioni i parasë elektronike nuk mund të emetojë para elektronike nëpërmjet agentëve;

b) “aksione të mbajtësit (*bearer shares*)” - janë aksione të një personi juridik, pronësia e të cilave i kalon personit që zotëron/mban certifikatën / dokumentin e aksioneve të mbajtësit, pa pasur nevojë për marrëveshje/kontratë për kalimin e pronësisë së këtyre aksioneve;

c) “aksionar përfaqësues (*nominee shareholder*)” - është aksionari i regjistruar i një personi juridik, që mban aksionet në emër të aksionarit aktual (pronarit përfitues), në bazë të një marrëveshjeje;

d) “bankë guaskë” - ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

3. Termat “kapital aksionar”, “këshill administrimi/mbikëqyrës” dhe “aksionar/ortak” të përdorur në këtë rregullore për institucionet e pagesave, do të nënkuptojnë përkatësisht termat “kapital”, “këshill drejtues” dhe “anëtar”, për shoqëritë e kursim-kreditit që do të licencohen si institucione pagesash.

KREU II LICENCIMI I INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE DHE INSTITUCIONEVE TË PARASË ELEKTRONIKE

NËNKREU I KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 5 Kapitali fillestar minimal

1. Shuma përkatëse e kapitalit fillestar minimal të paguar, të kërkuar për t’u licencuar si institucion i pagesave, është si më poshtë:

a) kur institucioni i pagesave do të ofrojë vetëm shërbimin e pagesave të parashikuar në pikën 6, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, jo më pak se 2.5 milionë lekë;

b) kur institucioni i pagesave do të ofrojë vetëm shërbimin e pagesave të parashikuar në pikën 7, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, jo më pak se 6.5 milionë lekë;

c) kur institucioni i pagesave do të ofrojë shërbimet e pagesave të parashikuar në pikat 1–5,



të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, jo më pak se 16 milionë lekë.

2. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionet e pagesave, që kërkojnë të ofrojnë 2 (dy) ose më shumë lloje shërbime pagesash nga ato të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të jetë i barabartë me vlerën që i përket nivelit më të lartë të kapitalit të kërkuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionet e parasë elektronike është 45 (dyzet e pesë) milionë lekë.

4. Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal, çdo shtesë e mëvonshme e tij, si dhe çdo ndryshim në strukturën e kapitalit të institucionit të pagesave dhe të institucionit të parasë elektronike shoqërohet me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të parashikuar përkatësisht në nenin 26 dhe në nenin 45, të kësaj rregulloreje.

5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e krijimit të kontributeve/fondeve që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal ose si shtesë e mëvonshme e tij.

6. Në rast se Banka e Shqipërisë konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se struktura e kapitalit apo burimi i tij lidhet me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, që kanë lidhje familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, sipas përcaktimeve ligjore, me aksionarët/ortakët e propozuar, apo lidhet me shoqëri të regjistruara në parajsa fiskale ose *offshore*, njofton dhe kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nëse ka informacion në lidhje me aksionarët/ortakët e propozuar, si dhe pezullon procedurën e licencimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit.

Neni 6

Karakteristikat e licencës

1. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

2. Licenca e institucionit të pagesave dhe e institucionit të parasë elektronike përfshin emrin tregtar të subjektit, numrin dhe datën e lëshimit të saj, si edhe ka si pjesë përbërëse të saj aneksin e

veprimtarive dhe të shërbimeve, për të cilat subjekti licencohet.

3. Licenca e institucionit të pagesave përfshin, përveç emrit të subjektit, edhe emërtimin “institucion i pagesave”.

4. Licenca e institucionit të parasë elektronike përfshin, përveç emrit të subjektit, edhe emërtimin “institucion i parasë elektronike”.

Neni 7

Kriteret për dhënien ose refuzimin e licencës

1. Banka e Shqipërisë merr vendim për dhënien e licencës vetëm kur krijon bindjen se subjekti plotëson kërkesat e nenit 13, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës kur nuk plotësohen kërkesat e nenit 13, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje, duke marrë në konsideratë edhe situatat e mëposhtme:

a) të paktën njëri nga themeluesit me pjesëmarrje influencuese ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paafëtisë paguese ose falimentimit;

b) nuk paraqitet informacion lidhur me identitetin e themeluesve me pjesëmarrje influencuese;

c) vërtetohet se të paktën njëri nga themeluesit:

i. është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

ii. është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizmit;

iii. kur ndaj tij është marrë vendimi nga gjykata për moslejimin e ushtrimit të profesionit;

iv. zotëron aksione të mbajtësit (*bearer shares*), ose është aksionar përfaqësues (*nominee shareholder*) (nëse është e aplikueshme);

v. ka një strukturë komplekse të pronësisë dhe kontrollit;

vi. është një bankë guaskë;

vii. paraqet rrezik të lartë, bazuar në vlerësimet e Bankës së Shqipërisë.



3. Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës, në çdo rast, kur gjykon se licencimi i subjektit do të cenonte interesat e publikut.

4. Banka e Shqipërisë, për të kryer vlerësimet e parashikuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar dhe për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Tatim-Taksave, etj.

Neni 8

Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për licencim

1. Banka e Shqipërisë, për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, bën shqyrtimin e dokumenteve të paraqitura, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon dhënien e licencës si institucion i pagesave ose si institucion i parasë elektronike, brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë.

Data e pranimit të kërkesës për licencë konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuessit nga Banka e Shqipërisë.

3. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune, do të dërgojë një njoftim për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje, së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacion shtesë.

4. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga subjekti, brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë. Në rast të ndërprerjes së procedurës së

shqyrtimit të kërkesës për licencë, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin.

5. Banka e Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë sipas kërkesave të parashikuara në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe në këtë rregullore, si dhe pas plotësimit të informacionit shtesë sipas pikës 4 të këtij neni:

a) shqyrton dhe analizon dokumentacionin e paraqitur;

b) vlerëson aftësinë profesionale dhe integritetin e administratorëve;

c) organizon, nëse e çmon të nevojshme, takime me administratorët e institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike, për të diskutuar mbi dokumentacionin dhe informacionin e paraqitur.

6. Banka e Shqipërisë mund të inspektojë mjediset/zyrat ku do të kryhen veprimtaritë për të cilat subjekti kërkon të licencohet, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e këtyre veprimtarive, në zbatim të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

7. Dokumentacioni i parashikuar në këtë rregullore duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni duhet të jetë edhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

8. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

9. Banka e Shqipërisë, nëse e gjykon të arsyeshme, mund të kërkojë paraqitjen e vërtetimeve të përditësuara mbi gjendjen gjyqësore, ndjekjen penale dhe gjendjen e detyrimeve tatimore të lëshuara nga organet kompetente, në rast se afati i vlefshmërisë së dokumentacionit të paraqitur përfundon para datës së miratimit të licencës, regjistrimit dhe miratimeve të tjera.

Neni 9

Botimi i vendimit për dhënien e licencës

1. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për dhënien e licencës për të vepruar si institucion i pagesave ose si institucion i parasë elektronike.

2. Vendimi botohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.



3. Banka e Shqipërisë regjistron në regjistrin e subjekteve të licencuara institucionin e pagesave, institucionin e parasë elektronike, si dhe listën e agjentëve të tyre (nëse është e aplikueshme), me të dhënat përkatëse, në zbatim të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 10 Komisionet

1. Subjekti që kërkon dhënien e licencës, për të vepruar si institucion i pagesave ose si institucion i parasë elektronike, paguan një komision për përpunimin e kërkesës për licencë prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh, në Bankën e Shqipërisë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.

2. Komisioni, i përcaktuar në këtë nen, nuk rimbursohet edhe në rast të refuzimit të dhënies së licencës nga Banka e Shqipërisë.

Neni 11 Shfuqizimi i licencës

1. Banka e Shqipërisë shfuqizon licencën e institucionit të pagesave dhe të institucionit të parasë elektronike, në rast se plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 15, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

2. Vendimi i shfuqizimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

3. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike ndalohet të kryejë veprimtaritë e parashikuara në licencën e tij, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë për shfuqizimin e saj.

4. Banka e Shqipërisë publikon në Buletinin Zyrtar të saj vendimin për shfuqizimin e licencës, për të vepruar si institucion i pagesave ose si institucion i parasë elektronike, si dhe bën ndryshimet përkatëse në regjistrin e subjekteve të licencuara.

NËNKREU II

KËRKESAT NË LIDHJE ME DOKUMENTACIONIN, PËR SUBJEKTET QË APLIKOJNË PËR LICENCIM SI INSTITUCION PAGESE

Neni 12 Kërkesa të përgjithshme

1. Kërkesat e parashikuara në këtë nënkre, zbatohen për subjektet që aplikojnë për licencim si institucion pagese, të cilët kërkojnë të ofrojnë çdo shërbim të parashikuar në pikat 1-7, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, ose shërbimin e parashikuar në pikën 8, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, së bashku me shërbime të tjera pagesash. Subjektet që kërkojnë të ofrojnë vetëm shërbimin e parashikuar në pikën 8, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, zbatojnë kërkesat për ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, të parashikuara në kreun III të kësaj rregulloreje.

2. Shoqëritë e kursim-kreditit, që paraqesin kërkesën për t'u licencuar si institucione pagesash, zbatojnë të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë rregullore për institucionet e pagesave, me përjashtim të kërkesave të nenit 5, pika 4; nenit 26; neneve 66–68 dhe nenit 73, të kësaj rregulloreje, për të cilat do të zbatohen kërkesat e parashikuara përkatësisht në nenin 5, pika 8; nenin 6, pika 2, shkronjat “e”, “f” dhe “g”, nenet 13–15 dhe në nenin 33/1, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”.

3. Kërkesa për licencim si institucion i pagesave bëhet me shkrim nga themeluesit ose administratori i subjektit, ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre (sipas formularit nr. 1 të kësaj rregulloreje). Kërkesa shoqërohet nga formularët e plotësuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacioni i parashikuar në nenin 7, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në nenet 13–30 të kësaj rregulloreje.

4. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese paraqet pranë Bankës së Shqipërisë informacion, sipas kërkesave të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje, i cili është i vërtetë, i plotë, i saktë dhe i përditësuar.



5. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, për paraqitjen e dokumentacionit/informacionit të kërkuar në Bankën e Shqipërisë, në lidhje me aktet/ procedurat apo dokumentet e brendshme të veprimtarisë, ekstrakton/ nxjerr/ shkëput seksionet përkatëse të këtyre akteve/procedurave apo dokumenteve, si dhe paraqet referencat ndaj këtyre seksioneve, sipas kërkesave përkatëse të parashikuara në këtë rregullore.

6. Në rastet kur Banka e Shqipërisë kërkon sqarime të mëtejshme mbi dokumentacionin/informacionin e paraqitur, aplikuesi duhet t'i paraqesë këto sqarime brenda një kohe të arsyeshme/të përshtatshme.

Neni 13

Kërkesat mbi të dhënat identifikuese të subjektit

1. Subjekti që aplikon për licencim, si institucion pagese, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë të dhënat identifikuese sipas formularit nr. 3 të kësaj rregulloreje, të cilat përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e shoqërisë/subjektit që aplikon dhe, nëse është i ndryshëm, emrin tregtar;

b) ekstraktin e regjistrimit tregtar për regjistrimin e subjektit si person juridik, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të për të cilën/at subjekti kërkon të licencohet, si dhe Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS);

c) statutin e shoqërisë;

d) adresën e selisë qendrore të aplikuesit;

e) adresën e postës elektronike dhe faqen zyrtare të internetit të aplikuesit (nëse ka);

f) emrin/at e personit/personave të autorizuar për ndjekjen e aplikimit dhe procedurës së licencimit, si dhe të dhënat e tyre të kontaktit;

g) informacion nëse aplikuesi është aktualisht ose ka qenë ndonjëherë subjekt i rregullimit e mbikëqyrjes së një autoriteti tjetër mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare;

h) informacion nëse aplikuesi është anëtar ose planifikon të anëtarësohet në ndonjë shoqatë, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave, në rast se është e aplikueshme.

Neni 14

Kërkesat për informacion mbi programin e veprimtarive

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “a”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë programin e veprimtarive (operacioneve), i cili përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të detajuar të llojit të shërbimeve të pagesave të parashikuara, duke përfshirë një shpjegim mbi mënyrën se si veprimtaritë që do të ofrohen, identifikohen nga aplikuesi se përshtaten me ndonjë nga kategoritë e shërbimeve të pagesave të parashikuara në aneksin 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

b) informacion nëse aplikanti do të zotërojë/posedojë në ndonjë moment fondet (e marra nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave të ofruara);

c) një përshkrim të mënyrës së ekzekutimit të shërbimeve të ndryshme të pagesave, duke detajuar të gjitha palët e përfshira në transaksion, si dhe duke përfshirë për çdo shërbim pagese që do të ofrohet, elementet e mëposhtme:

i. një skemë të rrjedhjes/flukseve të fondeve, me përjashtim të rasteve kur aplikuesi kërkon të ofrojë vetëm shërbimin e inicimit të pagesës;

ii. kontratat e shlyerjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si nënpjesëmarrës në sistemet e pagesave, me përjashtim të rasteve kur aplikuesi kërkon të ofrojë vetëm shërbimin e inicimit të pagesës;

iii. projektkontratat midis të gjitha palëve të përfshira në ofrimin e shërbimit të pagesave, përfshirë edhe skemat e pagesave me kartë, nëse janë të aplikueshme;

iv. kohën e përpunimit;

d) një kopje të kontratës tip, siç përcaktohet në nenin 5, pika 19, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

e) numrin e parashikuar të degëve në të cilat aplikuesi parashikon të ofrojë shërbimet e pagesave dhe/ose të zhvillojë veprimtaritë e lidhura me shërbimet e pagesave, nëse është e aplikueshme;

f) një përshkrim të shërbimeve operacionale dhe ndihmëse të shërbimeve të pagesave të parashikuara në nenin 19, pika 1, shkronja “a”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, që do të ofrojë (nëse është e aplikueshme). Në rastin kur subjekti



do të ofrojë veprimtarinë e operimit të sistemeve të pagesave, duhet të paraqesë informacion të mjaftueshëm pranë Bankës së Shqipërisë mbi planin e tij të biznesit, në lidhje me operimin e sistemeve të pagesave, pjesëmarrësit në sistem dhe shërbimet e ofruara në lidhje me këtë aktivitet, me qëllim vlerësimin e aplikimit të nenit 20, pika 2 ose 3, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

g) një deklaratë nëse aplikuesi ka për qëllim të japë kredi siç parashikohet në nenin 19, pika 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, dhe nëse po, brenda cilit kufi;

h) informacion nëse aplikuesi ka për qëllim të ofrojë për tre vitet e ardhshme, ose nëse ofron tashmë veprimtari tregtare, siç përcaktohen në nenin 19, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, përfshirë një përshkrim të llojit dhe volumit të parashikuar të veprimtarive;

i) informacionin e përcaktuar në udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, në përputhje me nenin 7, pikat 2, 3 dhe 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, kur aplikuesi synon të ofrojë shërbimet e pagesave sipas pikave 7 dhe 8 (shërbimi i inicimit të pagesës dhe shërbimi i informimit të llogarisë), të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

j) informacion për investimet në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të shoqëruar me listën e pajisjeve, programeve, etj.

Neni 15

Kërkesat mbi planin e biznesit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “b”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë, planin e biznesit, i cili përmban:

a) një analizë të pozicionit konkurrues të subjektit në segmentin përkatës të tregut të pagesave;

b) një përshkrim të kategorive të përdoruesve të shërbimeve të pagesave;

c) një parashikim të gjendjes financiare të subjektit për 3 vitet e para të veprimtarisë, që tregon se aplikuesi është në gjendje të sigurojë ushtrimin e një veprimtarie të qëndrueshme, që përfshin:

i. një parashikim të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe të bilancit kontabël dhe shpjegime të zërave kryesorë të tyre, duke përfshirë edhe informacion mbi supozimet për vëllimin ose vlerën e transaksioneve, numrin e klientëve, çmimin e shërbimit, vlerën mesatare të një transaksioni, rritjen e parashikuar të fitimit, etj.;

ii. një parashikim të pasqyrës së ndryshimeve në kapital;

iii. një skemë dhe ndarje të hollësishme të flukseve të parashikuara të parasë për tri vitet e ardhshme;

d) një parashikim vjetor të përbërjes sipas zërave, të kapitalit rregullator, për tre vitet e para të veprimtarisë, të llogaritur në përputhje me metodën e përcaktuar në nenin 11, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur aplikuesi kërkon të ofrojë vetëm shërbimin e inicimit të pagesës ose vetëm shërbimin e inicimit të pagesës dhe shërbimin e informimit të llogarisë;

e) një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës (tregues të kujdesit, raporte, etj.) për 3 (tre) vitet e ardhshme;

f) nëse subjekti ka ushtruar një veprimtari tjetër, përpara aplikimit për licencimin si institucion pagese, pasqyrat financiare vjetore të audituara për tri vitet paraardhëse, dhe në rastin e një shoqërie më të re, pasqyrat financiare të audituara, që nga krijimi.

Neni 16

Kërkesat mbi organizimin strukturor

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “h”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një përshkrim të organizimit strukturor të shoqërisë, që përmban:

a) një organigramë të detajuar të strukturës organizative, duke paraqitur çdo njësi, departament, ose ndarje të ngjashme strukturore, në të cilën përcaktohen emrat e personave përgjegjës dhe përshkrimet e funksioneve dhe përgjegjësi, veçanërisht të personave të ngarkuar me funksionet e kontrollit të brendshëm;

b) një parashikim të numrit të përgjithshëm të punonjësve për tre vitet e ardhshme;

c) kopje të marrëveshjeve me të tretët për transferimin e funksioneve operationale të



shërbimit të pagesave, si dhe një përshkrim të këtyre marrëveshjeve, që përmban:

i. identitetin dhe vendndodhjen gjeografike të ofruesit të shërbimit;

ii. identitetin e personave brenda institucionit të pagesave, të cilët janë përgjegjës për secilin nga shërbimet e ofruara nga të tretët;

iii. një përshkrim të detajuar të shërbimeve të ofruara nga të tretët dhe karakteristikave kryesore të tyre;

d) një përshkrim mbi degët dhe agjentët, kur është e aplikueshme, duke përfshirë:

i. një parashikim të kontrolleve në distancë dhe në vend, për t'u kryer të paktën çdo vit, në degët dhe agjentët, si dhe frekuencën e këtyre kontrolleve;

ii. sistemet e teknologjisë së informacionit, proceset dhe infrastrukturën e përdorur nga agjentët e aplikuesit që do të veprojnë për llogari të aplikuesit;

iii. në rastin e agjentëve, kriteret e përzgjedhjes së tyre, procedurat e monitorimit dhe trajnimet për agjentët;

iv. informacion mbi plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë për degët dhe/ose agjentët, sipas rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare, dhe për transportin e vlerave monetare”, në rast se subjekti do të ushtrojë veprimtarinë e shërbimeve të pagesave, me sportel dhe/ose me agjentë;

e) informacion nëse subjekti është pjesëmarrës në një sistem pagesash kombëtare dhe/ose ndërkombëtare;

f) listën e personave fizikë apo juridikë, me lidhje të ngushta me aplikuesin, së bashku me identitetin e tyre dhe natyrën e këtyre lidhjeve.

Neni 17

Kërkesat për evidencën e kapitalit fillestar minimal

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në lidhje me evidencën për kapitalin fillestar minimal të kërkuar, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “c”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj, të licencuar nga Banka e Shqipërisë, që subjekti ka bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit

të kërkuar sipas nenit 5, të kësaj rregulloreje. Kjo shumë, zhbllkohet nëpërmjet njoftimit të Bankës së Shqipërisë, në përfundim të procedurës së licencimit.

Neni 18

Kërkesat për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave

1. Për subjektet që kërkojnë të ofrojnë shërbimet e pagesave sipas pikave 1 deri në 6, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, të cilët i mbrojnë fondet e marra prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave, nëpërmjet depozitimit të fondeve në një llogari të veçantë në bankë apo nëpërmjet investimit në aktive likuide dhe me rrezik të ulët, subjekti aplikues paraqet një përshkrim të masave të marra për mbrojtjen e fondeve, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili duhet të përmbajë:

a) një përshkrim të politikës së investimit, për të siguruar se aktivet e zgjedhura për investim janë likuide dhe me rrezik të ulët, nëse është e aplikueshme;

b) numrin e personave të cilët kanë akses në llogarinë e fondeve të mbrojtura dhe funksionet e tyre;

c) një kopje të projektkontratës tip me bankën / at;

d) një deklaratë të institucionit të pagesave për përputhshmërinë me nenin 12, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” (sipas formularit nr. 12 të kësaj rregulloreje).

2. Për subjektet që kërkojnë të ofrojnë shërbimet e pagesave, sipas pikave 1 deri në 6, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, të cilët i mbrojnë fondet e marra prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave nëpërmjet një police sigurimi ose ndonjë garancie tjetër të krahasueshme nga një shoqëri sigurimi ose nga një bankë, subjekti aplikues paraqet një përshkrim të masave të marra për mbrojtjen e fondeve, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili duhet të përmbajë:

a) një konfirmim nga vetë subjekti që polica e sigurimit ose garancia tjetër e krahasueshme me të, nga një shoqëri sigurimi ose nga një bankë, është lëshuar nga një subjekt që nuk i përket të njëjtit grup të institucionit të pagesave (të aplikuesit);



b) detaje të procesit të rakordimit për të siguruar se polica e sigurimit ose ndonjë garanci tjetër e krahasueshme me të, është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e aplikuesit për mbrojtjen e fondeve në çdo kohë;

c) kohëzgjatjen dhe rinovimin e siguracionit/garancisë;

d) një kopje të projekt marrëveshjes së sigurimit ose të projektkontratës së garancisë së krahasueshme.

Neni 19

Kërkesat mbi sistemin e drejtimit dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “d”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një përshkrim të sistemit të drejtimit dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm, që përfshin:

a) një përshkrim të llojeve të rreziqeve të identifikuar nga aplikuesi (përfshirë edhe për degët dhe agjentët, nëse është e aplikueshme), si dhe të procedurave që aplikuesi do të zbatojë për vlerësimin dhe parandalimin e këtyre rreziqeve;

b) procedurat për kryerjen e kontrolleve periodike dhe të vazhdueshme, duke përfshirë frekuencën e këtyre kontrolleve dhe burimet njerëzore në dispozicion;

c) procedurat kontabël nëpërmjet të cilave aplikuesi do të regjistrojë dhe do të raportojë informacionin financiar;

d) identitetin e personit/personave përgjegjës për funksionin e kontrollit të brendshëm, përfshirë kontrollin periodik dhe të vazhdueshëm, dhe për funksionin e përputhshmërisë, si edhe një *curriculum vitae* (CV) të përditësuar të këtyre personave;

e) përbërjen e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të komitetit të kontrollit, si dhe të ndonjë komiteti tjetër në nivel këshilli administrimi / mbikëqyrës (nëse është e aplikueshme);

f) një përshkrim të mënyrës së monitorimit dhe kontrollit të funksioneve operationale të transferuara tek të tretët (*outsourcing*), me qëllim që të parandalohet çdo cenim i cilësisë së kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave;

g) një përshkrim të mënyrës se si monitorohen dhe kontrollohen agjentët ose degët, brenda kuadrit të kontrollit të brendshëm të aplikuesit;

h) një përshkrim të organeve drejtuese dhe të subjekteve që përbëjnë grupin, në rastin kur aplikuesi është filial i një subjekti të rregulluar nga një shtet tjetër.

Neni 20

Kërkesat mbi procedurat për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e ngjarjeve që cenojnë sigurinë, dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një përshkrim të procedurave të hartuara për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e një ngjarjeje që cenon sigurinë, dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë, i cili duhet të përmbajë:

a) masat organizative dhe mjetet për parandalimin e mashtrimit;

b) të dhënat e personave përgjegjës dhe të organeve përgjegjëse të aplikuesit, për të asistuar klientët në rastet e mashtrimit, të problemeve teknike dhe/ose të administrimit të ankesave/pretendimeve;

c) linjat e raportimit në rast mashtrimi;

d) personin e kontaktit për klientët, përfshirë emrin dhe adresën elektronike;

e) procedurat për raportimin e incidenteve, përfshirë komunikimin e këtyre ngjarjeve tek organet përkatëse, të brendshme dhe të jashtme, përfshirë njoftimin në Bankën e Shqipërisë për incidentet madhore, në përputhje me nenin 89, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe me aktet nënligjore përkatëse;

f) instrumentet e monitorimit që do të përdoren dhe masat e procedurave për ndjekjen e zbutjes së rreziqeve të sigurisë.

Neni 21

Kërkesat mbi procesin e regjistrimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të të drejtave të hyrjes në të dhënat sensitive të pagesës

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “e”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një përshkrim të procesit të



regjistrimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të të drejtave të hyrjes (aksesit) në të dhënat sensitive të pagesës, i cili duhet të përmbajë:

a) një përshkrim të rrjedhës së të dhënave, të klasifikuara si të dhëna sensitive të pagesës, në kontekstin e modelit të biznesit të institucionit të pagesës;

b) procedurat për autorizimin e së drejtës së hyrjes në të dhënat sensitive të pagesës;

c) një përshkrim të instrumenteve të monitorimit;

d) politikën e të drejtave të hyrjes, duke detajuar të drejtat e hyrjes (aksesit) në të gjitha sistemet dhe komponentët e infrastrukturës përkatëse, përfshirë bazën e të dhënave dhe infrastrukturën e *back-up-it*;

e) një përshkrim të mënyrës së regjistrimit të të dhënave të grumbulluara, me përjashtim të rasteve kur aplikuesi kërkon të ofrojë vetëm shërbimin e inicimit të pagesës;

f) përdorimin e brendshëm dhe të jashtëm të të dhënave të grumbulluara, përfshirë ato nga kundërpartitë, me përjashtim të rasteve kur aplikuesi kërkon të ofrojë vetëm shërbimin e inicimit të pagesës;

g) sistemin e teknologjisë së informacionit (IT) dhe masat teknike të sigurisë të zbatuara, përfshirë enkriptimin dhe/ose përdorimin e dy ose më shumë faktorëve të autentifikimit (*tokenisation*);

h) identifikimin e personave, organeve dhe/ose komiteteve me të drejta hyrjeje në të dhënat sensitive të pagesave;

i) një shpjegim si gjurmohen/zbulohen dhe adresohen incidentet apo shkeljet/thyerjet e konfidencialitetit dhe integritetit të informacionit;

j) programin vjetor të kontrollit të brendshëm, në lidhje me sigurinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Neni 22

Kërkesat mbi planin e vazhdimësisë së biznesit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “ë”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një përshkrim të planit të vazhdimësisë së biznesit, i cili përbëhet nga informacioni i mëposhtëm:

a) një analizë të ndikimit në biznes, përfshirë proceset e biznesit dhe objektivat e rimëkëmbjes, të

tilla si: objektivat mbi kohën e rimëkëmbjes, objektivat për pikën e rimëkëmbjes dhe aktivet e ruajtura/mbrojtura, përfshirë edhe informacionin;

b) identifikimi i ambienteve dytësore (*back-up*) në rast të aktivizimit të planit të vazhdimësisë së biznesit, të drejtave të hyrjes në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, si dhe matricën e të drejtave të hyrjes në programin/programet bazë (*key software*) dhe të dhënat kryesore që do të shërbejnë për rimëkëmbjen, në rast ndërprerjeje të veprimtarisë apo fatkeqësie/katastrofe;

c) një shpjegim të mënyrës sipas së cilës aplikuesi do të trajtojë ngjarje të rëndësishme të vazhdueshmërisë apo ndërprerjes së veprimtarisë, siç është mosfunksionimi i sistemeve kryesore, humbja e të dhënave kryesore, pamundësia për të hyrë në mjediset e punës, apo humbja e personave kyç (kryesorë) të subjektit;

d) frekuenca me të cilën aplikuesi synon të testojë planet e vazhdimësisë së biznesit dhe të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, përfshirë mënyrën se si do të regjistrohen rezultatet e testimit;

e) një përshkrim të masave zbutëse që do të përdoren nga aplikuesi, në rast të përfundimit të ofrimit të shërbimeve të pagesës, për të siguruar ekzekutimin e transaksioneve të pagesave në proces dhe përfundimin e kontratave ekzistuese.

Neni 23

Kërkesat për mbledhjen e të dhënave statistikore për ecurinë e veprimtarisë, transaksionet dhe mashtrimet

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “f”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një përshkrim të parimeve dhe përcaktimeve që do të zbatohen për mbledhjen e të dhënave statistikore, për ecurinë e veprimtarisë, transaksionet dhe mashtrimet, që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) llojin e të dhënave të mbledhura, në lidhje me klientët, llojin e shërbimit të pagesave, kanalin, instrumentin dhe monedhën;

b) të dhënat lidhur me aktivitetet dhe subjektet përkatëse, përfshirë degët dhe agjentët;

c) mënyrën e mbledhjes së të dhënave;

d) qëllimin e mbledhjes së të dhënave;

e) frekuencën e mbledhjes së të dhënave;



f) dokumentet shoqëruese, të tilla si një udhëzues që përshkruan mënyrën e funksionimit të sistemit.

Neni 24

Kërkesat mbi dokumentin e politikës së sigurisë

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “g”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë një dokument të politikës së sigurisë, që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një vlerësim të detajuar të rreziqeve, të lidhur me shërbimet e pagesave që aplikuesi kërkon të ofrojë, i cili duhet të përfshijë edhe rreziqet e mashtrimit dhe kontrollin e sigurisë, dhe masat zbutëse të marra për të mbrojtur në mënyrën e duhur përdoruesit e shërbimeve të pagesave ndaj rreziqeve të identifikuar;

b) një përshkrim të sistemeve të teknologjisë së informacionit, që përfshin:

i. arkitekturën e sistemeve dhe elementeve të rrjetit të tyre;

ii. sistemet e teknologjisë së informacionit të biznesit që mbështesin aktivitetet e biznesit, si faqen e internetit të aplikuesit, portofolat e klientëve (*wallets*), mënyrën e funksionimit të pagesave, mënyrën e administrimit të rrezikut dhe të rasteve të mashtrimit dhe të identifikimit dhe kontabilizimit të klientëve;

iii. sistemet mbështetëse të teknologjisë së informacionit, që përdoren për organizimin dhe administrimin e aplikuesit, të tilla si: sistemi kontabël, sistemet e raportimit sipas kërkesave rregullatore, administrimi i personelit, administrimi i marrëdhënieve me klientët, serverët e postës elektronike dhe serverët e dokumenteve/skedarëve të brendshëm;

iv. informacion nëse këto sisteme përdoren tashmë nga aplikuesi apo grupi i tij, si dhe data e parashikuar e zbatimit, nëse është e aplikueshme;

c) llojin e kontakteve/lidhjeve të autorizuar nga jashtë, të tillë si lidhjet me bashkëpunëtorët/partnerët, ofruesit e shërbimeve, subjektet e grupit dhe punonjësit që punojnë në distancë, duke përfshirë arsyen/argumentimin e këtyre kontakteve/lidhjeve;

d) për secilin prej kontakteve të renditura në shkronjën “c”, masat dhe mekanizmat logjike të sigurisë, të krijuara, duke specifikuar kontrollin që

aplikuesi do të ketë mbi këtë të drejtë hyrjeje/aksesi, si dhe natyrën dhe frekuencën e secilit kontroll, atij teknik kundrejt atij organizativ, atij parandalues kundrejt atij gjurmues, dhe monitorimin në kohë reale kundrejt rishikimeve rutinë/periodike, si përdorimi i një rrjeti aktiv të ndarë nga grupi, hapja/mbyllja e linjave të komunikimit, konfigurimi i mjeteve/pajisjeve të sigurisë, gjenerimi i çelësve (*keys*) ose certifikatave të autentifikimit, monitorimi i sistemit, autentifikimi, konfidencialiteti i komunikimit, zbulimi i ndërhyrjeve, sistemet antivirus dhe regjistrat e aksesimeve (*logs*);

e) masat dhe mekanizmat logjike të sigurisë që rregullojnë të drejtën e hyrjes/aksesit të brendshëm në sistemet e teknologjisë së informacionit, të cilat duhet të përfshijnë:

i. natyrën teknike dhe organizative, si dhe frekuencën e çdo mase, nëse masa është e natyrës parandaluese apo zbuluese, si dhe nëse është ndërmarrë ose jo në kohë reale;

ii. mënyrën si trajtohet ndarja e mjediseve të klientit, kur burimet e teknologjisë së informacionit janë të përbashkëta;

f) masat dhe mekanizmat e sigurisë fizike të ambienteve/ndërtesës dhe qendrës së të dhënave të aplikuesit, të tilla si kontrolli i të drejtës së hyrjes/aksesit dhe sigurisë së mjedisit;

g) sigurinë e proceseve të pagesave, e cila duhet të përfshijë:

i. procedurën e autentifikimit të klientit të përdorur si për hyrjen (aksesin), me qëllim këshillimin, ashtu edhe për kryerjen e transaksioneve, si dhe për të gjithë instrumentet bazë të pagesave;

ii. një shpjegim për mënyrën se si realizohet dërgimi i sigurt të përdoruesit i ligjshëm i shërbimit të pagesave dhe integriteti i faktorëve të autentifikimit, të tillë si pajisjet për gjenerimin e fjalëkalimeve me një përdorim (*hardware tokens*) dhe aplikacionet për *mobile banking*, si në kohën e regjistrimit fillestar, ashtu edhe të rinovimit;

iii. një përshkrim të sistemeve dhe procedurave që aplikuesi zbaton për analizën e transaksionit dhe identifikimin e transaksioneve të dyshimta ose të pazakonta;

h) një vlerësim të detajuar të rreziqeve në lidhje me shërbimet e pagesave, përfshirë rrezikun e mashtrimit, duke e lidhur me kontrollin dhe masat zbutëse të përcaktuara/përshkruara në dokumentin



e aplikimit, të cilat sigurojnë adresimin e duhur të tyre (rreziqeve);

i) procedurat kryesore në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit të aplikuesit, ose për procedurat që nuk janë formalizuar ende, një datë e parashikuar për përfundimin/finalizimin e tyre, të cilat marrin në konsideratë edhe kërkesat e rregullores “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”.

Neni 25

Kërkesat mbi mekanizmat e kontrollit të brendshëm, për zbatimin e kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “gj”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë, një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, që aplikuesi ka krijuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili duhet të përmbajë:

a) vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit të lidhur me veprimtarinë e aplikuesit, përfshirë rreziqet që lidhen me bazën e klientëve të aplikuesit, produktet dhe shërbimet e ofruara, kanalet e shpërndarjes dhe zonën gjeografike ku do të ushtrojë veprimtarinë;

b) masat për zbutjen e rreziqeve dhe për përmbushjen e kërkesave ligjore e rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë procesin e vlerësimit të rrezikut nga aplikuesi, politikat dhe procedurat për të qenë në përputhje me kërkesat për zbatimin e vigjilencës ndaj klientit, si dhe për identifikimin dhe raportimin e transaksioneve apo veprimtarive të dyshimta;

c) sistemet dhe kontrollet e aplikuesit, të cilat sigurojnë që degët dhe agentët e tij veprojnë në përputhje me kërkesat në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;

d) mekanizmat e aplikuesit, të cilat sigurojnë që punonjësit dhe agentët janë të trajnuar në mënyrën e duhur për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

e) identitetin e personit/ave që do të jenë përgjegjës për të siguruar përputhshmërinë e aplikantit me kërkesat ligjore e rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe evidencën që ekspertiza e tij/tyre, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është e përshtatshme për të mundësuar përmbushjen e këtij roli në mënyrë efektive;

f) sistemet dhe kontrollet e aplikuesit, të cilat sigurojnë që politikat dhe procedurat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të jenë të përditësuara në vazhdimësi, efektive dhe të përshtatshme;

g) sistemet dhe kontrollet e aplikuesit, të cilat sigurojnë që agentët nuk e ekspozojnë aplikuesin ndaj rritjes së rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;

h) manualin për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit për punonjësit e aplikuesit.

Neni 26

Kërkesat mbi identitetin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese në kapital

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, për qëllime të plotësimit të kërkesave mbi identitetin dhe evidencën e përshtatshmërisë së aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese në kapitalin e aplikuesit (institucionit të pagesave), në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “i”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të grupit të cilit i përket aplikuesi dhe informacion mbi shoqërinë mëmë, nëse është e aplikueshme;

b) një skemë që paraqet strukturën e aksionarëve/ortakëve të aplikuesit, që përfshin:

i. emrin dhe përqindjen e pjesëmarrjes (në kapital/të drejtat e votës) të çdo personi që zotëron pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në kapitalin e aplikuesit, duke evidentuar personat që konsiderohen si aksionarë/ortakë me pjesëmarrje influencuese dhe arsyen e këtij kualifikimi;

ii. emrin dhe përqindjen e pjesëmarrjes (në kapital/të drejtat e votës) të çdo personi që zotëron pjesëmarrje të tërthortë në kapitalin e aplikuesit, duke evidentuar personat që konsiderohen si



aksionarë/ortakë me pjesëmarrje influencuese të tërthortë në kapital dhe arsyen e këtij kualifikimi;

c) një listë të emrave të personave që zotërojnë pjesëmarrje influencuese në kapitalin e aplikuesit, duke specifikuar për çdo person:

i. numrin dhe llojin e aksioneve ose të kuotave në kapital, të nënshkruara;

ii. vlerën nominale të këtyre aksioneve ose kuotave në kapital.

2. Në rastin kur një person, që zotëron pjesëmarrje influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në kapitalin e aplikuesit, është individ ose person fizik tregtar, subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm lidhur me identitetin dhe përshtatshmërinë e këtij personi:

a) emrin e personit, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë, numrin personal të identifikimit ose numrin e pasaportës, adresën dhe kopje të dokumentit zyrtar të identifikimit;

b) për individin, një *curriculum vitae* (CV) të detajuar, që paraqet informacion mbi arsimimin dhe trajnimet, eksperiencat profesionale të mëparshme, largimet nga puna dhe veprimtaritë profesionale apo funksione të tjera aktuale (sipas formularit nr. 4 të kësaj rregulloreje);

c) vërtetimet e mëposhtme, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial:

i. se personi nuk është në ndjekje penale;

ii. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii. se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe

iv. nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;

d) deklaratë personale mbi ndonjë rast paafësie paguese dhe që nuk ka qenë përgjegjës për falimentimin, ose procedura të ngjashme të ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;

e) vërtetim ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent nga organet kompetente të shtetit të huaj, të lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;

f) deklaratë për çdo refuzim ose revokim nga një autoritet mbikëqyrës/Banka e Shqipërisë ose subjekt i sektorit publik në sektorin e shërbimeve

financiare, apo çdo përjashtim nga një shoqatë profesionistësh;

g) një listë të shoqërive tregtare që personi drejton ose kontrollon, përqindjen e kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në këto shoqëri, statusin e tyre (nëse janë aktive, kanë pushuar së vepruari, etj.);

h) rezultatit e vlerësimit, në rastin kur është kryer një vlerësim i reputacionit të personit nga Banka e Shqipërisë ose nga një autoritet mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare, përfshirë identitetin e atij autoriteti;

i) pasqyra/të dhëna financiare të audituara nga audituesit ligjorë për tri vitet e fundit (sipas formularit nr. 11 të kësaj rregulloreje);

j) për personat fizikë tregtarë, ekstrakti i regjistrimit në regjistrin tregtar dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale;

k) deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje);

l) një deklaratë nëse personi është person i ekspozuar politikisht dhe nëse ka lidhje me persona të ekspozuar politikisht, sipas përcaktimeve në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (sipas formularit nr. 10 të kësaj rregulloreje).

3. Në rastin kur një person apo subjekt që zotëron pjesëmarrje influencuese, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në kapitalin e aplikuesit, është person juridik, subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm, lidhur me identitetin dhe përshtatshmërinë e këtij personi:

a) emrin e subjektit;

b) ekstraktin e regjistrimit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht, sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

c) adresën e selisë qendrore;

d) të dhënat e kontaktit;

e) statutin e shoqërisë, ose kur personi është i regjistruar në një shtet tjetër, një përmbledhje që shpjegon karakteristikat kryesore juridike të formës ligjore apo të subjektit;



f) vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e institucionit të pagesave;

g) informacion nëse personi juridik ka qenë ose jo subjekt i rregulluar nga Banka e Shqipërisë/një autoritet tjetër mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare ose nga një organ tjetër shtetëror;

h) informacionin e parashikuar në shkronjat “c” deri në “l”, të pikës 2, të këtij neni, në lidhje me personin juridik;

i) strukturën e aksionarëve të personit juridik, që përfshin të paktën: emrin, datën dhe vendin e lindjes (për individët), adresën, dhe kur është e mundur, numrin personal të identifikimit ose të regjistrimit, si dhe përqindjen përkatëse të pjesëmarrjes në kapital/të drejtës së votës, të çdo aksionari/ortaku të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe pronari përfitues, sipas përcaktimit në nenin 17, pika 1, shkronja “P”, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;

j) një përshkrim të grupit financiar të rregulluar, pjesë e të cilit është aplikuesi, ose mund të bëhet pjesë, duke përcaktuar/paraqitur shoqërinë mëmë dhe subjektet e tjera të grupit, si dhe emrin e autoriteteve të tyre mbikëqyrëse;

k) pasqyrat financiare vjetore, në nivel individual, dhe kur është e zbatueshme, të konsoliduara në nivel grupi, për tri vitet e fundit financiare, kur personi juridik ka ushtruar veprimtari (ose, nëse ka ushtruar veprimtarinë për më pak se tre vjet, periudha për të cilën personi juridik ka ushtruar veprimtari dhe për të cilën janë përgatitur pasqyrat financiare), të audituara/certifikuara nga audituesi ligjor apo shoqëria e auditimit, në përputhje me ligjin për auditimin ligjor, nëse është e aplikueshme, duke përfshirë:

i. bilancin kontabël;

ii. pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;

iii. raportet vjetore dhe anekset financiare;

l) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

m) në rastin kur personi juridik nuk ka kryer veprimtari për një periudhë të mjaftueshme për të paraqitur pasqyrat financiare, për tri vitet financiare, përpara datës së aplikimit, aplikimi duhet të përmbajë pasqyrat financiare ekzistuese të ndërmjetme, nëse ka;

n) kur personi juridik ka selinë qendrore në një shtet tjetër, informacioni i përgjithshëm mbi regjimin rregullator të shtetit në fjalë siç zbatohet / aplikohet për personin juridik, duke përfshirë informacion mbi shkallën e përputhshmërisë së regjimit të masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vendit në fjalë, me rekomandimet e FATF-së³;

o) për subjektet në formën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive ose trusteve, subjekti që aplikon duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm:

i. identitetin e personave që administrojnë aktivet dhe identitetin e personave që janë përfitues ose nënshkrues;

ii. një kopje të dokumentit të themelimit dhe qeverisjes së subjektit, përfshirë politikën e investimit dhe çdo kufizim të investimit të aplikueshëm ndaj subjektit.

4. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm për çdo individ, person fizik ose juridik që zotëron pjesëmarrje influencuese në kapitalin e aplikuesit:

a) informacion të detajuar mbi arsyet financiare ose të biznesit të personit për zotërimin e pjesëmarrjes, si dhe strategjinë në lidhje me pjesëmarrjen në kapital, përfshirë periudhën në të cilën personi synon të mbajë këtë pjesëmarrje dhe çdo synim për të rritur, zvogëluar, apo ruajtur nivelin e pjesëmarrjes në kapital në të ardhmen e parashikuar;

b) informacion të detajuar mbi synimet/qëllimet e personit, në lidhje me aplikuesin, dhe shkallën e influencës/ndikimit që personi synon të ushtrojë mbi aplikuesin, lidhur me politikën e dividendëve, zhvillimin strategjik dhe shpërndarjen e burimeve të aplikuesit, pavarësisht nëse ai synon ose jo të veprojë si aksionar aktiv i pakicës, si dhe argumentimin për këtë qëllim;

c) informacion mbi gatishmërinë e personit për të mbështetur aplikuesin me kapital shtesë, nëse është nevojshme, për zhvillimin e veprimtarisë së tij apo në rast të vështirësisë financiare;

d) përmbajtjen e ndonjë marrëveshjeje (përfshirë edhe marrëveshjet financiare) ndërmjet aksionarëve apo ortakëve të synuar, me aksionarë ose ortakë të tjerë në lidhje me aplikuesin;

³ Financial Action Task Force Recommendations.



e) një analizë që përcakton nëse pjesëmarrja influencuese në kapital do të ndikojë në ndonjë mënyrë në aftësinë e aplikuesit për të siguruar informacion të saktë dhe në kohën e duhur për Bankën e Shqipërisë;

f) identitetin e çdo anëtari të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe/ose të administratorit që do të emërohet nga këta aksionarë apo ortakë, së bashku me informacionin e paraqitur në nenin 27 të kësaj rregulloreje.

5. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm, për kapitalin dhe burimin e tij (për të siguruar informacion të mjaftueshëm për Bankën e Shqipërisë se fondet janë gjeneruar nga veprimtari të ligjshme):

a) deklaratë noteriale të aksionarëve apo ortakëve se burimi i kapitalit fillestar të paguar të institucionit të pagesave nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta;

b) deklaratë noteriale të aksionarëve apo ortakëve mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

i. për personat juridikë:

- evidencën e burimit të krijimit të fondeve, të paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve të institucionit të pagesave) dhe certifikatën e autoriteteve kompetente që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave;

ii. për individët ose personat fizikë tregtarë:

- evidencën e burimit të krijimit të fondeve, të paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka ose të tjera evidenca të burimit të fondeve) dhe certifikatën e autoriteteve përkatëse fiskale shtetërore lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore.

6. Kërkesat për informacion të parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme për procesin e licencimit të institucioneve të pagesave dhe për procesin e dhënies së miratimit në çdo situatë ndryshimi të pjesëmarrjes influencuese, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të aksioneve ose

kuotave, siç parashikohet në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

Neni 27

Kërkesat mbi vlerësimin e përshtatshmërisë së administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e institucionit të pagesave

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese paraqet në Bankën e Shqipërisë, identitetin e çdo anëtari të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të administratorit dhe të çdo anëtari të komitetit të kontrollit.

2. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, për qëllime të vlerësimit të përshtatshmërisë së kryetarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit dhe kryetarit të komitetit të kontrollit, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “j”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e parashikuar në nenin 67 të kësaj rregulloreje. Këta persona, në çdo rast, duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 66 të kësaj rregulloreje.

3. Kërkesat e parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme edhe në rastet e ndryshimit ose të riemërimit (zgjatjes së afatit të emërimit) të personave, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, pas licencimit të subjektit.

Neni 28

Kërkesat mbi audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “k”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë, informacion mbi audituesin ligjor apo shoqërinë e auditimit, i cili duhet të përmbajë emrin, adresën dhe të dhënat e kontaktit të tij/saj.



Neni 29

**Kërkesat mbi siguracionin e
dëmshpërblimit profesional ose ndonjë
garanci tjetër të krahasueshme, për shërbimet
e inicimit të pagesës dhe shërbimet e
informimit të llogarisë**

1. Subjekti që synon të ofrojë shërbimin e inicimit të pagesës ose shërbimin e informimit të llogarisë, siç parashikohet në nenin 7, pikat 2 dhe 3, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, si evidencë të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose garancisë së krahasueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm:

a) një kontratë sigurimi ose dokument tjetër ekuivalent, që konfirmon ekzistencën e siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose garancive të krahasueshme, me një vlerë mbulimi në përputhje me udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, që tregon mbulimin e detyrimeve (përgjegjësi)ve përkatëse;

b) dokumentacion për mënyrën si aplikuesi e ka llogaritur shumën minimale, në mënyrë që të jetë në përputhje me udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, përfshirë të gjithë elementet e formulës së përcaktuar në të.

Neni 30

Kërkesat mbi agjentët

1. Në rastet kur institucioni i pagesave synon të ofrojë shërbimet e pagesave nëpërmjet agjentit, përveç sa parashikohet në nenin 21, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë edhe informacionin/dokumentacionin e mëposhtëm:

a) informacionin sipas formularit nr. 8 të kësaj rregulloreje;

b) për agjentët, të ndryshëm nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial, që vërtetojnë se:

- i. personi nuk është në ndjekje penale;
- ii. personi nuk është në gjykim për vepra penale;
- iii. personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);
- iv. personi nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm (nga Zyra e Përmbarimit Gjyqësor);

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.

2. Institucioni i pagesave mban në dosje të veçanta vërtetimet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, për administratorin dhe personat përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të institucionit të pagesave.

3. Kërkesat e parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme në procesin e licencimit të institucioneve të pagesave dhe në rastet e agjentëve të rinj.

**NËNKREU III
KËRKESAT NË LIDHJE ME
DOKUMENTACIONIN
PËR SUBJEKTET QË APLIKOJNË PËR
LICENCIM SI INSTITUCION I PARASË
ELEKTRONIKE**

Neni 31

Kërkesa të përgjithshme

1. Kërkesat e parashikuara në këtë nënkre zbatohen për subjektet që aplikojnë për licencim si institucion i parasë elektronike (IPE), të cilët kërkojnë të ofrojnë shërbime të parasë elektronike dhe nëse është e aplikueshme, çdo shërbim të parashikuar në pikat 1–8, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”. Subjektet që kërkojnë të ofrojnë vetëm shërbimet e pagesave të parashikuara në pikat 1–7, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, ose shërbimin e parashikuar në pikën 8 të atij aneksi, së bashku me shërbime të tjera pagesash të parashikuara në pikat 1–7, pa ofruar shërbime të parasë elektronike, duhet t’u referohen kërkesave të parashikuara në nënkreun II, të këtij kreu, mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar për licencimin e institucioneve të pagesave. Subjektet që kërkojnë të ofrojnë vetëm shërbimin e pagesave, të parashikuar në pikën 8, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, pa ofruar



shërbime të parasë elektronike, duhet t'u referohen kërkesave të parashikuara në kreun III të kësaj rregulloreje, mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar për regjistrimin e ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë.

2. Kërkesa për licencim si institucion i parasë elektronike bëhet me shkrim nga themeluesit ose administratori i subjektit, ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre (sipas formularit nr. 1 të kësaj rregulloreje). Kërkesa shoqërohet nga formularët e plotësuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacioni i parashikuar në nenet 32–49 të kësaj rregulloreje.

3. Subjekti që aplikon për licencim, si institucion i parasë elektronike, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë informacion sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, i cili është i vërtetë, i plotë, i saktë dhe i përditësuar.

4. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike, për paraqitjen e dokumentacionit/informacionit të kërkuar në Bankën e Shqipërisë, në lidhje me aktet/procedurat apo dokumentet e brendshme të veprimtarisë, ekstraktin/nxjerr/shkëput seksionet përkatëse të këtyre akteve/procedurave apo dokumenteve, si dhe paraqet referencat ndaj këtyre seksioneve, sipas kërkesave përkatëse të parashikuara në këtë rregullore.

5. Në rastet kur Banka e Shqipërisë kërkon sqarime të mëtejshme mbi dokumentacionin/informacionin e paraqitur, aplikuesi duhet t'i paraqesë këto sqarime brenda një kohe të arsyeshme/të përshtatshme.

Neni 32

Kërkesat mbi të dhënat identifikuese të subjektit

1. Subjekti që aplikon për licencim, si institucion i parasë elektronike, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë të dhënat identifikuese, sipas formularit nr. 3 të kësaj rregulloreje, të cilat përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e shoqërisë/subjektit që aplikon dhe, nëse është i ndryshëm, emrin tregtar;

b) ekstraktin e regjistrimit tregtar për regjistrimin e subjektit si person juridik, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të për të cilën/at subjekti kërkon

të licencohet, si dhe Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUI);

c) statutin e shoqërisë;

d) adresën e selisë qendrore të aplikuesit;

e) adresën e postës elektronike dhe faqen zyrtare të internetit të aplikuesit (nëse ka);

f) emrin/at e personit/personave të autorizuar për ndjekjen e aplikimit dhe procedurës së licencimit, si dhe të dhënat e tyre të kontaktit;

g) informacion nëse aplikuesi është aktualisht ose ka qenë ndonjëherë subjekt i rregullimit e mbikëqyrjes së një autoriteti tjetër mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare;

h) informacion nëse aplikuesi është anëtar ose planifikon të anëtarësohet në ndonjë shoqatë, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të parasë elektronike dhe/ose të shërbimeve të pagesave, në rast se është e aplikueshme.

Neni 33

Kërkesat për informacion mbi programin e veprimtarive

1. Subjekti që aplikon për licencim, si institucion i parasë elektronike, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë programin e veprimtarive (operacioneve), i cili përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të shërbimeve të parasë elektronike që subjekti parashikon të ofrojë: shërbimin e emetimit, shpërndarjes ose ripagimit të fondeve;

b) një përshkrim të detajuar të llojit të shërbimeve të pagesave të parashikuara (nëse është e aplikueshme), duke përfshirë një shpjegim mbi mënyrën se si veprimtaritë që do të ofrohen, identifikohen nga aplikuesi se përshtaten me ndonjë nga kategoritë e shërbimeve të pagesave të parashikuara në aneksin 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, si dhe një përshkrim nëse këto shërbime pagesash do të ofrohen përveç shërbimeve të parasë elektronike, ose nëse janë të lidhura me emetimin e parasë elektronike;

c) informacion nëse aplikanti do të zotërojë/posedojë në ndonjë moment fondet (e marra nga klientët);

d) një përshkrim të mënyrës së ekzekutimit të shërbimeve të ndryshme të parasë elektronike dhe të shërbimeve të pagesave, nëse është e aplikueshme, duke detajuar të gjitha palët e



përfshira për çdo shërbim të parasë elektronike dhe për çdo shërbim pagese që do të ofrohet, nëse është e aplikueshme, elementet e mëposhtme:

i. një skemë të rrjedhjes/flukseve të fondeve;

ii. kontratat e shlyerjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si nënpjesëmarrës në sistemet e pagesave;

iii. projektkontratat midis të gjitha palëve të përfshira në ofrimin e shërbimit të pagesave, përfshirë edhe skemat e pagesave me kartë, nëse janë të aplikueshme;

iv. kohën e përpunimit;

e) një kopje të kontratës tip midis emetuesit dhe pranuesit (mbajtësit) të parasë elektronike, si dhe një kopje të kontratës tip siç përcaktohet në nenin 5, pika 19, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, nëse aplikuesi parashikon të ofrojë shërbime pagesash, përveç emetimit të parasë elektronike;

f) numrin e parashikuar të degëve në të cilat aplikuesi parashikon të ofrojë shërbimet, nëse është e aplikueshme;

g) një përshkrim të shërbimeve operacionale dhe ndihmëse të shërbimeve të parasë elektronike dhe nëse është e aplikueshme, të shërbimeve të pagesave, të parashikuara në nenin 19, pika 1, shkronja “a”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”. Në rastin kur subjekti do të ofrojë veprimtarinë e operimit të sistemeve të pagesave, duhet të paraqesë informacion të mjaftueshëm pranë Bankës së Shqipërisë mbi planin e tij të biznesit, në lidhje me operimin e sistemeve të pagesave, pjesëmarrësit në sistem dhe shërbimet e ofruara në lidhje me këtë aktivitet, me qëllim vlerësimin e aplikimit të nenit 20, pika 2 ose 3, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

h) në rastin kur aplikuesi parashikon të ofrojë shërbime pagesash përveç emetimit të parasë elektronike, një deklaratë nëse aplikuesi ka për qëllim të japë kredi, siç parashikohet në nenin 19, pika 4 dhe 7, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, dhe nëse po, brenda cilit kufi;

i) informacion nëse aplikuesi ka për qëllim të ofrojë për tre vitet e ardhshme ose nëse ofron tashmë veprimtari tregtare, siç përcaktohen në nenin 19, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, përfshirë një përshkrim të llojit dhe volumit të parashikuar të veprimtarive;

j) informacionin e përcaktuar në udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit

profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, në përputhje me nenin 7, pikat 2, 3 dhe 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, kur aplikuesi synon të ofrojë shërbimet e pagesave sipas pikave 7 dhe 8 (shërbimi i inicimit të pagesës dhe shërbimi i informimit të llogarisë), të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

k) informacion për investimet në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të shoqëruar me listën e pajisjeve, programeve, etj.

Neni 34

Kërkesat mbi planin e biznesit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet në Bankën e Shqipërisë planin e biznesit, i cili përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një analizë të pozicionit konkurrues të subjektit në segmentin përkatës të tregut të parasë elektronike dhe, nëse është e aplikueshme, në segmentin e caktuar të tregut të pagesave;

b) një përshkrim të kategorive të përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe pranuesve (mbajtësve) të parasë elektronike;

c) një parashikim të gjendjes financiare të subjektit për 3 vitet e para të veprimtarisë, që tregon se aplikuesi është në gjendje të sigurojë ushtrimin e një veprimtarie të qëndrueshme, që përfshin:

i. një parashikim të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të bilancit kontabël dhe shpjegime të zërave kryesorë të tyre, duke përfshirë edhe informacion mbi supozimet për vëllimin ose vlerën e transaksioneve, numrin e klientëve, çmimin e shërbimit, vlerën mesatare të një transaksioni, rritjen e parashikuar të fitimit, etj.;

ii. një parashikim të pasqyrës së ndryshimeve në kapital;

iii. një skemë dhe ndarje të hollësishme të flukseve të parashikuara të parasë për tri vitet e ardhshme;

d) një parashikim vjetor të përbërjes sipas zërave, të kapitalit rregullator për tre vitet e para të veprimtarisë, të llogaritur në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, nëse institucioni i parasë elektronike do të ofrojë vetëm shërbimet e parasë elektronike, ose në përputhje me metodën e përcaktuar në nenin 11, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në aktet



nënligjore të Bankës së Shqipërisë, nëse aplikuesi kërkon të ofrojë shërbime të pagesave (me përjashtim të rasteve kur aplikuesi kërkon të ofrojë vetëm shërbimin e inicimit të pagesës ose vetëm shërbimin e inicimit të pagesës dhe shërbimin e informimit të llogarisë), përveç shërbimeve të parasë elektronike;

e) një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës (tregues të kujdesit, raporte etj.) për 3 (tre) vitet e ardhshëm;

f) nëse subjekti ka ushtruar një veprimtari tjetër, përpara aplikimit për licencim si institucion i parasë elektronike, pasqyrat financiare vjetore të audituara për tri vitet paraardhëse, dhe në rastin e një shoqërie më të re, pasqyrat financiare të audituara, që nga krijimi.

Neni 35

Kërkesat mbi organizimin strukturor

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet në Bankën e Shqipërisë një përshkrim të organizimit strukturor të shoqërisë, që përmban:

a) një organigramë të detajuar të strukturës organizative, duke paraqitur çdo njësi, departament, ose ndarje të ngjashme strukturore, në të cilën përcaktohen emrat e personave përgjegjës dhe përshkrimet e funksioneve dhe përgjegjësi, veçanërisht të personave të ngarkuar me funksionet e kontrollit të brendshëm;

b) një parashikim të numrit të përgjithshëm të punonjësve për tre vitet e ardhshme;

c) kopje të marrëveshjeve me të tretët për transferimin e funksioneve operacionale, si dhe një përshkrim të këtyre marrëveshjeve, që përmban:

i. identitetin dhe vendndodhjen gjeografike të ofruesit të shërbimit;

ii. identitetin e personave brenda institucionit të parasë elektronike, të cilët janë përgjegjës për secilin nga shërbimet e ofruara nga të tretët;

iii. një përshkrim të detajuar të shërbimeve të ofruara nga të tretët dhe karakteristikave kryesore të tyre;

d) një përshkrim mbi degët dhe agjentët, kur është e aplikueshme, duke përfshirë:

i. një parashikim të kontrolleve në distancë dhe në vend që parashikohen të kryhen në degët dhe agjentët, si dhe frekuencën e këtyre kontrolleve;

ii. sistemet e teknologjisë së informacionit, proceset dhe infrastrukturën e përdorur nga agjentët, që do të veprojnë për llogari të aplikuesit;

iii. në rastin e agjentëve, kriteret e përzgjedhjes së tyre, procedurat e monitorimit dhe trajnimet për agjentët;

iv. informacion mbi plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë për degët dhe/ose agjentët, sipas rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare”, në rast se subjekti do të ushtronte veprimtarinë me sportel dhe/ose me agjentët;

e) informacion nëse subjekti është pjesëmarrës në një sistem pagesash kombëtare dhe/ose ndërkombëtare;

f) listën e personave fizikë apo juridikë, me lidhje të ngushta me aplikuesin, së bashku me identitetin e tyre dhe natyrën e këtyre lidhjeve.

Neni 36

Kërkesat për evidencën e kapitalit fillestar minimal

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike, në lidhje me evidencën për kapitalin fillestar minimal të kërkuar, paraqet në Bankën e Shqipërisë një vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë, që subjekti ka bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje. Kjo shumë zhbllokohet nëpërmjet njofimit të Bankës së Shqipërisë, në përfundim të procedurës së licencimit.

Neni 37

Kërkesat për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të parasë elektronike dhe/ose të përdoruesve të shërbimeve të pagesave

1. Për subjektet që do t'i mbrojnë fondet e marra prej përdoruesve të parasë elektronike dhe/ose përdoruesve të shërbimeve të pagesave, nëpërmjet depozitimit të fondeve në një llogari të veçantë në bankë apo nëpërmjet investimit në aktive likuide dhe me rrezik të ulët, subjekti aplikues paraqet një përshkrim të masave të marra për mbrojtjen e fondeve, që përmban:



a) një përshkrim të politikës së investimit, për të siguruar se aktivet e zgjedhura për investim janë likuide dhe me rrezik të ulët, nëse është e aplikueshme;

b) numrin e personave të cilët kanë akses në llogarinë e fondeve të mbrojtura dhe funksionet e tyre;

c) një kopje të projektkontratës tip me bankën/at;

d) një deklaratë të institucionit të parasë elektronike për përputhshmërinë me nenin 12, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” (sipas formularit nr. 12 të kësaj rregulloreje).

2. Për subjektet që do t'i mbrojnë fondet e marra prej përdoruesve të parasë elektronike dhe/ose përdoruesve të shërbimeve të pagesave (nëse është e aplikueshme), nëpërmjet një police sigurimi ose ndonjë garancie tjetër të krahasueshme nga një shoqëri sigurimi ose nga një bankë, dhe përveç rastit kur aplikanti synon të ofrojë vetëm shërbimin e inicimit të pagesës, subjekti aplikues paraqet një përshkrim të masave të marra për mbrojtjen e fondeve, që përmban:

a) një konfirmim nga vetë subjekti që polica e sigurimit ose garancia tjetër e krahasueshme me të nga një shoqëri sigurimi ose nga një bankë është lëshuar nga një subjekt që nuk i përket të njëjtut grup të institucionit të parasë elektronike (të aplikuesit);

b) detaje të procesit të rakordimit për të siguruar se polica e sigurimit ose ndonjë garanci tjetër e krahasueshme me të është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e aplikuesit për mbrojtjen e fondeve në çdo kohë;

c) kohëzgjatjen dhe rinovimin e siguracionit / garancisë;

d) një kopje të projekt marrëveshjes së sigurimit ose të projektkontratës së garancisë së krahasueshme.

Neni 38

Kërkesat mbi sistemin e drejtimit dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, një përshkrim të sistemit të drejtimit dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm, që përfshin:

a) një përshkrim të llojeve të rreziqeve të identifikuar nga aplikuesi (përfshirë edhe për degët

dhe agjentët, nëse është e aplikueshme), si dhe të procedurave që aplikuesi do të zbatojë për vlerësimin dhe parandalimin e këtyre rreziqeve që lidhen me shërbimet e parasë elektronike dhe nëse është e aplikueshme, me shërbimet e pagesave;

b) procedurat për kryerjen e kontroleve periodike dhe të vazhdueshme, duke përfshirë frekuencën e këtyre kontroleve dhe burimet njerëzore në dispozicion;

c) procedurat kontabël nëpërmjet të cilave aplikuesi do të regjistrojë dhe do të raportojë informacionin financiar;

d) identitetin e personit/personave përgjegjës për funksionin e kontrollit të brendshëm, përfshirë kontrollin periodik dhe të vazhdueshëm, dhe për funksionin e përputhshmërisë, si edhe një *curriculum vitae* (CV) të përditësuar të këtyre personave;

e) përbërjen e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të komitetit të kontrollit, si dhe të ndonjë komiteti tjetër në nivel këshilli administrimi /mbikëqyrës (nëse është e aplikueshme);

f) një përshkrim të mënyrës së monitorimit dhe kontrollit të funksioneve operacionale të transferuara tek të tretët (*outsourcing*), me qëllim që të parandalohet çdo cenim i cilësisë së kontrollit të brendshëm të institucionit të parasë elektronike;

g) një përshkrim të mënyrës se si monitorohen dhe kontrollohen agjentët dhe degët, brenda kuadrit të kontrollit të brendshëm të aplikuesit;

h) një përshkrim të organeve drejtuese dhe të subjekteve që përbëjnë grupin, në rastin kur aplikuesi është filial i një subjekti të rregulluar nga një shtet tjetër.

Neni 39

Kërkesat mbi procedurat për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e ngjarjeve që cenojnë sigurinë, dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, një përshkrim të procedurave të hartuara për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e një ngjarjeje që cenon sigurinë dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë, i cili duhet të përmbajë:

a) masat organizative dhe mjetet për parandalimin e mashtrimit;



b) të dhënat e personave përgjegjës dhe të organeve përgjegjëse të aplikuesit, për të asistuar klientët në rastet e mashtrimit, të problemeve teknike dhe/ose të administrimit të ankesave/pretendimeve;

c) linjat e raportimit në rast mashtrimi;

d) personin e kontaktit për klientët, përfshirë emrin dhe adresën elektronike;

e) procedurat për raportimin e incidenteve, përfshirë komunikimin e këtyre ngjarjeve tek organet përkatëse, të brendshme dhe të jashtme, përfshirë edhe për aplikantët që do të ofrojnë shërbime pagesash, përveç shërbimeve të parasë elektronike, si dhe për njoftimin në Bankën e Shqipërisë për incidentet madhore, në përputhje me nenin 89, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe me aktet nënligjore përkatëse;

f) instrumentet e monitorimit që do të përdoren dhe masat e procedurat për ndjekjen e zbutjes së rreziqeve të sigurisë.

Neni 40

Kërkesat mbi procesin e regjistrimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të të drejtave të hyrjes në të dhënat sensitive të pagesës

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, një përshkrim të procesit të regjistrimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të të drejtave të hyrjes (aksesit) në të dhënat sensitive të pagesës, i cili duhet të përmbajë:

a) një përshkrim të rrjedhës së të dhënave, të klasifikuara si të dhëna sensitive të pagesës, në kontekstin e modelit të biznesit të institucionit të parasë elektronike;

b) procedurat për autorizimin e së drejtës së hyrjes në të dhënat sensitive të pagesës;

c) një përshkrim të instrumenteve të monitorimit;

d) politikën e të drejtave të hyrjes, duke detajuar të drejtat e hyrjes (aksesit) në të gjitha sistemet dhe komponentët e infrastrukturës përkatëse, përfshirë bazën e të dhënave dhe infrastrukturën e *back-up*-it;

e) një përshkrim të mënyrës së regjistrimit të të dhënave të grumbulluara;

f) përdorimin e brendshëm dhe të jashtëm të të dhënave të grumbulluara, përfshirë ato nga kundërpartitë;

g) sistemin e teknologjisë së informacionit (IT) dhe masat teknike të sigurisë të zbatuara, përfshirë enkriptimin dhe/ose përdorimin e dy ose më shumë faktorëve të autentifikimit (*tokenisation*);

h) identifikimin e personave, organeve dhe/ose komiteteve me të drejta hyrjeje në të dhënat sensitive të pagesave;

i) një shpjegim si gjurmohen/zbulohen dhe adresohen incidentet apo shkeljet/thyerjet e konfidencialitetit dhe integritetit të informacionit;

j) programin vjetor të kontrollit të brendshëm, në lidhje me sigurinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Neni 41

Kërkesat mbi planin e vazhdimësisë së biznesit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, një përshkrim të planit të vazhdimësisë së biznesit, i cili përbëhet nga informacioni i mëposhtëm:

a) një analizë të ndikimit në biznes, përfshirë proceset e biznesit dhe objektivat e rimëkëmbjes, të tilla si: objektivat mbi kohën e rimëkëmbjes, objektivat për pikën e rimëkëmbjes dhe aktivitetet e ruajtura/mbrojtura, përfshirë edhe informacionin;

b) identifikimi i ambienteve dytësore (*back-up*) në rast të aktivizimit të planit të vazhdimësisë së biznesit, të drejtave të hyrjes në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, si dhe matricën e të drejtave të hyrjes në programin/programet bazë (*key software*) dhe të dhënat kryesore që do të shërbejnë për rimëkëmbjen, në rast ndërprerjeje të veprimtarisë apo fatkeqësie/katastrofe;

c) një shpjegim të mënyrës sipas së cilës aplikuesi do të trajtojë ngjarje të rëndësishme të vazhdueshmërisë apo ndërprerjes së veprimtarisë, siç është mosfunksionimi i sistemeve kryesore, humbja e të dhënave kryesore, pamundësia për të hyrë në mjediset e punës, apo humbja e personave kyç (kryesorë) të subjektit;

d) frekuenca me të cilën aplikuesi synon të testojë planin e vazhdimësisë së biznesit dhe të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, përfshirë mënyrën se si do të regjistrohen rezultatet e testimit;

e) një përshkrim të masave zbutëse që do të përdoren nga aplikuesi, në rast të përfundimit të ofrimit të shërbimeve të pagesës, për të siguruar



ekzekutimin e transaksioneve të pagesave në proces dhe përfundimin e kontratave ekzistuese.

Neni 42

Kërkesat për mbledhjen e të dhënave statistikore për ecurinë e veprimtarisë, transaksionet dhe mashttrimet

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, një përshkrim të parimeve dhe përcaktimeve, që do të zbatohen për mbledhjen e të dhënave statistikore, për ecurinë e veprimtarisë, transaksionet dhe mashttrimet, që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) llojin e të dhënave të mbledhura, në lidhje me klientët, llojin e shërbimit të pagesave, kanalin, instrumentin dhe monedhën;

b) të dhënat lidhur me aktivitetet dhe subjektet përkatëse, përfshirë degët dhe agjentët;

c) mënyrën e mbledhjes së të dhënave;

d) qëllimin e mbledhjes së të dhënave;

e) frekuencën e mbledhjes së të dhënave;

f) dokumentet shoqëruese, të tilla si një udhëzues që përshkruan mënyrën e funksionimit të sistemit.

Neni 43

Kërkesat mbi dokumentin e politikës së sigurisë

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, një dokument të politikës së sigurisë që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një vlerësim të detajuar të rreziqeve të lidhur me shërbimet e parasë elektronike dhe, nëse është e aplikueshme, me shërbimet e pagesave që aplikuesi kërkon të ofrojë, i cili duhet të përfshijë edhe rreziqet e mashttrimet dhe kontrollin e sigurisë dhe masat zbutëse të marra për të mbrojtur në mënyrën e duhur përdoruesit e shërbimeve të parasë elektronike dhe nëse është e aplikueshme, përdoruesit e shërbimeve të pagesave, ndaj rreziqeve të identifikuar;

b) një përshkrim të sistemeve të teknologjisë së informacionit, që përfshin:

i. arkitekturën e sistemeve dhe elementeve të rrjetit të tyre;

ii. sistemet e teknologjisë së informacionit të biznesit që mbështesin aktivitetet e biznesit, si faqen e internetit të aplikuesit, portofolat e klientëve (*wallets*), mënyrën e funksionimit të pagesave, mënyrën e administrimit të rrezikut dhe të rasteve të mashttrimet dhe të identifikimit dhe kontabilizimit të klientëve;

iii. sistemet mbështetëse të teknologjisë së informacionit që përdoren për organizimin dhe administrimin e institucionit të parasë elektronike, të tilla si: sistemi kontabël, sistemet e raportimit sipas kërkesave rregullatore, administrimi i personelit, administrimi i marrëdhënieve me klientët, serverët e postës elektronike dhe serverët e dokumenteve/skedarëve të brendshëm;

iv. informacion nëse këto sisteme përdoren tashmë nga institucioni i parasë elektronike apo grupi i tij, si dhe data e parashikuar e zbatimit, nëse është e aplikueshme;

c) lloji i kontakteve/lidhjeve të autorizuar nga jashtë, të tillë si: lidhjet me bashkëpunëtorët / partnerët, ofruesit e shërbimeve, subjektet e grupit dhe punonjësit që punojnë në distancë, duke përfshirë arsyen/argumentimin e këtyre kontakteve / lidhjeve;

d) për secilin prej kontakteve të renditura në shkronjën “c”, masat dhe mekanizmat logjike të sigurisë të krijuara, duke specifikuar kontrollin që institucioni i parasë elektronike do të ketë mbi këtë të drejtë hyrjeje/aksesi, si dhe natyrën dhe frekuencën e secilit kontroll, atij teknik kundrejt atij organizativ, atij parandalues kundrejt atij gjurmues, dhe monitorimin në kohë reale kundrejt rishikimeve rutinë/periodike, si përdorimi i një rrjeti aktiv të ndarë nga grupi, hapja/mbyllja e linjave të komunikimit, konfigurimi i mjeteve/pajisjeve të sigurisë, gjenerimi i çelësave (*keys*) ose certifikatave të autentifikimit, monitorimi i sistemit, autentifikimi, konfidencialiteti i komunikimit, zbulimi i ndërhyrjeve, sistemet antivirus dhe regjistrat e aksesimeve (*logs*);

e) masat dhe mekanizmat logjike të sigurisë që rregullojnë të drejtën e hyrjes/aksesit të brendshëm në sistemet e teknologjisë së informacionit, të cilat duhet të përfshijnë:

i. natyrën teknike dhe organizative, si dhe frekuencën e çdo mase, nëse masa është e natyrës parandaluese apo zbuluese, si dhe nëse është ndërmarrë ose jo në kohë reale;



ii. mënyrën si trajtohet ndarja e mjediseve të klientit kur burimet e teknologjisë së informacionit janë të përbashkëta;

f) masat dhe mekanizmat e sigurisë fizike të ambienteve/ndërtesës dhe qendrës së të dhënave të aplikuesit, të tilla si kontrolli i të drejtës së hyrjes/aksesit dhe sigurisë së mjedisit;

g) sigurinë e proceseve të parasë elektronike, dhe, nëse është e aplikueshme, të proceseve të pagesave, e cila duhet të përfshijë:

i. procedurën e autentifikimit të klientit të përdorur si për hyrjen (aksesin) me qëllim këshillimin, ashtu edhe për kryerjen e transaksioneve, si dhe për të gjithë instrumentet bazë të pagesave;

ii. një shpjegim për mënyrën se si realizohet dërgimi i sigurt të përdoruesi i ligjshëm i shërbimit të parasë elektronike dhe nëse është e aplikueshme, të shërbimit të pagesave dhe integriteti i faktorëve të autentifikimit, të tillë si pajisjet për gjenerimin e fjalëkalimeve me një përdorim (*hardware tokens*) dhe aplikacionet për *mobile banking*, si në kohën e regjistrimit fillestar, ashtu edhe të rinovimit;

iii. një përshkrim të sistemeve dhe procedurave që institucioni i parasë elektronike zbaton për analizën e transaksionit dhe identifikimin e transaksioneve të dyshimta ose të pazakonta;

h) një vlerësim të detajuar të rreziqeve në lidhje me shërbimet e parasë elektronike, dhe nëse është e aplikueshme, me shërbimet e pagesave, përfshirë rrezikun e mashtrimit, duke e lidhur me kontrollin dhe masat zbutëse të përcaktuara/përshkruara në dokumentin e aplikimit, të cilat sigurojnë adresimin e duhur të tyre (rreziqeve);

i) procedurat kryesore në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit të aplikuesit, ose për procedurat që nuk janë formalizuar ende, një datë e parashikuar për përfundimin/finalizimin e tyre, të cilat marrin në konsideratë edhe kërkesat e rregullores “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”.

Neni 44

Kërkesat mbi mekanizmat e kontrollit të brendshëm për zbatimin e kërkesave, për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm që aplikuesi ka krijuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili duhet të përmbajë:

a) vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit të lidhur me veprimtarinë e aplikuesit, përfshirë rreziqet që lidhen me bazën e klientëve të aplikuesit, produktet dhe shërbimet e ofruara, kanalet e shpërndarjes dhe zonën gjeografike ku do të ushtrojë veprimtarinë;

b) masat për zbutjen e rreziqeve dhe për përmbushjen e kërkesave ligjore e rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë procesin e vlerësimit të rrezikut nga aplikuesi, politikat dhe procedurat për të qenë në përputhje me kërkesat për zbatimin e vigjilencës ndaj klientit, si dhe për identifikimin dhe raportimin e transaksioneve apo veprimtarive të dyshimta;

c) sistemet dhe kontrollet e aplikuesit, të cilat sigurojnë që degët dhe agjentët e tij veprojnë në përputhje me kërkesat në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;

d) mekanizmat e aplikuesit, të cilat sigurojnë që punonjësit dhe agjentët janë të trajnuar në mënyrën e duhur për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

e) identitetin e personit/ave që do të jenë përgjegjës për të siguruar përputhshmërinë e aplikantit me kërkesat ligjore e rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe evidencën që ekspertiza e tij/tyre, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është e përshtatshme për të mundur përmbushjen e këtij roli në mënyrë efektive;

f) sistemet dhe kontrollet e aplikuesit, të cilat sigurojnë që politikat dhe procedurat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të jenë të përditësuara në vazhdimësi, efektive dhe të përshtatshme;



g) sistemet dhe kontrollet e aplikuesit, të cilat sigurojnë që agjentët nuk e ekspozojnë aplikuesin ndaj rritjes së rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

h) manualin për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit për punonjësit e aplikuesit.

Neni 45

Kërkesat mbi identitetin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese në kapital

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike, për qëllime të plotësimit të kërkesave mbi identitetin dhe evidencën e përshtatshmërisë së aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese në kapitalin e aplikuesit (institucionit të parasë elektronike), paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të grupit të cilit i përket aplikuesi dhe informacion mbi shoqërinë mëmë, nëse është e aplikueshme;

b) një skemë që paraqet strukturën e aksionarëve/ortakëve të aplikuesit, që përfshin:

i. emrin dhe përqindjen e pjesëmarrjes (në kapital/të drejtat e votës) të çdo personi që zotëron pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në kapitalin e aplikuesit, duke evidentuar personat që konsiderohen si aksionarë/ortakë me pjesëmarrje influencuese dhe arsyen e këtij kualifikimi;

ii. emrin dhe përqindjen e pjesëmarrjes (në kapital/të drejtat e votës), të çdo personi që zotëron pjesëmarrje të tërthortë në kapitalin e aplikuesit, duke evidentuar personat që konsiderohen si aksionarë/ortakë me pjesëmarrje influencuese të tërthortë në kapital dhe arsyen e këtij kualifikimi;

c) një listë të emrave të personave që zotërojnë pjesëmarrje influencuese në kapitalin e aplikuesit, duke specifikuar për çdo person:

i. numrin dhe llojin e aksioneve ose të kuotave në kapital, të nënshkruara;

ii. vlerën nominale të këtyre aksioneve ose kuotave në kapital.

2. Në rastin kur një person që zotëron pjesëmarrje influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në kapitalin e aplikuesit, është individ ose person fizik tregtar, subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet,

në Bankën e Shqipërisë, informacionin e mëposhtëm lidhur me identitetin dhe përshtatshmërinë e këtij personi:

a) emrin e personit, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë, numrin personal të identifikimit ose numrin e pasaportës, adresën dhe kopje të dokumentit zyrtar të identifikimit;

b) për individin, një *curriculum vitae* (CV) të detajuar, që paraqet informacion mbi arsimimin dhe trajnimet, eksperiencat profesionale të mëparshme, largimet nga puna dhe veprimtaritë profesionale apo funksione të tjera aktuale (sipas formularit nr. 4 të kësaj rregulloreje);

c) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial:

i. se personi nuk është në ndjekje penale;

ii. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii. se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe

iv. nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pushlyera;

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.

d) deklaratë personale mbi ndonjë rast paaftësie paguese dhe që nuk ka qenë përgjegjës për falimentimin, ose procedura të ngjashme të ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;

e) vërtetim ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent nga organet kompetente të shtetit të huaj, të lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;

f) deklaratë për çdo refuzim ose revokim nga një autoritet mbikëqyrës/Banka e Shqipërisë ose subjekt i sektorit publik në sektorin e shërbimeve financiare, apo çdo përjashtim nga një shoqatë profesionistësh;

g) një listë të sipërmarrjeve që personi drejton ose kontrollon, përqindjen e kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në këto shoqëri, statusin e tyre (nëse janë aktive, kanë pushuar së vepruari, etj.);

h) rezultatin e vlerësimit, në rastin kur është kryer një vlerësim i reputacionit të personit nga Banka e Shqipërisë ose nga një autoritet mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare, përfshirë identitetin e atij autoriteti;



i) pasqyra/të dhëna financiare të audituara nga audituesit ligjorë për tri vitet e fundit (sipas formularit nr. 11 të kësaj rregulloreje);

j) për personat fizikë tregtarë, ekstrakti i regjistrimit në regjistrin tregtar dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale;

k) deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje);

l) një deklaratë nëse personi është person i ekspozuar politikisht dhe nëse ka lidhje me persona të ekspozuar politikisht, sipas përcaktimeve në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (sipas formularit nr. 10 të kësaj rregulloreje).

3. Në rastin kur një person apo subjekt, që zotëron pjesëmarrje influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në kapitalin e aplikuesit, është person juridik, subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet, në Bankën e Shqipërisë, informacionin e mëposhtëm, lidhur me identitetin dhe përshtatshmërinë e këtij personi:

a) emrin e subjektit;

b) ekstraktin e regjistrimit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

c) adresën e selisë qendrore;

d) të dhënat e kontaktit;

e) statutin e shoqërisë, ose kur personi është i regjistruar në një shtet tjetër, një përmbledhje që shpjegon karakteristikat kryesore juridike të formës ligjore apo të subjektit;

f) vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e institucionit të parasë elektronike;

g) informacion nëse personi juridik ka qenë ose jo subjekt i rregulluar nga Banka e Shqipërisë/një autoritet tjetër mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare ose organ tjetër shtetëror;

h) informacionin e parashikuar në shkronjat “c” deri në “l”, të pikës 2 të këtij neni, në lidhje me personin juridik;

i) strukturën e aksionarëve të personit juridik, që përfshin të paktën: emrin, datën dhe vendin e lindjes (për individët), adresën, dhe kur është e mundur, numrin personal të identifikimit ose të

regjistrimit, si dhe përqindjen përkatëse të pjesëmarrjes në kapital/të drejtës së votës, të çdo aksionari/ortaku të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe pronari përfitues, sipas përcaktimit në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

j) një përshkrim të grupit financiar të rregulluar, pjesë e të cilit është aplikuesi, ose mund të bëhet pjesë, duke përcaktuar/paraqitur shoqërinë mëmë dhe subjektet e tjera të grupit, si dhe emrin e autoriteteve të tyre mbikëqyrëse;

k) pasqyrat financiare vjetore, në nivel individual, dhe kur është e zbatueshme, të konsoliduara në nivel grupi, për tri vitet e fundit financiare, kur personi juridik ka ushtruar veprimtari (ose, nëse ka ushtruar veprimtarinë për më pak se tre vjet, periudha për të cilën personi juridik ka ushtruar veprimtari dhe për të cilën janë përgatitur pasqyrat financiare), të audituara/certifikuara nga audituesi ligjor apo shoqëria e auditimit, në përputhje me ligjin për auditimin ligjor, nëse është e aplikueshme, duke përfshirë:

i. bilancin kontabël;

ii. pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;

iii. raportet vjetore dhe anekset financiare;

l) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

m) në rastin kur personi juridik nuk ka kryer veprimtari për një periudhë të mjaftueshme, për të paraqitur pasqyrat financiare, për tri vitet financiare përpara datës së aplikimit, aplikimi duhet të përmbajë pasqyrat financiare ekzistuese të ndërmjetme, nëse ka;

n) kur personi juridik ose subjekti ka selinë qendrore në një shtet tjetër, informacioni i përgjithshëm mbi regjimin rregullator të shtetit në fjalë, siç zbatohet/aplikohet për personin juridik, duke përfshirë informacion mbi shkallën e përputhshmërisë së regjimit të masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vendit në fjalë, me rekomandimet e FATF-së⁴;

o) për subjektet në formën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive ose trusteve, subjekti që aplikon duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm:

⁴ Financial Action Task Force Recommendations.



i. identitetin e personave që menaxhojnë aktivet dhe identitetin e personave që janë përfitues ose nënshkrues;

ii. një kopje të dokumentit të themelimit dhe qeverisjes së subjektit, përfshirë politikën e investimit dhe çdo kufizim të investimit të aplikueshëm ndaj subjektit.

4. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet në Bankën e Shqipërisë, informacionin e mëposhtëm për çdo individ, person fizik ose juridik që zotëron pjesëmarrje influencuese në kapitalin e aplikuesit:

a) informacion të detajuar mbi arsyet financiare ose të biznesit të personit për zotërimin e pjesëmarrjes, si dhe strategjinë në lidhje me pjesëmarrjen në kapital, përfshirë periudhën në të cilën personi synon të mbajë këtë pjesëmarrje dhe çdo synim për të rritur, zvogëluar, apo ruajtur nivelin e pjesëmarrjes në kapital në të ardhmen e parashikuar;

b) informacion të detajuar mbi synimet/qëllimet e personit në lidhje me aplikuesin dhe shkallën e influencës/ndikimit që personi synon të ushtrojë mbi aplikuesin, lidhur me politikën e dividendëve, zhvillimin strategjik dhe shpërndarjen e burimeve të aplikuesit, pavarësisht nëse ai synon ose jo të veprojë si aksionar aktiv i pakicës, si dhe argumentimin për këtë qëllim;

c) informacion mbi gatishmërinë e personit për të mbështetur aplikuesin me kapital shtesë nëse është nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së tij apo në rast të vështirësisë financiare;

d) përmbajtjen e ndonjë marrëveshjeje (përfshirë edhe marrëveshjet financiare) ndërmjet aksionarëve apo ortakëve të synuar, me aksionarë ose ortakë të tjerë në lidhje me aplikuesin;

e) një analizë që përcakton nëse pjesëmarrja influencuese në kapital do të ndikojë në ndonjë mënyrë në aftësinë e aplikuesit për të siguruar informacion të saktë dhe në kohën e duhur për Bankën e Shqipërisë;

f) identitetin e çdo anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe/ose të administratorit që do të emërohet nga këta aksionarë apo ortakë, së bashku me informacionin e paraqitur në nenin 46 të kësaj rregulloreje.

5. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet në Bankën e Shqipërisë, dokumentacionin e mëposhtëm për kapitalin dhe burimin e tij (për të siguruar

informacion të mjaftueshëm për Bankën e Shqipërisë se fondet janë gjeneruar nga veprimtari të ligjshme):

a) deklaratë noteriale të aksionarëve apo ortakëve se burimi i kapitalit fillestar të paguar të institucionit të parasë elektronike nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta;

b) deklaratë noteriale të aksionarëve apo ortakëve mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

i. për personat juridikë:

- evidencën e burimit të krijimit të fondeve, të paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve të institucionit të parasë elektronike) dhe certifikatën e autoriteteve kompetente që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave;

ii. për individët ose personat fizikë tregtarë:

- evidencën e burimit të krijimit të fondeve, të paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka ose të tjera evidenca të burimit të fondeve) dhe certifikatën e autoriteteve përkatëse fiskale shtetërore lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore.

6. Kërkesat për informacion të parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme për procesin e licencimit të institucioneve të parasë elektronike dhe për procesin e dhënies së miratimit në çdo situatë ndryshimi të pjesëmarrjes influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të aksioneve ose kuotave, siç parashikohet në nenin 8, pikat 1 dhe 2 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

Neni 46

Kërkesat mbi vlerësimin e përshtatshmërisë së administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e institucionit të parasë elektronike

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike, paraqet në Bankën e Shqipërisë, identitetin e çdo anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të administratorit dhe të çdo anëtarit të komitetit të kontrollit.



2. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike, për qëllime të vlerësimit të përshtatshmërisë së kryetarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit dhe kryetarit të komitetit të kontrollit, paraqet në Bankën e Shqipërisë, dokumentacionin e parashikuar në nenin 67 të kësaj rregulloreje. Këta persona në çdo rast duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 66 të kësaj rregulloreje.

3. Kërkesat e parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme edhe në rastet e ndryshimit ose të riemërimit (zgjatjes së afatit të emërimit) të personave, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, pas licencimit të subjektit.

Neni 47

Kërkesat mbi audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike paraqet në Bankën e Shqipërisë, informacion mbi audituesin ligjor apo shoqërinë e auditimit, i cili duhet të përmbajë emrin, adresën dhe të dhënat e kontaktit të tij/saj.

Neni 48

Kërkesat mbi siguracionin e dëmshpërblimit profesional ose ndonjë garanci tjetër të krahasueshme, për shërbimet e inicimit të pagesës dhe shërbimet e informimit të llogarisë

1. Subjekti që aplikon për licencim si institucion i parasë elektronike, që përveç shërbimeve të parasë elektronike synon të ofrojë edhe shërbimin e inicimit të pagesës dhe/ose shërbimin e informimit të llogarisë, siç parashikohet në nenin 7, pikat 2 dhe 3, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, si evidencë të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose garancisë së krahasueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë, informacionin e mëposhtëm:

a) një kontratë sigurimi ose dokument tjetër ekuivalent që konfirmon ekzistencën e siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose garancive të krahasueshme, me një vlerë mbulimi në përputhje me udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e

shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, që tregon mbulimin e detyrimeve (përgjegjësi) përkatëse;

b) dokumentacion për mënyrën si aplikuesi e ka llogaritur shumën minimale, në mënyrë që të jetë në përputhje me udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, përfshirë të gjitha elementet e formulës së përcaktuar në të.

Neni 49

Kërkesat mbi agentët dhe marrëveshjet me të tretët

1. Në rastet kur institucioni i parasë elektronike synon të ofrojë shërbimet nëpërmjet agentit, përveç sa parashikohet në nenin 21, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, institucioni i parasë elektronike zbaton edhe kërkesat e parashikuara në nenin 30 të kësaj rregulloreje.

2. Institucionet e parasë elektronike nuk mund të emetojnë para elektronike nëpërmjet agentëve, por mund të shpërndajnë dhe/ose të ripaguajnë fondet nëpërmjet një ose më shumë agentëve, të cilët veprojnë për llogari të tyre.

3. Institucioni i parasë elektronike mund të lidhë marrëveshje me të tretët për transferimin e funksioneve operacionale, për të cilat zbatohen kërkesat e nenit 21, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

4. Kërkesat e parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme në procesin e licencimit të institucioneve të parasë elektronike dhe në rastet e agentëve të rinj, si dhe të marrëveshjeve të reja me të tretët.



KREU III
KËRKESAT PËR REGJISTRIMIN E
OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË
PAGESAVE QË PËRFITOJNË NGA
PËRJASHTIMET, SIPAS PËRCAKTIMEVE
NË LIGJIN “PËR SHËRBIMET E
PAGESAVE”

NËNKREU I
KËRKESAT NË LIDHJE ME
DOKUMENTACIONIN
PËR SUBJEKTET QË APLIKOJNË PËR
REGJISTRIM, PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT
SIPAS PIKËS 8, TË ANEKSIT 1, TË LIGJIT
“PËR SHËRBIMET E PAGESAVE”

Neni 50

Kërkesa të përgjithshme

1. Kërkesat e parashikuara në këtë nënkre, zbatohen për subjektet që aplikojnë për regjistrim, si ofrues të shërbimit të informimit të llogarisë, të cilët kërkojnë të ofrojnë vetëm shërbimin e parashikuar në pikën 8, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”. Në rast se aplikuesi ka për qëllim të ofrojë shërbime të tjera, përveç shërbimit të informimit të llogarisë, ai duhet të aplikojë për licencim si institucion pagese dhe të zbatojë kërkesat e parashikuara në kreun II të kësaj rregulloreje për institucionet e pagesave.

2. Kërkesa për regjistrim, si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, bëhet me shkrim nga themeluesit ose administratori i subjektit, ose nga një person i autorizuar ligjrisht prej tyre (sipas formularit nr. 1 të kësaj rregulloreje). Kërkesa shoqërohet nga formularët e plotësuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacioni i parashikuar në nenet 51–61 të kësaj rregulloreje.

3. Subjektet që aplikojnë për regjistrim, si ofrues të shërbimit të informimit të llogarisë, paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë informacionin, sipas kërkesave të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje, i cili është i vërtetë, i plotë, i saktë dhe i përditësuar.

4. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, për paraqitjen e dokumentacionit/informacionit të kërkuar në Bankën e Shqipërisë, në lidhje me aktet/procedurat apo dokumentet e brendshme të veprimtarisë,

ekstrakton/nxjerr/shkëput seksionet përkatëse të këtyre akteve/procedurave apo dokumenteve, si dhe paraqet referencat ndaj këtyre seksioneve, sipas kërkesave përkatëse të parashikuara në këtë rregullore.

5. Banka e Shqipërisë, për regjistrimin si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, bën shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, sipas afateve të përcaktuara në këtë nen dhe në përputhje me kërkesat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje.

6. Banka e Shqipërisë regjistron ofruesin e shërbimit të informimit të llogarisë, brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për regjistrim.

Data e pranimit të kërkesës për regjistrim konsiderohet data kur kërkuuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuarit nga Banka e Shqipërisë.

7. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe këtë rregullore, Banka e Shqipërisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune, do të dërgojë një njoftim për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje, së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacion shtesë.

8. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për regjistrim, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për regjistrim nuk plotësohet nga subjekti, brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për regjistrim. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për regjistrim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin.

9. Nëse Banka e Shqipërisë kërkon sqarime të mëtejshme mbi dokumentacionin/informacionin e paraqitur, aplikuesi duhet t’i paraqesë këto sqarime brenda një kohe të arsyeshme/të përshtatshme.

10. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, paguan një komision për përpunimin e kërkesës për regjistrim, prej 10,000 (dhjetë mijë) lekësh në Bankën e Shqipërisë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës. Ky komision nuk rimbursohet edhe në rast të refuzimit të regjistrimit nga Banka e Shqipërisë.



11. Banka e Shqipërisë regjistron në regjistrin e subjekteve ofruesin e shërbimit të informimit të llogarisë, si dhe listën e agentëve të tij (nëse është e aplikueshme), me të dhënat përkatëse, në zbatim të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

12. Banka e Shqipërisë pajis ofruesin e shërbimit të informimit të llogarisë me vendimin për regjistrimin në regjistrin publik.

Neni 51

Kërkesat mbi të dhënat identifikuese të subjektit

1. Nëse aplikuesi është person fizik, të dhënat e identifikimit, që do të paraqiten sipas formularit nr. 3/1 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë, numrin personal të identifikimit ose numrin e pasaportës dhe adresën;

b) kopje të kartës së identitetit/pasaportës ose një dokumenti ekuivalent zyrtar identifikimi;

c) një *curriculum vitae* (CV) të përditësuar (sipas formularit nr. 4 të kësaj rregulloreje);

d) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial:

i. se personi nuk është në ndjekje penale;

ii. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii. se personi nuk është i dënuar penalisht.

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;

e) emrin/at e personit/personave të autorizuar për ndjekjen e aplikimit dhe procedurën e regjistrimit, si edhe të dhënat e tyre të kontaktit.

2. Nëse aplikuesi është person juridik, të dhënat e identifikimit, që duhet të paraqiten nga aplikuesi sipas formularit nr. 3/1 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e shoqërisë/subjektit që aplikon dhe, nëse është i ndryshëm, emrin tregtar;

b) ekstraktin e regjistrit tregtar për regjistrimin e subjektit si person juridik, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria për të cilën subjekti kërkon të regjistrohet, si dhe Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIIS);

c) statutin e shoqërisë;

d) adresën e selisë qendrore të aplikuesit;

e) adresën e postës elektronike dhe faqen zyrtare të internetit të aplikuesit (nëse ka);

f) emrin/at e personit/personave të autorizuar për ndjekjen e aplikimit dhe procedurën e regjistrimit, si edhe të dhënat e tyre të kontaktit;

g) informacion nëse aplikuesi është aktualisht ose ka qenë ndonjëherë subjekt i rregullimit e mbikëqyrjes së një autoriteti tjetër mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare.

Neni 52

Kërkesat për informacion mbi programin e veprimtarive

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “a”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë programin e veprimtarive (operacioneve), i cili përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të shërbimit të informimit të llogarisë që do të ofrohet, duke përfshirë një shpjegim mbi mënyrën se si aplikuesi ka përcaktuar se veprimtaria që parashikon të kryejë i korrespondon përkufizimit të shërbimit të informimit të llogarisë, të parashikuar në nenin 5, pika 38, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

b) një deklaratë se aplikanti nuk do të hyjë asnjëherë në zotërim/posedim të fondeve të klientëve/përdoruesve të shërbimeve të pagesave;

c) një përshkrim të ofrimit të shërbimit të informimit të llogarisë, që përfshin:

i. kontratat tip midis të gjitha palëve të përfshira në ofrimin e shërbimit, nëse është e aplikueshme;

ii. termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimit të informimit të llogarisë;

iii. kohën e përpunimit;

d) numrin e parashikuar të degëve në të cilat aplikuesi parashikon të ofrojë shërbimet, nëse është e aplikueshme;

e) një përshkrim të shërbimeve operationale dhe ndihmëse të shërbimit të informimit të llogarisë, të parashikuara në nenin 19, pika 1, shkronja “a”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, nëse është e aplikueshme;

f) informacion nëse aplikuesi ka për qëllim, për tre vitet e ardhshme, të ofrojë ose ofron tashmë veprimtari të tjera tregtare, përveç shërbimit të informimit të llogarisë, siç përcaktohen në nenin



19, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, përfshirë një përshkrim të llojit dhe volumit të parashikuar të veprimtarive;

g) informacionin e përcaktuar në udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, në përputhje me nenin 7, pikat 2, 3 dhe 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, kur aplikuesi synon të ofrojë vetëm shërbimin sipas pikës 8 (shërbimin e informimit të llogarisë), të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

h) informacion për investimet në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të shoqëruar me listën e pajisjeve, programeve, etj.

Neni 53

Kërkesat mbi planin e biznesit

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “b”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë planin e biznesit, i cili përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një analizë të pozicionit konkurrues të aplikuesit;

b) një përshkrim të kategorive të përdoruesve të shërbimit të informimit të llogarisë në segmentin përkatës të tregut;

c) një parashikim të gjendjes financiare të aplikuesit për 3 vitet e para të veprimtarisë, që tregon se aplikuesi është në gjendje të sigurojë ushtrimin e një veprimtarie të qëndrueshme, që përfshin:

i. një parashikim të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të bilancit kontabël dhe shpjegime të zërave kryesorë të tyre, duke përfshirë edhe informacion mbi supozimet për numrin e klientëve, çmimin e shërbimit dhe rritjen e parashikuar të fitimit, etj.;

ii. një skemë dhe ndarje të hollësishme të flukseve të parashikuara të parasë për tri vitet e ardhshme;

d) nëse subjekti ka ushtruar një veprimtari tjetër, përpara aplikimit për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, pasqyrat financiare vjetore të audituara për tre vitet paraardhëse dhe, në rastin e një shoqërie më të re, pasqyrat financiare të audituara që nga krijimi.

Neni 54

Kërkesat mbi organizimin strukturor

1. Në rastin kur subjekti që aplikon për regjistrim, si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, është person fizik, ai paraqet pranë Bankës së Shqipërisë përshkrimin e organizimit strukturor, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “h”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një parashikim të numrit të përgjithshëm të punonjësve për tre vitet e ardhshme;

b) kopje të marrëveshjeve me të tretët për transferimin e funksioneve operacionale të shërbimit të pagesave, si dhe një përshkrim të këtyre marrëveshjeve, që përmban:

i. identitetin dhe vendndodhjen gjeografike të ofruesit të shërbimit;

ii. identitetin e personave brenda ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, të cilët janë përgjegjës për secilin nga shërbimet e ofruara nga të tretët;

iii. një përshkrim të detajuar të shërbimeve të ofruara nga të tretët dhe karakteristikave kryesore të tyre;

c) një përshkrim mbi degët dhe agentët, kur është e aplikueshme, duke përfshirë:

i. një parashikim të kontrolleve në distancë dhe në vend, që aplikuesi planifikon të realizojë, në degët dhe agentët, si dhe frekuencën e këtyre kontrolleve;

ii. sistemet e teknologjisë së informacionit, proceset dhe infrastrukturën e përdorur nga agentët e aplikuesit, që do të veprojnë për llogari të aplikuesit;

iii. në rastin e agentëve, kriteret e përzgjedhjes së tyre, procedurat e monitorimit dhe trajnimet për agentët;

d) listën e personave fizikë ose juridikë, me lidhje të ngushta me aplikuesin, së bashku me identitetin e tyre dhe natyrën e këtyre lidhjeve.

2. Në rastin kur subjekti që aplikon për regjistrim, si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, është person juridik, ai paraqet pranë Bankës së Shqipërisë përshkrimin e organizimit strukturor të shoqërisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “h”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, që përmban informacionin e mëposhtëm:



a) një organigramë të detajuar të strukturës organizative, duke paraqitur çdo njësi, departament, ose ndarje të ngjashme strukturore, në të cilën përcaktohen emrat e personave përgjegjës dhe përshkrimet e funksioneve dhe përgjegjësi, veçanërisht të personave të ngarkuar me funksionet e kontrollit të brendshëm;

b) një parashikim të numrit të përgjithshëm të punonjësve për tre vitet e ardhshme;

c) kopje të marrëveshjeve me të tretët për transferimin e funksioneve operationale të shërbimit të pagesave, si dhe një përshkrim të këtyre marrëveshjeve, që përmban:

i. identitetin dhe vendndodhjen gjeografike të ofruesit të shërbimit;

ii. identitetin e personave brenda ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, të cilët janë përgjegjës për secilin nga shërbimet e ofruara nga të tretët;

iii. një përshkrim të detajuar të shërbimeve të ofruara nga të tretët dhe karakteristikave kryesore të tyre;

d) një përshkrim mbi degët dhe agentët, kur është e aplikueshme, duke përfshirë:

i. një parashikim të kontrolleve në distancë dhe në vend, që aplikuesi planifikon të realizojë, në degët dhe agentët, si edhe frekuencën e këtyre kontrolleve;

ii. sistemet e teknologjisë së informacionit, proceset dhe infrastrukturën e përdorur nga agentët e aplikuesit, që do të veprojnë për llogari të aplikuesit;

iii. në rastin e agentëve, kriteret e përzgjedhjes së tyre, procedurat e monitorimit dhe trajnimet për agentët;

e) listën e personave fizikë ose juridikë, me lidhje të ngushta me aplikuesin, së bashku me identitetin e tyre dhe natyrën e këtyre lidhjeve.

3. Në rastet kur ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë synon të ofrojë shërbimin e pagesave nëpërmjet agentit, paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin, sipas formularit nr. 8 të kësaj rregulloreje, i cili përmban:

a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e agentit;

b) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të subjektit;

c) shërbimin e pagesave që do të kryejë agjenti.

4. Kërkesat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni janë të zbatueshme në procesin e regjistrimit të ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë dhe në rastet e agentëve të rinj.

Neni 55

Kërkesat mbi sistemin e drejtimit dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “d”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë, një përshkrim të sistemit të drejtimit dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm, që përfshin:

a) një përshkrim të llojeve të rreziqeve të identifikuar nga aplikuesi (përfshirë edhe për degët dhe agentët, nëse është e aplikueshme), si dhe të procedurave që aplikuesi do të zbatojë për vlerësimin dhe parandalimin e këtyre rreziqeve;

b) procedurat për kryerjen e kontrolleve periodike dhe të vazhdueshme, duke përfshirë frekuencën e këtyre kontrolleve dhe burimet njerëzore në dispozicion;

c) procedurat kontabël nëpërmjet të cilave aplikuesi do të regjistrojë dhe do të raportojë informacionin financiar;

d) identitetin e personit/personave përgjegjës për funksionin e kontrollit të brendshëm, përfshirë kontrollin periodik dhe të vazhdueshëm, dhe për funksionin e përputhshmërisë, si dhe një *curriculum vitae* (CV) të përditësuar të këtyre personave;

e) përbërjen e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të komitetit të kontrollit, si dhe të ndonjë komiteti tjetër në nivel këshilli administrimi/mbikëqyrës (nëse është e aplikueshme);

f) një përshkrim të mënyrës së monitorimit dhe kontrollit të funksioneve operationale të transferuara tek të tretët (*outsourcing*), me qëllim që të parandalohet çdo cenim i cilësisë së kontrollit të brendshëm të aplikantit;

g) një përshkrim të mënyrës se si monitorohen dhe kontrollohen agentët ose degët, brenda kuadrit të kontrollit të brendshëm të aplikuesit;

h) një përshkrim të organeve drejtuese dhe të subjekteve që përbëjnë grupin, në rastin kur aplikuesi është filial i një subjekti të rregulluar nga një shtet tjetër.



Neni 56

Kërkesat për procedurat për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e ngjarjeve që cenojnë sigurinë, dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë një përshkrim të procedurave të hartuara për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e një ngjarjeje që cenon sigurinë, dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë, i cili duhet të përmbajë:

- a) masat organizative dhe mjetet për parandalimin e mashtrimit;
- b) të dhënat e personave përgjegjës dhe të organeve përgjegjëse të aplikuesit, për të asistuar klientët në rastet e mashtrimit, të problemeve teknike dhe/ose të administrimit të ankesave/pretendimeve;
- c) linjat e raportimit në rast mashtrimi;
- d) personin e kontaktit për klientët, përfshirë emrin dhe adresën elektronike;
- e) procedurat për raportimin e incidenteve, përfshirë komunikimin e këtyre ngjarjeve tek organet përkatëse, të brendshme dhe të jashtme, përfshirë njoftimin në Bankën e Shqipërisë për incidentet madhore, në përputhje me nenin 89, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe me aktet nënligjore përkatëse;
- f) instrumentet e monitorimit që do të përdoren dhe masat e procedurat për ndjekjen e zbutjes së rreziqeve të sigurisë.

Neni 57

Kërkesat mbi procesin e regjistrimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të të drejtave të hyrjes në të dhënat sensitive të pagesës

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “e”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë një përshkrim të procesit të regjistrimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të të drejtave të hyrjes (aksesit) në të dhënat sensitive të pagesës, i cili duhet të përmbajë:

a) një përshkrim të rrjedhës së të dhënave të klasifikuara si të dhëna sensitive të pagesës, në kontekstin e modelit të biznesit të ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë;

b) procedurat për autorizimin e së drejtës së hyrjes në të dhënat sensitive të pagesës;

c) një përshkrim të instrumenteve të monitorimit;

d) politikën e të drejtave të hyrjes, duke detajuar të drejtat e hyrjes (aksesit) në të gjitha sistemet dhe komponentët e infrastrukturës përkatëse, përfshirë bazën e të dhënave dhe infrastrukturën e *back-up*-it;

e) një përshkrim të mënyrës së regjistrimit të të dhënave të grumbulluara;

f) përdorimin e brendshëm dhe të jashtëm të të dhënave të grumbulluara, përfshirë ato nga kundërpartitë;

g) sistemin e teknologjisë së informacionit (IT) dhe masat teknike të sigurisë të zbatuara, përfshirë enkriptimin dhe/ose përdorimin e dy ose më shumë faktorëve të autentifikimit (*tokenisation*);

h) identifikimin e personave, organeve dhe/ose komiteteve me të drejta hyrjeje në të dhënat sensitive të pagesave;

i) një shpjegim si gjurmohen/zbulohen dhe adresohen incidentet apo shkeljet/thyerjet e konfidencialitetit dhe integritetit të informacionit;

j) programin vjetor të kontrollit të brendshëm, në lidhje me sigurinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Neni 58

Kërkesat mbi planin e vazhdimësisë së biznesit

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “ë”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë një përshkrim të planit të vazhdimësisë së biznesit, i cili përbëhet nga informacioni i mëposhtëm:

a) një analizë të ndikimit në biznes, përfshirë proceset e biznesit dhe objektivat e rimëkëmbjes, të tilla si: objektivat mbi kohën e rimëkëmbjes, objektivat për pikën e rimëkëmbjes dhe aktivet e ruajtura/mbrojtura, përfshirë edhe informacionin;

b) identifikimi i ambienteve dytësore (*back-up*) në rast të aktivizimit të planit të vazhdimësisë së biznesit, të drejtave të hyrjes në infrastrukturën e



teknologjisë së informacionit, si dhe matricën e të drejtave të hyrjes në programin/programet bazë (*key software*) dhe të dhënat kryesore që do të shërbejnë për rimëkëmbjen, në rast ndërprerjeje të veprimtarisë apo fatkeqësie/katastrofe;

c) një shpjegim të mënyrës sipas së cilës aplikuesi do të trajtojë ngjarje të rëndësishme të vazhdueshmërisë apo ndërprerjes së veprimtarisë, siç është mosfunksionimi i sistemeve kryesore, humbja e të dhënave kryesore, pamundësia për të hyrë në mjediset e punës, apo humbja e personave kyç (kryesorë) të aplikuesit;

d) frekuenca me të cilën aplikuesi synon të testojë planet e vazhdimësisë së biznesit dhe të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, përfshirë mënyrën se si do të regjistrohen rezultatet e testimit.

Neni 59

Kërkesat mbi dokumentin e politikës së sigurisë

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “g”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë një dokument të politikës së sigurisë, që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një vlerësim të detajuar të rreziqeve të lidhur me shërbimin e pagesave që aplikuesi kërkon të ofrojë, i cili duhet të përfshijë edhe rreziqet e mashtrimit dhe kontrollin e sigurisë dhe masat zbutëse të marra për të mbrojtur në mënyrën e duhur përdoruesit e shërbimeve të pagesave ndaj rreziqeve të identifikuara;

b) një përshkrim të sistemeve të teknologjisë së informacionit, që përfshin:

i. arkitekturën e sistemeve dhe elementeve të rrjetit të tyre;

ii. sistemet e teknologjisë së informacionit të biznesit që mbështesin aktivitetet e biznesit, si faqen e internetit të aplikuesit, mënyrën e administrimit të rrezikut dhe të rasteve të mashtrimit dhe të identifikimit dhe kontabilizimit të klientëve;

iii. sistemet mbështetëse të teknologjisë së informacionit që përdoren për organizimin dhe administrimin e ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, të tilla si: sistemi kontabël, sistemet e raportimit sipas kërkesave rregullatore, administrimi i personelit, administrimi i

marrëdhënieve me klientët, serverët e postës elektronike dhe serverët e dokumenteve/skedarëve të brendshëm;

iv. informacion nëse këto sisteme përdoren tashmë nga aplikuesi apo grupi në të cilin bën pjesë, si dhe data e parashikuar e zbatimit, nëse është e aplikueshme;

c) llojin e kontakteve/lidhjeve të autorizuar nga jashtë, të tillë si: lidhjet me bashkëpunëtorët/partnerët, me ofruesit e shërbimeve, me subjektet e grupit dhe me punonjësit që punojnë në distancë, duke përfshirë arsyen/argumentimin e këtyre kontakteve/lidhjeve;

d) për secilin prej kontakteve të renditura në shkronjën “c”, masat dhe mekanizmat logjike të sigurisë të krijuara, duke specifikuar kontrollin që aplikuesi do të ketë mbi këtë të drejtë hyrjeje/aksesi, si edhe natyrën dhe frekuencën e secilit kontroll, atij teknik kundrejt atij organizativ, atij parandalues kundrejt atij gjurmues, dhe monitorimin në kohë reale kundrejt rishikimeve rutinë/periodike, si përdorimi i një rrjeti aktiv të ndarë nga grupi, hapja/mbyllja e linjave të komunikimit, konfigurimi i mjeteve/pajisjeve të sigurisë, gjenerimi i çelësave (*keys*) ose certifikatave të autentifikimit të klientëve, monitorimi i sistemit, autentifikimi, konfidencialiteti i komunikimit, zbulimi i ndërhyrjeve, sistemet antivirus dhe regjistrat e aksesimeve (*logs*);

e) masat dhe mekanizmat logjike të sigurisë që rregullojnë të drejtën e hyrjes/aksesit të brendshëm në sistemet e teknologjisë së informacionit, të cilat duhet të përfshijnë:

i. natyrën teknike dhe organizative, si dhe frekuencën e çdo mase, nëse masa është e natyrës parandaluese apo zbuluese, si dhe nëse është ndërmarrë ose jo në kohë reale;

ii. mënyrën si trajtohet ndarja e mjediseve të klientit kur burimet e teknologjisë së informacionit të aplikuesit janë të përbashkëta;

f) masat dhe mekanizmat e sigurisë fizike të ambienteve/ndërtesës dhe qendrës së të dhënave të aplikuesit, të tilla si kontrolli i të drejtës së hyrjes/aksesit dhe sigurisë së mjedisit;

g) sigurinë e proceseve të pagesave, e cila duhet të përfshijë:

i. procedurën e autentifikimit të klientit, të përdorur për hyrjen (aksesin), për qëllime këshilluese ose transaksionale;



ii. një shpjegim për mënyrën se si realizohet dërgimi i sigurt të përdoruesi i ligjshëm i shërbimit të pagesave dhe integriteti i faktorëve të autentifikimit, të tillë si pajisjet për gjenerimin e fjalëkalimeve me një përdorim (*hardware tokens*) dhe aplikacionet për *mobile banking*, si në kohën e regjistrimit fillestar, ashtu edhe të rinovimit;

iii. një përshkrim të sistemeve dhe procedurave që aplikuesi zbaton për analizën e transaksionit dhe identifikimin e transaksioneve të dyshimta ose të pazakonta;

h) një vlerësim të detajuar të rreziqeve në lidhje me shërbimet e pagesave, përfshirë rrezikun e mashtrimit, duke e lidhur me kontrollin dhe masat zbutëse të përcaktuara/përshkruara në dokumentin e aplikimit, të cilat sigurojnë adresimin e duhur të tyre (rreziqeve);

i) procedurat kryesore të shkruara në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit të aplikuesit, ose për procedurat që nuk janë formalizuar ende, një datë e parashikuar për përfundimin/finalizimin e tyre, të cilat marrin në konsideratë edhe kërkesat e rregullores “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”.

Neni 60

Kërkesat mbi vlerësimin e përshtatshmërisë së administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë

1. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë paraqet në Bankën e Shqipërisë identitetin e çdo anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të administratorit dhe të çdo anëtarit të komitetit të kontrollit.

2. Subjekti që aplikon për regjistrim si ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë, për qëllime të vlerësimit të përshtatshmërisë së kryetarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit dhe kryetarit të komitetit të kontrollit, në përputhje me nenin 7, pika 1, shkronja “j”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e parashikuar në nenin 67 të kësaj rregulloreje. Këta persona në çdo rast duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 66 të kësaj rregulloreje.

3. Kërkesat e parashikuara në këtë nen janë të zbatueshme edhe në rastet e ndryshimit ose të riemërimit (zgjatjes së afatit të emërimit) të personave, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, pas regjistrimit të subjektit.

Neni 61

Kërkesat mbi siguracionin e dëmshpërblimit profesional ose ndonjë garanci tjetër të krahasueshme, për shërbimet e informimit të llogarisë

1. Subjekti që aplikon për regjistrim për të ofruar shërbimin e informimit të llogarisë, siç parashikohet në nenin 7, pika 3, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, si evidencë të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose garancisë së krahasueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm:

a) një kontratë sigurimi ose dokument tjetër ekuivalent që konfirmon ekzistencën e siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose garancive të krahasueshme, me një vlerë mbulimi në përputhje me udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, që tregon mbulimin e detyrimeve (përgjegjësi) përkatëse;

b) dokumentacion për mënyrën si aplikuesi e ka llogaritur këtë shumë minimale, në mënyrë që të jetë në përputhje me udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”, përfshirë të gjitha elementet e formulës së përcaktuar në të.



NËNKREU II

KËRKESAT PËR REGJISTRIMIN E
PERSONAVE QË PËRFITOJNË NGA
PËRJASHTIMET, SIPAS NENIT 4,
SHKRONJAT “GJ” DHE “H”, TË LIGJIT
“PËR SHËRBIMET E PAGESAVE”

Neni 62

**Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve të
parashikuar në nenin 4, shkronja “gj”,
nënndarjet “i” dhe “ii”, të ligjit “Për shërbimet
e pagesave”**

1. Kërkesat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje, përveç sa parashikohet në nenin 31, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në këtë nen, nuk do të zbatohen për ofruesit e shërbimeve që kryejnë njërin prej veprimtarive ose të dyja njëkohësisht, sipas nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “gj”, të nenit 4, të ligjit të sipërcituar.

2. Në rast se Banka e Shqipërisë, në bazë të nenit 31, pika 2, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, merr një vendim të mirëargumentuar për mosvazhdimësinë e përjashtimit nga ligji, ofruesi i shërbimeve duhet të paraqesë informacion dhe dokumentacion në përputhje me nenin 51 të kësaj rregulloreje, me qëllim regjistrimin e tij në regjistrin publik të përcaktuar në nenin 16 dhe nenit 31, pika 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

3. Banka e Shqipërisë mund të kryejë verifikimin në vend në këto subjekte apo persona, mbi plotësimin e kërkesave të këtij neni.

4. Banka e Shqipërisë pajis ofruesit e shërbimeve, të parashikuara në nenin 4, shkronja “gj”, nënndarjet “i” dhe “ii”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, me vendimin për regjistrimin në regjistrin publik.

Neni 63

**Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve të
parashikuara në nenin 4, shkronja “h”, të ligjit
“Për shërbimet e pagesave”**

1. Ofruesi i shërbimeve të parashikuara në shkronjën “h”, të nenit 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” njofton Bankën e Shqipërisë dhe paraqet opinionin vjetor të audituesit ligjor, sipas nenit 31, pika 3, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, si dhe dokumentacionin në përputhje me nenin 51, të

kësaj rregulloreje, me qëllim regjistrimin në regjistrin publik të përcaktuar në nenin 16 dhe nenin 31, pika 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

2. Banka e Shqipërisë pajis ofruesin e shërbimeve të parashikuara në shkronjën “h”, të nenit 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, me vendimin për regjistrimin në regjistrin publik.

3. Kërkesat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje do të zbatohen për ofruesit e shërbimeve të parashikuara në shkronjën “h”, të nenit 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) vlera e një transaksioni të vetëm pagese tejkalon shumën prej 3,000 (tre mijë) lekësh;

b) vlera kumulative (në total) e transaksioneve, për çdo klient, tejkalon shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në muaj; si dhe

c) vlera e parapaguar në total për transaksionet e çdo klienti, në rastin e llogarive me parapagim, tejkalon shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në muaj.

4. Në rast se tejkalohen limitet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të aplikojnë për licencim si institucion pagese dhe të zbatojnë kërkesat e parashikuara në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe në kreun II, të kësaj rregulloreje për institucionet e pagesave.

5. Ofruesit e shërbimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përveç sa parashikohet në nenin 31, pika 3, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, paraqesin çdo informacion dhe dokumentacion shtesë që kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

6. Banka e Shqipërisë mund të kryejë verifikimin në vend në këto subjekte apo persona, mbi plotësimin e kërkesave të këtij neni.



KREU IV
MIRATIMET DHE DETYRIMI
PËR NJOFTIM

NËNKREU I
MIRATIMET GJATË USHTRIMIT
TË VEPRIMTARISË

Neni 64

Miratimet gjatë ushtrimit të veprimtarisë

1. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, nuk mund:

a) të ofrojë shërbime të pagesave sipas aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, të papërfshira në licencën e dhënë;

b) të zvogëlojë kapitalin;

c) të emërojë/riemërojë një ose disa administratorë, kryetarin e këshillit të administrimit /mbikëqyrës dhe kryetarin e komitetit të kontrollit;

d) të ndryshojë (nëpërmjet blerjes, shitjes ose transferimit) pjesëmarrjen influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose kontrollin e subjektit, siç parashikohet në nenin 8, pika 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

e) të kryejë veprimtarinë si agjent në sigurime.

2. Ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, nuk mund të emërojë/riemërojë një ose disa administratorë, kryetarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe kryetarin e komitetit të kontrollit.

3. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimin, sipas pikës 1 dhe 2, të këtij neni, brenda 2 (dy) muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 65 të kësaj rregulloreje.

4. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratim, sipas pikës 1 dhe 2, të këtij neni, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohen nga subjekti brenda 3 (tre) muajve pas datës së aplikimit fillestar. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, sipas pikës 1 dhe 2, të këtij neni, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin.

Neni 65

**Kërkesa në lidhje me dokumentacionin
për miratimet**

1. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike, për të marrë miratimin për sa parashikohet në shkronjat “b”, “c”, “d” dhe “e”, të nenit 64, të kësaj rregulloreje, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) për zvogëlimin e kapitalit:

i. vendimin e asamblesë për zvogëlimin e kapitalit; dhe

ii. relacionin shoqërues me arsyet e këtij ndryshimi;

b) për të emëruar/riemëruar administratorin/ët, kryetarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe kryetarin e komitetit të kontrollit:

i. dokumentacionin sipas nenit 67 të kësaj rregulloreje;

c) për ndryshimin (nëpërmjet blerjes, shitjes ose transferimit) e pjesëmarrjes influencuese, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose kontrollit të subjektit, siç parashikohet në nenin 8, pika 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”:

i. vendimin e asamblesë për miratimin e këtij ndryshimi;

ii. dokumentacionin e kërkuar në nenin 26, për institucionet e pagesave dhe në nenin 45, të kësaj rregulloreje, për institucionet e parasë elektronike; dhe

iii. kopje të aktmarrëveshjes së nënshkruar për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese ose kontrollit të subjektit;

d) për kryerjen e veprimtarisë si agjent në sigurime:

i. vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë;

ii. ekstraktin e regjistrimit tregtar të lëshuar nga QKB-ja, në të cilin të jetë përcaktuar veprimtaria e kërkuar; dhe

iii. planin e biznesit për tre vitet e ardhshme nga veprimtaria.

2. Banka e Shqipërisë, sipas rastit, mund të kërkojë edhe dokumente shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

3. Banka e Shqipërisë, për të kryer vlerësimet e parashikuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse



homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar, dhe për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Tatim-Taksave, etj.

Neni 66

Kriteret e emërimit/riemërimit të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit dhe anëtarëve të komitetit të kontrollit

1. Institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë, në përputhje me natyrën, madhësinë, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e rrezikut të subjektit, mund të krijojë komitete të specializuara në nivel këshilli administrimi / mbikëqyrës, të tilla si: komiteti i kontrollit, rrezikut/qeve, etj., të cilat këshillojnë/asistojnë këshillin për çështje të veçanta.

2. Anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratori i institucionit të pagesave, institucionit të parasë elektronike dhe ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, duhet të plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë universitare ose minimalisht të kenë kryer programin e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë (në rastin e shtetasve shqiptarë), si rregull në ekonomi ose jurisprudencë;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se 5 (pesë) vjet, nga të cilat 3 vjet përvojë në sektorin bankar dhe/ose financiar ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga Banka e Shqipërisë;

c) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional.

3. Anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratori, përveç sa përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, duhet të plotësojnë, të paktën, kriteret e mëposhtme:

a) të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;

b) të mos jenë në ndjekje penale ose të mos jenë shpallur fajtorë nga gjykata për një vepër penale;

c) të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentit, si dhe të jenë çliruar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara;

d) të mos jenë ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 viteve të fundit për shkelje të ligjit “Për bankat” dhe ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

4. Anëtarët e komitetit të kontrollit (kur është e aplikueshme), përveç sa përcaktohet në shkronjat “a” deri në “d”, të pikës 3, të këtij neni, duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë universitare, si rregull në ekonomi;

b) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional; dhe

c) të kenë eksperiencë jo më pak se 3 vjet në fushën e kontabilitetit, të auditimit ose kredidhënies.

Neni 67

Dokumentacioni për miratimin e kryetarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit dhe kryetarit të komitetit të kontrollit

1. Institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë paraqesin një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, për marrjen e miratimit për kryetarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorin dhe për kryetarin e komitetit të kontrollit, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e organit kompetent, për emërimin e personit, si dhe datën e parashikuar të fillimit të marrëdhënies së punësimit (në rastin e emërimit) dhe kohëzgjatjen e mandatit;

b) emrin, vendin dhe datën e lindjes, adresën dhe shtetësinë, si dhe numrin personal të identifikimit dhe kopje të kartës së identitetit ose të një mjeti tjetër identifikimi (pasaportë);

c) diplomën e arsimit sipas kërkesave të nenit 66 të kësaj rregulloreje dhe dokumente që vërtetojnë kualifikime të tjera të personit;

d) *curriculum vitae* (CV) të nënshkruar (sipas formularit nr. 4, të kësaj rregulloreje);

e) të paktën një referencë/rekomandim lidhur me aftësinë profesionale, të lëshuar nga eprorë ose punëdhënës të mëparshëm;



f) nëse është e aplikueshme, informacion mbi vlerësimin e përshtatshmërisë, të kryer nga vetë subjekti, i cili duhet të përfshijë të dhëna mbi rezultatet e çdo vlerësimi të përshtatshmërisë së personit të kryer nga institucioni/ofruesi, të tilla si: minutat e mbledhjeve të asamblesë/bordit ose raportet e vlerësimit të përshtatshmërisë ose dokumente të tjera;

g) një përshkrim të detajuar të punës, për pozicionin që do të mbajë personi i propozuar, si dhe të detyrave kryesore dhe përgjegjësi të tij;

h) deklaratën personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;

i) deklaratën personale, që nuk ka qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;

j) deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje);

k) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, që vërtetojnë se:

i. personi nuk është në ndjekje penale;

ii. personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii. personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);

iv. personi nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm (nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor).

Vërtetimet e përmendura në shkronjën “k”, duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

2. Në rastin kur individ i propozuar është shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në rast se është e aplikueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë edhe lejen e tij të qëndrimit dhe të punës (nëse është e aplikueshme), në bazë dhe për zbatim të ligjit “Për të huajt”.

3. Institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë, në rastet e riemërimit të kryetarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të administratorit dhe të kryetarit të komitetit të kontrollit, paraqet në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim, për miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e riemërimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni;

b) *curriculum vitae* (CV) të përditësuar, të plotësuar sipas formularit nr. 4 të kësaj rregulloreje;

c) një informacion/relacion të detajuar për vlerësimin dhe kontributin e kryetarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të administratorit dhe të kryetarit të komitetit të kontrollit, në drejtimin efektiv të subjektit;

d) informacione të tjera shtesë, të cilat mund të gjykohen të nevojshme.

Neni 68

Dokumentacioni për anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe të komiteti të kontrollit

Institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë mban në dosje të veçanta, dokumentacionin e parashikuar në nenin 67 të kësaj rregulloreje, për anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe të komitetit të kontrollit, që nuk janë subjekt miratimi nga Banka e Shqipërisë.

NËNKREU II

VEPRIMTARITË/SHËRBIMET SHITESË

Neni 69

Veprimtaritë/shërbimet shtesë

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike ka të drejtë t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë, të lejohet të kryejë veprimtari/shërbime të tjera sipas aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, të papërfshira në licencën e dhënë, duke plotësuar kërkesat e nenit 5 dhe nenit 70, të kësaj rregulloreje.

Neni 70

Dokumentacioni për miratimin e veprimtarisë/shërbimit shtesë

1. Kërkesa për të ushtruar veprimtari/shërbime shtesë bëhet me shkrim nga administratori i subjektit ose një person i autorizuar ligjërish prej tij dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i organit vendimmarrës të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë/shërbimit shtesë;



b) ekstrakti i Regjistrimit Tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në të cilin të jenë përcaktuar edhe veprimtaritë/shërbimet shtesë në objektin e shoqërisë;

c) dokumenti që vërteton pagimin e shtesës së shumës së kapitalit fillestar minimal, në qoftë se kapitali i llogaritur nuk plotëson kërkesën për kapital, për veprimtarinë që kërkon të kryejë subjekti, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje;

d) informacioni mbi plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë, sipas rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare”, për kryerjen e veprimtarisë/shërbimit shtesë, në rast se kjo e fundit është veprimtari me sportel dhe/ose me agjentë;

e) rregulloret dhe/ose manualët e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë/shërbimit shtesë;

f) parashikimi për 3 (tre) vitet e ardhshme, i treguesve financiarë për veprimtaritë/shërbimet shtesë dhe ndikimin e tyre në gjendjen e përgjithshme financiare të subjektit.

Neni 71

Shqyrtimi i kërkesës për veprimtari/shërbime shtesë

1. Banka e Shqipërisë bën shqyrtimin e plotësimit të kërkesës për kapital dhe dokumentacionit për ushtrimin e veprimtarive/shërbimeve shtesë, në përputhje me kërkesat e neneve 5 dhe 70, të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë jep miratimin për kryerjen e veprimtarive/shërbimeve shtesë nëse vlerëson se këto veprimtari/shërbime nuk vënë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike dhe plotësohen kushtet teknike për ushtrimin e sigurt të tyre.

3. Në rastin e refuzimit të kërkesës për të ushtruar veprimtari/shërbime shtesë, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

NËNKREU III DETYRIMI PËR NJOFTIM

Neni 72

Kërkesat mbi detyrimet për njoftim

1. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë, në rastet kur:

a) pozicionet e rrezikut arrijnë kufijtë maksimalë të lejuar të ekspozimit, sipas akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

b) vlerësohet se ka shkaqe të justifikuara për ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë veprimtarie/shërbimi të lejuar;

c) vlerësohet se ka shkaqe për shfuqizimin e licencës.

2. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike njofton Bankën e Shqipërisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për:

a) ndryshimin e emrit;

b) ndryshimin e statutit;

c) zmadhimin e kapitalit;

d) ndryshimet në strukturën e kapitalit aksionar, që nuk janë subjekt i miratimit sipas kësaj rregulloreje;

e) ndryshime në strukturën organizative;

f) hapjen ose mbylljen e degëve të subjektit apo ndryshime të adresës së tyre;

g) ndryshimin e selisë dhe adresës së tij;

h) largimin e administratorëve, të kryetarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe të kryetarit të komitetit të kontrollit;

i) listën e agjentëve të tij apo ndryshime të saj;

j) çdo ndryshim tjetër që është i detyrueshëm për regjistrim në regjistrin tregtar;

k) rastet kur parashikon të kryejë veprimtari të tjera si shërbime operacionale dhe ndihmëse, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja “a”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

l) rastet kur parashikon të kryejë veprimtari të tjera tregtare, të ndryshme nga ato të ofrimit të shërbimit të pagesave, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja “c”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

m) për të gjitha shtesat në listën e produkteve, të transaksioneve financiare dhe kanaleve të komunikimit që kryhen në rrugë elektronike, të cilat ndodhin pas fillimit të veprimtarisë së



subjektit, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

i. procedurat e funksionimit dhe të dhënat teknike për transaksionet financiare që kryhen në rrugë elektronike dhe programin e kontrollit të brendshëm për këtë qëllim;

ii. marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë, për realizimin e mbështetjes informatike të aktivitetit të subjektit, nëse ka të tillë;

iii. listën sqaruese të transaksioneve financiare që do të kryejë subjekti, së bashku me kanalet e komunikimit që do të përdoren.

3. Personat fizikë ose juridikë që përfitojnë nga përjashtimet, sipas nenit 28, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, si dhe ofruesit e shërbimeve që kryejnë veprimtari sipas shkronjave “g” dhe “h”, të nenit 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë në rastet kur nuk plotësojnë më kushtet e parashikuara në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, për të përfituar nga përjashtimi.

4. Ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë njofton Bankën e Shqipërisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k” dhe “l”, të pikës 2, të këtij neni.

Neni 73

Procesi i rivlerësimit të përshtatshmërisë

1. Institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë kryen rivlerësimin e përshtatshmërisë së aksionarëve/ortakëve, anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorëve dhe anëtarëve të komitetit të kontrollit, të paktën një herë në vit, si dhe në rastet kur gjykohet e nevojshme, bazuar në rrethana apo fakte të veçanta.

2. Institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë, nëpërmjet procesit të rivlerësimit të përshtatshmërisë së aksionarëve/ortakëve, anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorëve dhe anëtarëve të komitetit të kontrollit, siguron plotësueshmërinë në vazhdimësi të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe raporton në Bankën e Shqipërisë rezultatet e

procesit të rivlerësimit, mbi baza vjetore, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë dokumenton procesin e rivlerësimit të përshtatshmërisë së aksionarëve/ortakëve, anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorëve dhe anëtarëve të komitetit të kontrollit, si dhe parashikon detyrimin për të gjithë këta persona, të cilët duhet të njoftojnë subjektin për çdo rrethanë apo fakt që ka ndikim të rëndësishëm në përshtatshmërinë e tyre ose të konfirmojnë, të paktën një herë në vit, që vazhdojnë të plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë rregullore.

4. Në rastet kur institucioni i pagesave, institucioni i parasë elektronike dhe ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë konstaton mosplotësimin e kriterëve të parashikuara në këtë rregullore, nga aksionarët/ortakët, anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorët dhe anëtarët e komitetit të kontrollit, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë, por jo më vonë se brenda 5 ditëve pune nga konstatimi.

5. Banka e Shqipërisë, pas njoftimit sipas pikës 4, të këtij neni, por edhe nëse e konstaton këtë fakt gjatë ushtrimit të procesit të saj mbikëqyrës:

a) merr masat për subjektin sipas ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë; si dhe

b) urdhëron shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorëve ose anëtarëve të komitetit të kontrollit.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 74

Dispozita kalimtare

1. Subjektet financiare jobanka, institucionet e parasë elektronike dhe shoqëritë e kursim-kreditit, të licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe që ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, marrin masa për organizimin e veprimtarisë dhe të strukturës së brendshme, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kësaj rregulloreje, brenda datës 2 korrik 2022.



2. Subjektet financiare jobanka, institucionet e parasë elektronike dhe shoqëritë e kursim-kreditit, të licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe që ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, paraqesin në Bankën e Shqipërisë, brenda datës 2 korrik 2022, dokumentacionin dhe informacionin e parashikuar në nenin 99, pika 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

3. Institucionet e parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, paraqesin në Bankën e Shqipërisë, brenda datës 2 korrik 2022,

dokumentacionin dhe informacionin e parashikuar në nenin 99, pika 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

4. Kërkesat për marrjen e licencës si institucion i parasë elektronike, të cilat janë duke u shqyrtuar nga Banka e Shqipërisë, në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të trajtohen në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 1, datë 17.1.2013, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, të ndryshuar. Këto subjekte, pas licencimit do të zbatojnë pikën 3 të këtij neni.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

ANEKS 1

FORMULARI NR. 1

KËRKESË

DREJTUAR BANKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIE LICENCE, PËR INSTITUCION PAGESASH/INSTITUCION I PARASË ELEKTRONIKE/PËR REGJISTRIM SI OFRUES I SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

Emri i subjektit: _____

Vendndodhja e propozuar: adresa _____, Shqipëri.
(qyteti) (rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari

Veprimtaritë për të cilat subjekti kërkon të licencohet:

- 1.
- 2.
-

si institucion pagesash/institucion i parasë elektronike/për të na regjistruar si ofrues i shërbimeve të pagesave që përfiton nga përjashtimet sipas nenit 28, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë, angazhohemi për zbatimin e ligjit “Për shërbimet e pagesave”/“Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të legjislacionit shqiptar.

Kërkuesit:

Shënim. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar, në mbështetje të kësaj rregulloreje, dërgohen në adresën e mëposhtme:

**Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi “Skënderbej”, nr. 1
Tiranë, Shqipëri**

**FORMULARI NR. 2**

VENDIMI

I _____
(ORGANIT VENDIMMARRËS)

PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE

_____ (organi vendimarrës) vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, _____ (organi vendimarrës) emëron dhe përcakton si përfaqësues:

(emri) (atësia) (mbiemri)Adresa: _____
(rruga, numri) (qyteti) (shteti)_____
(numri i telefonit/celularit)_____
(adresa e *email-it*)

Përfaqësuesi i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë subjektin dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e _____ (organit vendimarrës). Përfaqësuesi është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet, siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari, nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë.

Datë _____,

(Emri, mbiemri)_____
(nënshkrimi)*Shënim. Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.*

**FORMULARI NR. 3****TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË SUBJEKTIT**

Subjekti që aplikon për licencim si institucion pagese ose si institucion i parasë elektronike, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë të dhënat identifikuese, të cilat përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) emri i shoqërisë/subjektit që aplikon:

--

dhe, nëse është i ndryshëm, emri tregtar:

--

b) adresa e selisë qendrore të aplikuesit;

Adresa e selisë qendrore	
Numri i telefonit	
Numri i faksit	

c) ☐ adresa e postës elektronike dhe faqja zyrtare e internetit të aplikuesit (nëse ka);

Adresa e postës elektronike (email):	
Faqja zyrtare e internetit (nëse ka):	

d) informacion nëse aplikuesi është aktualisht ose ka qenë ndonjëherë subjekt i rregullimit e mbikëqyrjes së një autoriteti tjetër mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare. (Nëse po, me paraqitjen e aplikimit duhet të sigurohen detaje përkatëse);

(Ju lutem përgjigjuni **Po** ose **Jo**)

e) informacion nëse aplikuesi është anëtar ose planifikon të anëtarësohet në ndonjë shoqatë në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/ose të parasë elektronike, në rast se është e aplikueshme;

Emri i shoqatës:	
Adresa:	

**FORMULARI NR. 3/1****TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË PERSONIT QË APLIKON PËR REGJISTRIM
SI OFRUES I SHËRBIMIT TË INFORMIMIT TË LLOGARISË**

1. Nëse aplikuesi është person fizik, të dhënat identifikuese që paraqet pranë Bankës së Shqipërisë, duhet të përmbajjnë informacionin e mëposhtëm:

a) Emri:

Mbiemri:

b) Data e lindjes:

Dita/muaji/viti

c) Vendi i lindjes:

Shteti:

Qyteti:

d) Shtetësia:

e)

A keni pasur ndonjëherë/keni një shtetësi tjetër?

☐

→ Jo

☐

→ Po → Paraqisni detajet më poshtë për shtetësitë e tjera.

f) Adresa aktuale:

Adresa e plotë dhe kodi postar

Qyteti

Shteti

g) Konfirmoj se është paraqitur si pjesë e aplikimit edhe *curriculum vitae* CV.

☐

→ Po

☐

→ Jo → Nëse Jo, duhet të jepen shpjegime.

h) Konfirmoj se janë paraqitur si pjesë të aplikimit edhe vërtetimet e mëposhtme të lëshuara

Activate
Go to Sett



nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial (të lëshuara jo më herët se 3 (tre) muaj):

- i. se personi nuk është në ndjekje penale;
- ii. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
- iii. se personi nuk është i dënuar penalisht.

☐ → Po

☐ → Jo → Nëse Jo, duhet të jepet shpjegime.

- i) A keni lidhje me persona të ekspozuar politikisht, sipas përcaktimeve në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”?

☐ → Jo

☐ → Po → Nëse Po, paraqisni shpjegime më poshtë.

2. Nëse aplikuesi është person juridik, të dhënat identifikuese që paraqet pranë Bankës së Shqipërisë, duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- a) emri i shoqërisë/subjektit që aplikon:

dhe, nëse është i ndryshëm, emri tregtar:

- b) adresa e selisë qendrore të aplikuesit;

Adresa e selisë qendrore	
Numri i telefonit	
Numri i faksit	

- c) adresa e postës elektronike dhe faqja zyrtare e internetit të aplikuesit (nëse ka);

Adresa e postës elektronike (email):

Faqja zyrtare e internetit (nëse ka):

- d) informacion nëse aplikuesi është aktualisht ose ka qenë ndonjëherë subjekt i rregullimit e mbikëqyrjes së një autoriteti tjetër mbikëqyrës në sektorin e shërbimeve financiare. (Nëse po, me paraqitjen e aplikimit duhet të sigurohen detaje përkatëse);

(Ju lutem përgjigjuni **Po** ose **Jo**)

**FORMULARI NR. 4****CURRICULUM VITAE**

(e administratorit të propozuar, ortakut/aksionarit individ, anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, anëtarit të komitetit të kontrollit)

Emri dhe Mbiemri	
Adresa e banimit	
Datëlindja	
Vendlindja	
Shtetësia	
Numri i telefonit të punës	
Numri i telefonit celular	
Adresa e-mail	
KUALIFIKIMI ARSIMOR	
<i>(lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha institucionet arsimore që keni ndjekur, kohëzgjatjen e studimeve, datën e diplomimit dhe titujt/gradat akademike)</i>	
1. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	
Diploma e fituar	
2. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	
Diploma e fituar	
NIVELI I NJOHJES SE GJUHEVE TE HUAJA <i>(lutemi listoni gjuhët dhe nivelin e njohjes së tyre me numrat nga 5 – 1 (5 = shumë mirë, 4 = mirë, 3 = mjaftueshëm etj.)</i>	
TRAINIME TE AVANCUARA <i>(lutem listoni në mënyrë kronologjike të gjitha kurset, periudhat, temat e kursit, organizatorët)</i>	
PJESËMARRJE NE KESHILLA DREJTUESE/ NE SHOQATA PROFESIONISTËSH <i>(lutemi listoni shoqëritë/shoqatat ku jeni ose keni qenë anëtar i këshillave drejtues, datat e pjesëmarrjes, etj.)</i>	



EKSPERIENCA NE PUNE	
<i>(lutem listoni në mënyrë kronologjike të gjitha punësimet, duke filluar nga punësimi më i fundit, titullin e pozicionit dhe kohëzgjatjen e punësimit si dhe përgjegjësitë të detajuara për secilin pozicion)</i>	
1. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyra e punësimit	a. i punësuar ☐ b. i vetëpunësuar ☐ c. i papunë ☐ d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ☐
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a) Dorëheqje ☐ b) Shkurtim i vendit të punës ☐ c) Dalje në pension ☐ d) Përfundim i kontratës ☐ e) Pushim nga puna ☐ f) Të tjera ☐ Specifiko
2. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyra e punësimit	a. i punësuar ☐ b. i vetëpunësuar ☐ c. i papunë ☐ d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ☐
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a) Dorëheqje ☐ b) Shkurtim i vendit të punës ☐ c) Dalje në pension ☐ d) Përfundim i kontratës ☐ e) Pushim nga puna ☐ f) Të tjera ☐ Specifiko
3. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyra e punësimit	a. i punësuar ☐ b. i vetëpunësuar ☐ c. i papunë ☐ d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ☐
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	



Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a) Dorëheqje ☐ b) Shkurtim i vendit të punës ☐ c) Dalje në pension ☐ d) Përfundimi i kontratës ☐ e) Pushim nga puna ☐ f) Të tjera ☐ Specifiko
4. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyra e punësimit	a. i punësuar ☐ b. i vetëpunësuar ☐ c. i papunë ☐ d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (<i>full-time</i>) ☐
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a) Dorëheqje ☐ b) Shkurtim i vendit të punës ☐ c) Dalje në pension ☐ d) Përfundimi i kontratës ☐ e) Pushim nga puna ☐ f) Të tjera ☐ Specifiko

Emri dhe mbiemri

(firma)

Data

**FORMULARI NR. 5****DEKLARATË**

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet, dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë i paraqitet vullnetarisht Bankës së Shqipërisë nga ana ime.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport, mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë kërkesën.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(data)

(nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

(nënshkrimi i përgatitësit)

Nënshkruar në këtë ditë _____

të _____, 20_____.

(nënshkrimi i noterit publik)

Shënim. Kjo deklaratë do të plotësohet nga çdo themelues i institucionit të pagesave dhe institucionit të parasë elektronike.

**FORMULARI NR. 6****AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

(Të plotësohet secili prej të dy formularëve të autorizimit në origjinal!)

Unë, _____, autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër për personin tim, t'i paraqesë origjinalin ose kopje të këtij dokumenti, regjistri ose informacioni Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj.

Emri (shtypur ose printuar)_____
Adresa e plotë_____
Data (data/muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

_____data_____, 20____

KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ _____
(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

Unë, _____, autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër për personin tim, t'i paraqesë origjinalin ose kopje të këtij dokumenti, regjistri ose informacioni Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj.

Emri (shtypur ose printuar)_____
Adresa e plotë_____
Data (data/muaji/viti)_____
Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

_____data_____, 20____

KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ _____
(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)*Shënim. Do të plotësohet nga çdo themelues i institucionit të pagesave dhe institucionit të parasë elektronike.*

**FORMULARI NR. 7****MJEDISËT E SUBJEKTIT DHE VENDNDODHJA E TIJ²**

1. Kapitali i propozuar për t'u investuar në mjete fikse, tipi i zotërimit:
 - Mjediset e përhershme marrë me qira.
 - Mjediset e përhershme pronë vetjake.
 - Mjediset e përkohshme.
2. Përshkrimi i mjediseve:
 - a) Mjediset që do të merren me qira:
 - i. kostoja vjetore e parashikuar e qirasë së subjektit;
 - ii. përshkrimi i riparimeve dhe i përmirësimeve të parashikuara të ndërtesës.
 - b) Mjediset në pronësi:
 - i. emri dhe adresa e shitësit, data e përfundimit të ndërtimit, kostoja e blerjes së lokalit (objektit);
 - ii. kostoja dhe përshkrimi i riparimeve të nevojshme, riparime dhe ndryshime të ndërtesës dhe të ambientit rrethues.
 - c) Mjediset e përkohshme:
 - i. vendndodhja e mjediseve të përkohshme;
 - ii. detaje lidhur me mjediset e përkohshme, duke përfshirë përmasat e tyre, tipin e konstruksionit, lehtësitë më kryesore që do të vendosen në ndërtesë;
 - iii. në qoftë se mjediset e përkohshme do të blihen, parashikimin e koston, vlerën e përafërt të rishitjes, një kopje të formularit-tip të kontratës së blerjes;
 - iv. në qoftë se mjediset e përkohshme do të merren me qira, të jepet parashikimi i vlerës së qirasë mujore.
3. Investimi i propozuar në mobilie, në pajisje dhe një përshkrim i sendeve.
4. Investimi i propozuar për të përmbushur kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

² Shënim: Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike siguron sa më shumë të jetë e mundur nga ky informacion në kohën e paraqitjes së kërkesës.

**FORMULARI NR. 8**

**LISTA ME TË DHËNAT E AGJENTËVE TË INSTITUCIONIT TË
PAGESAVE/INSTITUCIONIT TË PARASË ELEKTRONIKE/OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË
INFORMIMIT TË LLOGARISË**

Nr.	Emri i agjentit	NUIS (numri unik i identifikimit të subjektit)/nr. personal i dokumentit të identifikimit	Vendndodhja (adresa) e agjentit	Administratori i agjentit/personi përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave (Emër, atësi, mbiemër)	Nr. personal i dokumentit të identifikimit të personave në kolonën (5)	Rrethi	Qyteti/ komuna	Kontakte (email, telefon)	Shërbimet e pagesave që do të kryejë agjenti ⁵	
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
									1 2 3 4 5 6 7 8	PE ⁶

FORMULARI NR. 9**DEKLARATË**

Nëpërmjet së cilës, unë vërtetoj se kam/nuk kam lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Shënim. Në rastin kur aksionari/ortaku/administratori/anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrës/anëtari i komitetit të kontrollit i propozuar, deklaron se ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me aksionarin/ortakun/ administratorin/anëtarin e këshillit të administrimit/ mbikëqyrës/anëtarin e komitetit të kontrollit të propozuar	Lloji i lidhjes (familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar	Ka dënim penal të formës së prerë (sqaro llojin e dënimit)
1			
2			
3			
...			

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë/subjektit _____.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë miratimin tim si aksionar/ortak/administrator/kryetar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës/kryetar i komitetit të kontrollit të subjektit _____ ose që subjekti _____

⁵ Subjekti përzgjedh me shenjë "X" shërbimin/të gjitha shërbimet e pagesave, sipas pikave 1–8, të aneksit 1, të ligjit "Për shërbimet e pagesave", që agjenti do të ofrojë dhe që janë të përfshira në aneksin e licencës.

⁶ Subjekti përzgjedh me shenjë "X" kolonën (11), nëse agjenti ofron shërbimin e parasë elektronike "PE".



_____ të refuzojë emërimin/riemërimin tim si anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës/ anëtar i komitetit të kontrollit.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë/subjekti _____.

(Emri/mbiemri i aksionarit/ortakut/administratorit/anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës/anëtarit të komitetit të kontrollit të propozuar)

_____/_____/_____
(data)

(nënshkrimi i plotë)

FORMULARI NR. 10

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës, unë (për individët) vërtetoj se jam/nuk jam person i ekspozuar politikisht dhe se kam/nuk kam lidhje me persona të ekspozuar politikisht, sipas përcaktimeve në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Shënim. Në rastin kur aksionari/ortaku me pjesëmarrje influencuese deklaron se ka lidhje me persona të ekspozuar politikisht, sipas përcaktimeve në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me aksionarin/ortakun me pjesëmarrje influencuese	Lloji i lidhjes (familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar
1		
2		
3		
...		

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë/subjektit _____.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë miratimin tim si aksionar/ortak i subjektit _____.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë/subjekti _____.

(Emri/mbiemri i aksionarit/ortakut individ (person fizik)/i përfaqësuesit ligjor të aksionarit/ortakut person juridik)

_____/_____/_____
(data)

(nënshkrimi i plotë)

Shënim. Kjo deklaratë plotësohet nga aksionarët/ortakët me pjesëmarrje influencuese në kapitalin e institucioneve të pagesave/institucioneve të parasë elektronike.

**FORMULARI NR. 11****RAPORTI FINANCIAR PERSONAL SEKRET ***

DO TË PLOTËSOHET NGA ÇDO AKSIONAR/ORTAK ME 10 PËR QIND OSE MË SHUMË TË KAPITALIT

GJENDJA FINANCIARE MË _____
(datë)

Depozituar nga:

Për personat fizikë shënohet: emri, atësia, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, nënshtetësia dhe adresa e vendbanimit.

PËR
DEPARTAMENTIN E MBIKËQYRJES
SË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në lidhje me:

(arsyet e veçanta të paraqitjes së këtij raporti)

INSTRUKSIONE:

Shtypni ose printoni këtë raport. Përgjigjuni të gjitha pyetjeve plotësisht. Në qoftë se përgjigja është “jo”, ose “asnjë” ose “e pazbatueshme”, lutemi paraqiteni këtë. Në qoftë se hapësira është e pamjaftueshme, i bashkëlidhni një pasqyrë të veçantë këtij formulari. Informacioni në pasqyrën e veçantë shënohet me numra dhe me germa për t’iu përshtatur këtij formulari dhe të gjitha pasqyrat nënshkruhen dhe të datohen.

Një raport i pasaktë dhe jo i plotë nuk pranohet dhe është shkak për të refuzuar kërkesën për licencë.

Çdo faqe e informacionit në RAPORTIN FINANCIAR PERSONAL SEKRET të nënshkruhet, të datohet nga individ që e plotëson atë dhe të noterizohet tek një noter publik.

Për të sqaruar ndonjë pyetje në lidhje me këtë raport personi që e ka plotësuar do të kontaktojë direkt me Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes.

* TË GJITHA TË DHËNAT TË JEPEN NË LEK SHQIPTAR. PËRSHKRUANI METODËN E PËRDORUR NË KËMBIMIN E MONEDHËS DHE SHËNONI KURSIN E KËMBIMIT.

**FORMULARI NR. 11** (faqe 2)

GJENDJA E TË ARDHURAVE

TË ARDHURA	20__	20__	20__	Vlera e vitit në vazhdim
Pagat, pagesat dhe kompensimet	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë
Dividendi dhe të ardhurat nga interesat	_____	_____	_____	_____
Të ardhurat neto nga qira dhe investime	_____	_____	_____	_____
Të ardhura të tjera	_____	_____	_____	_____
TOTALI I TË ARDHURAVE*	_____	_____	_____	_____
ZBRITJE	_____	_____	_____	_____
Zbritje dhe rregullime	_____	_____	_____	_____
Taksat për të ardhurat	_____	_____	_____	_____
TOTAL I ZBRITJEVE	_____	_____	_____	_____
TË ARDHURAT NETO (totali i të ardhurave minus zbritjet)	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë
* Shpjego raste të veçanta për vitin e parë				

Në qoftë se një nga arsyet për të plotësuar këtë raport është përfshirja në blerjen e aksioneve, plotëso informacionin që vjen pas:

Shuma e aksioneve të blera	Vlera nominale	Çmimi i blerjes/aksion	Vlera totale e blerjes

Përshkruaj mënyrën e pagesës. Në qoftë se mjetet do të jenë likuide për të financuar blerjen, lutemi jepni detaje për këtë:

**FORMULARI NR. 11** (Faqe 3)RAPORTI FINANCIAR⁷

AKTIVET	PASIVET
1. Paraja në dorë dhe në banka _____	7. Pasive korrente të pasiguruara _____
2. Dëftesa, hua dhe llogari të tjera të arkëtueshme të konsideruara të rregullta dhe të mbledhshme _____	8. Pasive korrente të siguruara _____
3. Pronë e patundshme e zotëruar _____	9. Pasive afatgjata të pasiguruara _____
4. Letra me vlerë të tregtueshme _____	10. Pasive afatgjata të siguruara _____
5. Interesa pronare _____	11. Interesi i ardhur dhe taksa për t'u paguar _____
6. Aktive të tjera _____	12. Të tjera pasive dhe detyrime _____
TOTALI I AKTIVEVE _____	TOTALI I PASIVEVE _____
	13. Pasuria neto (aktivet totale minus totalin e pasiveve) _____
	TOTALI I PASIVEVE DHE PASURIA NETO _____

PASIVE TË PASIGURUARA

Përveç detyrimeve dhe pasiveve të shënuara më sipër, unë kam nënshkruar, garantuar ose nga ana tjetër unë jam indirekt ose rastësisht përgjegjës për detyrimet e të tjerëve si më poshtë:

Emri dhe adresa e debitorit	Emri dhe adresa e kreditorit	Përshkrimi i kolateralit	Vlera aktuale e kolateralit	Norma e interesit	Data e detyrimit	Teprica aktuale

⁷ Kjo tabelë do të detajohet në tabelat vijuese.

**FORMULARI NR. 11** (faqe 4)

PARAJA NË DORË DHE NË BANKA⁸
(Vetëm llogaritë personale)

Emri i bankës	Kodi i llogarisë	Shuma (në lekë)
Shuma e parasë në banka		
Plus (+) paraja në dorë		
Mbartur nga pika 1, e raportit financiar		
TOTALI		

DËFTESA, HUAJA DHE DETYRIME TË TJERA TË ARKËTUESHME
TË KONSIDERUARA TË RREGULLTA DHE TË MBLEDHSHME⁹

Emri dhe adresa e debitorit	Data e detyrimit	Përshkrimi i kolateralit	Vlera aktuale e kolateralit	Teprica aktuale (në lekë)
Mbartur nga pika 2, e raportit financiar				
TOTALI				

⁸ Detajim i raportit financiar, pika 1.

⁹ Detajim i raportit financiar, pika 2.

**FORMULARI NR. 11** (faqe 5)**PRONË E PATUNDSHME E ZOTËRUAR¹⁰**

Përshkrimi dhe vendndodhja	Emri i titullmbajtësit	Data e marrjes	Vlera aktuale e interesit tuaj (në lekë)
Mbartur nga pika 3, e raportit financiar			
TOTALI			

LETRA ME VLERË TË TREGTUESHME¹¹
 (Listuar në bursë ose tregtohen në tregti të lirë të rregullt)

Emri i letrës me vlerë	Numri i aksioneve	Përshkrimi (aksione, bono etj.)	Vlera aktuale e tregut (në lekë)
Mbartur nga pika 4, e raportit financiar			
TOTALI			

¹⁰ Detajim i raportit financiar, pika 3.

¹¹ Detajim i raportit financiar, pika 4.

**FORMULARI NR. 11 (faqe 6)****INTERESAT PRONARE/PERSONAT JURIDIKE PA OFERTË PUBLIKE¹²**

Poshtë, në kolonat përkatëse jepni informacionin e kërkuar lidhur me të gjitha bizneset ose ndërmarrjet e ngjashme në të cilat ju zotëroni një interes pronar ligjor ose të drejtë. Shembujt janë: pronësi të vetme, ortakëri, ndërmarrje të përbashkëta dhe person tjetër juridik aksionet e të cilëve nuk listohen në bursë ose tregtohen në treg të lirë të rregulluar. Në kolonën “Forma e biznesit”, përshkruani formën ligjore të biznesit ose të ndërmarrjes. Në qoftë se ndërmarrja tregtare është një person juridik, përcaktoni natyrën dhe përqindjen e interesit tuaj pronar në biznes ose në ndërmarrje. Në kolonën “Vlera aktuale”, përshkruani vlerën e plotë aktuale në treg të pronësisë suaj.

Shënim. Paraqitni të dhënat më të fundit për gjendjen ose të dhëna të tjera të vlerësimit, për të justifikuar vlerat e dhëna në tabelë të cilat përfaqësojnë një sasi të barabartë me 10 për qind ose më shumë të pasurisë suaj neto.

Emri dhe adresa e biznesit	Forma e biznesit	Natyra e biznesit	Natyra e interesit tuaj	Vlera aktuale (në lekë)
Mbartur nga pika 5 e raportit financiar				
TOTALI				

AKTIVE TË TJERA¹³

PËRSHKRUANI AKTIVET, BAZAT DHE METODAT E VLERËSIMIT TË TYRE	VLERA AKTUALE (në lekë)
Mbartur nga pika 6 e raportit financiar	
TOTALI	

¹² Detajim i raportit financiar, pika 5.

¹³ Detajim i raportit financiar, pika 6.

**FORMULARI NR. 11 (faqe 7)****DETYRIMET AFATSHKURTRA¹⁴**

Paraqitni informacionin e kërkuar në lidhje me të gjitha detyrimet prej 500.000 lekësh ose më shumë, për të cilat ju jeni përgjegjës dhe të cilave u ka ardhur koha e pagimit ose do të paguhen për një vit ose më pak (pjesa e detyrimeve afatgjata nuk përfshihet në këtë formular).

Emri dhe adresa e kreditorit	Kontrollo nëse është e siguruar	Siguruar nga	Norma e interesit	Data e fillimit të detyrimit	Data e pagimit të detyrimit	Shuma (në lekë)
Mbartur nga pika 7 e raportit financiar						
TOTALI i detyrimeve të pasiguruara (në lekë)						
Mbartur nga pika 8 e raportit financiar						
TOTALI i detyrimeve të siguruara (në lekë)						
TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA						

DETYRIMET AFATGJATA¹⁵

Paraqitni informacionin e kërkuar në lidhje me të gjitha detyrimet për 500,000 lekë ose më shumë, për të cilat ju jeni përgjegjës dhe të cilat do të paguhen për një vit ose më shumë.

Emri dhe adresa e kreditorit	Kontrollo nëse është e siguruar	Siguruar nga	Norma e interesit	Data e fillimit të detyrimit	Pagesa mujore (në lekë)	Teprica aktuale (në lekë)
Mbartur nga pika 9 e raportit financiar						
TOTALI i detyrimeve të pasiguruara (në lekë)						
Mbartur nga pika 10 e raportit financiar						
TOTALI i detyrimeve të siguruara (në lekë)						
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA						

¹⁴ Detajim i raportit financiar, pikat 7 dhe 8.

¹⁵ Detajim i raportit financiar, pikat 9 dhe 10.

**FORMULARI NR. 11** (Faqe 8)DETYRIME DHE PASIVE TË TJERA¹⁶

Përshkrimi	Data e detyrimit	Shuma (në lekë)
	Mbartur nga pika 12 e raportit financiar	
	TOTALI	

CERTIFIKATË/DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë, ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet, dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë i paraqitet vullnetarisht nga unë Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(data)

(nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm: _____

(nënshkrimi i përgatitësit)

TTTULLI: _____

ADRESA: _____

Betuar dhe nënshkruar nga në këtë ditë _____ të _____, 20_____.

(Nënshkrimi i noterit publik)

Komisionet e shërbimit:

¹⁶ Detajim i raportit financiar, pika 12.

**FORMULARI NR. 11** (faqe 9)

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Autorizimi plotësohet në dy ekzemplarë në origjinal)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose kopjimit të tyre në zbatim të legjislacionit shqiptar.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë: _____

(data/muaji/viti)

Nënshkrimi

Betuar dhe nënshkruar në praninë time

____ data _____, 20 ____

KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ _____
(nënshkrimi i noterit publik)**FORMULARI NR. 12**

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës vërtetoj se institucioni i pagesave/institucioni i parasë elektronike - _____, do të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 12, të ligjit "Për shërbimet e pagesave".

(Emri/mbiemri i përfaqësuesit ligjor të institucionit të pagesave/institucionit të parasë elektronike)____/____/____
(data)_____
(nënshkrimi i plotë)*Shënim. Kjo deklaratë do të plotësohet nga institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike.*



VENDIM

Nr. 65, datë 1.12.2021

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
ZOTËRIMIN E KONTROLLIT TË
TËRTHORTË TË 100 PËR QIND TË
KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS
ALPHA ALBANIA SH.A. NGA AKSIONARI I
TËRTHORTË ALPHA BANK SA, GREQI**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “g”, të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin për zotërimin e kontrollit të tërthortë të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Alpha Albania sh.a. nga aksionari i tërthortë Alpha Bank s.a., Greqi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare

**KRYETAR
Gent Sejko**

VENDIM

Nr. 66, datë 1.12.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR EKSPORT-
IMPORTET E KARTËMONEDHAVE
DHE TË MONEDHAVE METALIKE
SHQIPTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 34 dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për eksport-importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 39, datë 25.5.2011, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 3, shkronja “g”, shprehja “*çdo person juridik*” zëvendësohet me shprehjen “*individ, personat fizikë tregtarë dhe personat juridikë*”;

b) Neni 5, ndryshon përmbajtje si vijon:

“Import-eksporti

1. *Çdo person, ka të drejtë të eksportojë ose të importojë në cash monedha shqiptare me ose pa kurs ligjor nga/ në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

2. *Në çdo rast, personat zbatojnë detyrimet për deklarimet pranë autoriteteve doganore në kuafi, sipas përcaktimeve në legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.”;*

c) Neni 6 ndryshon përmbajtje si vijon:

“Eksporti nga Banka e Shqipërisë për përshtatjen e makinave të përpunimit të monedhës

1. *Banka e Shqipërisë, për përshtatjen e makinave të veta të përpunimit të monedhës, kryen eksport të monedhave shqiptare.*

2. *Eksporti, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me urdhër me shkrim të administratorit përkatës.*

3. *Urdhri, sipas pikës 2 të këtij neni, bazohet në relacionin e përgatitur nga Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë. Në çdo rast, urdhri përmban, gjithashtu, edhe sasinë e monedhave që do të eksportohet.”;*

d) Neni 7, shfuqizohet.



2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë